



# Buletini i Austria Praemix

**Kategoria: Derra**

# PËRMBAJTJA

1. SHITESA OPTIMALE DITORE MUNDËSUAR NGA GJENETIKA DHE USHQIMI.....	4
2. NATUPIG: IDEAL PËR DERRAT E MAJMËRISË.....	7
3. FURNIZIMI I DUHUR ME KALCIUM DHE FOSFOR .....	9
4. KËSHILLA PËR FERMAT E MBARËSHTIMIT TË DOSAVE ME RENDIMENT MBI 30 GICA NË VIT .....	11
5. NEVOJA ENERJITIKE E DOSËS .....	13
6. KËRKESA TË MËDHA PËR USHQIMIN E GICAVE.....	15
7. KTHIMI I AFSHIT .....	17
8. NJË NDËRZIM I SUKSESSHËM .....	19
9. MËNYRA E DUHUR E TË USHQYERIT TË DOSAVE.....	22
10. GICAT E PËLQEJNË “USHQIMIN ME PËRMBAJTJE ACIDIKE” .....	24
11. DIARREJA DHE ENTEROTOKSEMIA: PROBLEMATIKA E VAZHDUESHME.....	26
12. MËNYRA E DUHUR E TË USHQYERIT ME DRITHËRA .....	29
13. MASAT QË DUHEN MARRË PËR MENAXHIMIN E PERIUdhËS SË MËMËZIMIT.....	31
14. OPTIMIZIMI I FURNIZIMIT ME CELULOZË.....	34
15. ORGANIZIMI NË STALLËN E DERRAVE.....	36
16. SHKAQET E SËMUNDJES SË EDEMËS .....	37
17. SUKSESI NË STALLË.....	39
18. PARANDALIMI I KAFSHIMIT TË BISHTIT TE GICAT .....	41
19. TEMPERATURAT E LARTA NË VERË- FAKTOR I RËNDËSISHËM PËR T’U KONTROLLUAR .....	42
20. SHMANGNI STRESIN NGA TEMPERATURAT E LARTA GJATË TRANSPORTIT TË KAFSHËVE.....	44
21. KLIMA NË STALLË.....	45
22. RRUGËT E FRYMËMARRJES, PATOGJENËT DHE SHKAKTARËT .....	48
23. PRODUKTET SCHAUMANN – ACIDET YNDYRORE RRISIN RENDIMENTIN .....	51
24. KUJDES NGA USHQIMI I MYKUR .....	53
25. FRESKI DHE VITALITET ME SCHAUMALAC ENERJETRUNK .....	54
26. USHQIM I MIRË PËR KAFSHË TË SHËNDETSHME .....	55
27. FILLIM I RI ME DOSA TË SHËNDETSHME .....	57
28. PROBIOTIKËT NË USHQIMIN E KAFSHËVE-PERFORMANCË MË E MIRË PËRMES SHËNDETIT MË TË MIRË.....	59
29. SI NDIKON STREPTOKOKU TE DERRAT .....	61
30. KONCEPTI I TË USHQYERIT PËRCAKTON SUKSESIN .....	63
31. DERRAT KANË NEVOJË TË VAZHDUESHME PËR UJË .....	65
32. PNEUMONIA ENZOOTIKE ËSHTË PROBLEM PËR TUFËN.....	66
33. TË USHQYERIT E DERRAVE .....	67
34. FILLIM I SHËNDETSHËM I JETËS - BONVITAL PËR GICAT NË GJI.....	69
35. MJESHTËRIA E MBARËSHTIMIT TË DERRAVE.....	71
36. ORGANIZIMI I KOHËS SË DERRAVE NË MAJMËRIM .....	72
37. MËNYRA EFIKASE PËR ELIMINIMIN E TOKSINAVE DHE OPTIMIZIMIN E PERFORMANCËS SË DERRAVE-SCHAUMASAN PREMIUM.....	74
38. MASAT OPTIMALE KUNDËR PARAZITËVE DHE PROGRAMET E VAKSINIMIT TË TUFËS SË DERRAVE.....	75



## 1. SHITESA OPTIMALE DITORE MUNDËSUAR NGA GJENETIKA DHE USHQIMI

*Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe Aksioneri i Austria Praemix shpk Përkthyer dhe përpunuar Olger Nanagjoka*

Qëllimi i majmërisë së derrit është prodhimi kosto-efektiv i karkasave të pasura me mish që japin mish të shijshëm. Potenciali gjenetik për prodhim të lartë të mishit është i pranishëm në derrat hibridë modernë, por zakonisht nuk shfrytëzohet plotësisht. Kjo ndodh nga njëra anë për shkak të kushteve të pafavorshme mjedisore, si p.sh. qëndrimi ose klima dhe shëndeti në anën tjetër, por edhe një sasi ushqimi që nuk i plotëson kërkesat ushqyese. Vetëm kur të gjithë faktorët janë në kahun pozitiv, “derrat 1,000 g” nuk janë utopi.

Ka akoma vend për diskutim se në cilat kushte kjo shtesë ditore prej 1000g është ekonomikisht e arsyeshme. Duke vepruar kështu, duhet të merren parasysh edhe parimet e procesit të rritjes së derrave të majmërisë, siç tregon kërkimi i mëposhtëm.

### PROTEINA DHE MARRJA E YNDYRËS NË FAZAT E MAJMËRISË

Derrat hibridë bashkëkohorë janë më të pasur me mish dhe zhvillohen siç tregohet në Figurën 1, dukshëm me një rreze mishi më të madhe se sa derrat me gjenetike jo të përmirësuar. Në të njëjtën kohë, dhjami (indi adipoz) zvogëlohet. Meqenëse nevojitet më shumë energji për marrjen e yndyrës sesa për grumbullimin e proteinave, kërkesa për energji të ushqimit për kg të derrave të sotëm është gjithashtu më e lartë.

Gjatë rrjedhës së një faze normale majmërie (25 deri në 115 kg peshë e gjallë), mund të përcaktohet një kurbë tipike për proteinën dhe yndyrën: në paramaturim kemi konsum të lartë të proteinave dhe në periudhën përfundimtare ndodh akumulimi i yndyrës (shih Fig. 1), kjo e bën të qartë se furnizimi optimal me lëndë ushqyese arrihet vetëm nëse receta ushqimore është përshtatur me kërkesat në faza të ndryshme të majmërisë. Prandaj, marrja maksimale e proteinave mund të arrihet vetëm nëpërmjet një furnizimi me proteina ose aminoacide në fazën e grumbullimit më të lartë të tyre. Për shkak të progresit të peshës përdorimi i karbohidrateve është gjithashtu shumë i nevojshëm. Nga ana tjetër, yndyra formohet në fazën përfundimtare. Si rezultat, shpenzimet për lëndë ushqyese për kg janë më të larta dhe sasia e ushqimit në këtë fazë rritet.



Një furnizim i tepruar mund të çojë në një degjenerim yndyror të karkasës.

Kjo haset kryesisht në karkasën e meshkujve që rriten më shpejt dhe kanë një konsum më të lartë ushqimi sesa dasat. Nga ana tjetër, konsumi i proteinave është më i ulët dhe shtimi në peshë është më shpejtë gjatë majmërisë.

### SHITESA DITORE SI NJË FAKTOR EKONOMIK

Një përmirësim i konvertimit të ushqimit në derrat hibridë modernë ka sjellë një kapacitet më të lartë prodhimi mishi. Kjo është më e dukshme tek dasat sesa tek derrat e kastruar dhe tek racat e tjera të mirëfillta të mishit sesa te derrat hibridë. Sipas këtyre parimeve të përshkruara, faktori më i rëndësishëm ekonomik, përkatësisht norma e lartë e shtesës ditore, duhet të shfrytëzohet ekonomikisht. Kjo ngre pyetjen nëse shtesat ditore duhet të arrihen me çdo çmim dhe çfarë efektesh do të kishte shtesa ditore maksimale p.sh., masa 1000g në këndvështrimin e tregut. Një 3 përgjigje për këto pyetje jepet me anë të shembullit në vlerësimin e një eksperimenti të Hülsenberger-it. Duhet të theksohet se sipas Hülsenbergut derrat në fazën përfundimtare ishin të ndarë sipas gjinisë dhe me të njëjtën recetë ushqimore. Ushqimi i përdorur përmbante afërsisht 75% drithëra, 15 deri në 20% sojë dhe premikse të cilësisë së lartë të Schaumann, Tri-Pherphoral VM dhe SM 2074, të cilat përdoren në fazën paramajmërisë dhe përfundimtare. Kushtet optimale ambientale, si qëndrimi, klima, shëndeti, si dhe një derr hibrid gjenetikisht intensiv japin përgjigje në pyetjen se si shtesa ditore do të kishte ndikim pozitiv në aspektin ekonomik.

## **SHTESA DITORE DHE MARRJA E USHQIMIT**

Si rregull i përgjithshëm, një shtesë e lartë peshe është e mundur vetëm nëpërmjet konsumit të lartë të ushqimit, ekziston një marrëdhënie e ngushtë pozitive midis marrjes së ushqimit dhe rritjes ditore, kapaciteti i lartë i ushqimit duhet të përdoret plotësisht. Në këtë periudhë të rritjes ushqimi i marrë në ditë është rreth 2.2-2.4. Receta ushqimore e zgjedhur tregon gjithashtu se racionimi i ushqimit për derrat nga 60 kg bëhet deri në një sasi maksimale ushqimi prej 2.8 kg/ditë për dosat, të cilat e marrin ushqimin ad libitum ndërsa derrat arrijnë të konsumojnë sasi më të mëdha ushqimi.

Më e rëndësishmja është se derrat gjenetikisht me një konsum të ulët ushqimi ditor janë në gjendje të arrijnë konvertim ditor të lartë nëse ushqimi që është ofruar është ad libitum, kjo ndodh sidomos në rastin e dosave dhe me meshkuj të kastruar vetëm deri në një maksimum prej 80 kg peshë e gjallë.

## **SHTESA DITORE DHE PËRDORIMI USHQIMIT**

Ajo që është interesante është çështja se si në rritjen e përditshme ndikon shfrytëzimi i ushqimit.

Testi i ngarkesës së mishit të derrit (shih Figurën 4) tregon se rritja në konvertimin e ushqimit rritet me shtesa e ditore. Kjo vlen për derrat meshkuj, si dhe për femrat, meqë metoda e përdorur (deri në 60 kg peshë e gjallë) prodhon mbi 900 g shtesë ditore është metoda optimale e shfrytëzimit të ushqimit. Zhvillimi i shpejtë i organizmit gjatë kohës së paramajmërisë lejon një absorbim maksimal të proteinave. Në të njëjtën kohë, faza përfundimtare e majmërisë është shkurtuar dhe energjia e marrë nëpërmjet ushqimit përdoret për akumulimin dhe mirëmbajtjen e yndyrës. Rritja maksimale ditore rrjedhimisht çon në një përmirësim të caktuar në normën e konvertimit të ushqimit, nëse mishi ushqehet intensivisht në fillim dhe pjesa tjetër ushqehet në mënyrë drastike. Në veçanti, kjo vlen për sterilizimin kur cilësia e ushqimit është përshtatur me rritjen e shpejtë dhe marrjen e lartë të mishit në fazën përpara therjes.

## **SHTESA DITORE DHE RREZJA E MISHIT**

Çështja kryesore është nëse rrezja e mishit arrin një rritje maksimale ditore. Vlerësimi është kryer veçmas sipas gjinisë dhe tregon një marrëdhënie qartësisht pozitive për të gjithë derrat e marrë në studim. Arsyeja për këtë është se derrat janë më të rinj me një rritje të lartë dhe ushqehen në mënyrë më të kufizuar gjatë pjesës së fundit të majmërisë.

Parakusht është që në pjesën e konsumit më të lartë të proteinave, ushqimi siguron një furnizim me cilësi të lartë të aminoacideve. Nëse dikush dallon sipas gjinisë, një raport pozitiv gjithashtu rezulton për neuteratet. Kjo tregon, një rritje të lartë, përmbajtje të lartë të rezes së mishit. Natyrisht, niveli i mishit është më i lartë tek meshkujt e kastruar dhe është më i ulët tek dosat.

Në një tjetër eksperiment të ushqyerit me meshkuj të kastruar, u zbulua se kur ushqimi jepej ad libitum në derrat me peshë 80 kg u rrit, pjesa e mishit të stomakut pati një rritje më të lartë. Kjo kërkon që kafshët meshkuj dhe femra duhet të lihen veçmas, pasi që ushqimi në ad libitum nuk rezulton me ndonjë humbje të përmbajtjes së mishit në femra. Sipas Hülsenberger ushqimi në fazën përfundimtare të majmërisë me një maksimum prej 70 kg peshë e gjallë ad libitum dhe më pas me kufizime një recetë më të kufizuar në energji (34-36 MJ për kafshë/ditë), pjesa e rezes së mishit nuk përkeqësohet.

Derrat në fund të majmërisë sipas Hülsenberger janë në gjendje të arrijnë rritjen më të lartë me performancën më të mirë të therjes nën kushte optimale të ushqyerjes dhe kushteve të tjera mjedisore. Sidoqoftë, suksesi i tij është i dukshëm vetëm nëse plotësohen parakushtet e mëposhtme: duhet të përshtatet me kërkesat e derrit, mbi të gjitha, kërkesa e lartë për aminoacidet, energjinë dhe substancat aktive në fazën e gicave në rritje duhet të mbulohet plotësisht. Shtesat ditore të larta mund të arrihen vetëm me një normë të lartë të ushqyerjes në kohën e duhur. Kjo do të thotë se potenciali i lartë i rritjes në fazën e gicave në rritje duhet të përdoret plotësisht. Rritja e kompensimit në fazën përfundimtare çon në dështim. Rritja e shtesës ditore çon në një impuls ekonomik më të kënaqshëm. Shtesat ditore nuk ndikojnë negativisht në cilësinë e trupave kur gjenetika, ushqimi dhe mënyra e të ushqyerit janë të drejta. Ushqimi sipas konceptit Schaumann, i kombinuar me kafshët me performancë të lartë, favorizon një majmëri të suksesshme dhe mish konkurrues në treg.

**Fig. 1: Proteina, yndyrna dhe energjia ditore krahasuar me të dhëna nga literatura (rreth 25-100 kg) (Referenca: Abel et al)**


Origjina e derrit	Rritje ditore g	Proteina g/ditë	Yndyrna g/ditë	Energjia MJ ME/ditë
Hülsenb. Hibrid*	816	127	214	11.5
DL**	836	108	326	15.4
LB***	828	124	262	15.4
(DL x DE) x DL****	927	116	291	14.4

\*Abel et al., 1988 \*\*Osfage et al., 1986 \*\*\* Gütte., 1978 \*\*\*\* Abel et al., 1983

**Fig. 2: Raporti i rritjes ditore**

Masë e gjalle në kg	Substancat e trupit në g	Proteina ditore në g	Yndyrna ditore në g	Energjia ditore në MJ	Rritja Proteina g/kg	Rritja Yndyrna g/kg	Rritja Energjia MJ/kg
20	500	91	65	4.8	188	130	9.6
40	650	113	135	8.0	174	210	12.5
60	750	125	220	11.8	167	295	15.7
80	800	125	300	14.9	156	375	18.7
100	750	113	340	16.1	151	450	21.5

**Fig. 3: Raporti midis rritjes ditore në g (RD) dhe ushqimit ditor në kg**



Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk  
Tel: +355 (0)68 402 6311  
e-mail: agri@ap.com.al



## 2. NATUPIG: IDEAL PËR DERRAT E MAJMËRISË

### NATURAL – I SHËNDETSHËM – EFIKAS

Përpunuar nga Kristian Maka




**Linja e re e produkteve NatuPig ofron avantazhe jo vetëm për kafshët, por edhe për mjedisin. NatuPig nga Schaumann rrit potencialin premikseve të fazës së majmërisë dhe mundëson racione ushqimore me sojë të reduktuar.**

Me produktet NatuPig, mund të krijohen përzierje ushqimore të reduktuara në proteina dhe fosfor, duke iu përmbajtur ligjit/kodit të mbetjeve. Këto mundësi të reja (Tab. 1) konfirmohen nga përvoja praktike.

#### PËRBËRËS TË RINJ AKTIVË

Përveç mikroelementeve Aminotrace, të lidhur në mënyrë organike, në produktet NatuPig përdoren tre përbërës aktivë plotësisht të rinj (nga ISF Schaumann Research). Ceragel - produkti i algave - dhe Cerabac - probiotiku i ri Schaumann - mbështesin tretjen dhe shëndetin optimal të derrave.

Ceravital XP - produkti i ri i fermentuar me një efekt të ngjashëm me enzimën - përmirëson disponueshmërinë e lëndëve ushqyese në ushqim (Tab. 2).



**Tab. 1:** Mundësi të reja në majmërine e derrave me NatuPig

## RUAJTJA E RESURSEVE DHE OPTIMIZIMI I KOSTOVE TË USHQIMIT

Në përzierjen e ushqimit mund të zvogëlohet me 2 deri në 3% përdorimi i miellit të sojës, pa përdorimin shtesë të aminoacideve. Ky është një potencial i lartë kursimi për fermat individuale. Për 1000 vende majmërie, mund të kursehen deri në 24 t/vit miell soje, nëpërmjet të ushqyerit me NatuPig (Tab. 3).

## RUAJTJA E RESURSEVE DHE OPTIMIZIMI I KOSTOVE TË USHQIMIT

Ferma Rottler nga Bergen (sistemi pjesërisht i mbyllur, 250 dosa PIC, 1200 vende për majmëri me ushqim të lëngshëm) ka përdorur përzierje për majmëri me përbërësin aktiv NatuPig Ceravital XP që nga pranvera 2019 (Tab. 4).

Krahasuar me përzierjet e mëparshme, në të gjitha periudhat e majmërisë, me të njëjtën përmbajtje aminoacide të ushqimit mineral (lizinë, metioninë dhe treonin) është përdorur 2% më pak miell soje HP.

Me një nivel të lartë performance, 871 g shtim ditor dhe një raport të konvertimit të ushqimit prej 1:2,72, edhe pas ndryshimit të ushqimit me më pak miell soje, pa kompensim nëpërmjet aminoacideve të lira, përqindja e mishit pa dhjamë mbeti në një nivel të lartë mbi 60% (Tab. 5).

Për të njëjtat të ardhura nga shitjet, kalimi në ushqimin mineral NatuPig redukton përdorimin e miellit të sojës duke ulur kostot e ushqimit dhe ekskrecionet e lëndëve ushqyese.

Tab. 2: Avantazhet e CERAVITAL XP

- zvogëlon sasinë e miellit të sojës në ushqim deri në 3%
- siguron një përdorim dukshëm më të mirë të proteinës së ushqimit
- ofron më shumë siguri me nivelet e luhatshme të proteinave në drithëra/vakt soje
- përdor më shumë energji nga ushqimi në metabolizmin e derrave
- redukton ekskrecionet N dhe kursen hapësirën dhe kostot e asgjësimit

Tab. 3: Potenciali i reduktimit të përdorimit të miellit të sojës nëpërmjet NatuPig

	1.000 Vende majmërie 792 t Konsumi i ushqimit	2.000 Vende majmërie 1.584 t Konsumi i ushqimit
-2 % Miell soje në përzierjen e ushqimit	-16,0 t	-32,0 t
-3 % Miell soje në përzierjen e ushqimit	-24,0 t	-48,0 t


Tab. 4: Përzierje majmërie në fermën Rottler

		Para-majmëri	Majmëri e mesme	Majmëria përfundimtare
Gruri	%	49,0	57,0	41,6
Elbi	%	33,0	29,8	49,8
HP-Miell Soje	%	15,0	10,2	5,6
NatuPig M 100	%	3,0	3,0	3,0
Energji	ME MJ/kg	13,1	13,1	12,9
Proteinë krudo	%	17,1	15,3	13,4
Lizinë	%	0,94	0,82	0,70

Tab. 5: Përzierje majmërie në fermën Rottler

Vlerësimi i therrjeve,  
% MFA

Me përdorimin e NatuPig M





### 3. FURNIZIMI I DUHUR ME KALCIUM DHE FOSFOR

*Përgatitur nga Franz Riegler, Këshillues i Schaumann dhe Aksioner i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Kristian Maka*



**Ushqimi i derrave** – Ushqimet e përziera dhe ushqimet minerale kërkojnë gjithmonë racione të përshtatura në mënyrë që të sigurohet furnizimi i kafshëve me lëndë minerale. Në artikullin e mëposhtëm shpjegohet se si mund të kursehen para duke optimizuar dozat e kalciumit dhe fosforit.

Kalciumi dhe fosfori janë lëndë minerale që ndihmojnë formimin e kockave. Për këtë arsye, furnizimi i pamjaftueshëm me kalcium dhe fosfor nuk mund të zbulohet brenda një kohe të shkurtër. Problemet kockore nga mungesa e lëndëve minerale shfaqen me kalimin e kohës. Përveç ndikimit të tyre në fortësinë e kockave, kalciumi (Ca) dhe fosfori (P) luajnë rol të rëndësishëm në metabolizimin e energjisë dhe funksionimin e muskujve.

Prandaj mosfunksionimi i qelizave të muskujve të zemrës, aparatit tretës, gjendrës së qumështit dhe të mitrës vijnë si pasojë e mungesës së kalciumit.

Kafshët, të cilat pas pjelljes preken me sindromën MMA (Mastitis-Metritis- Agalakti), shfaqin ulje të vlerave të kalciumit në gjak. Shkak për këtë mund të jetë sasia e ulët e kalciumit në ushqim. Por shumë shpesh vërehet situata e kundërt: ushqim me sasi të lartë kalciumi. Kafshët sinjalizohen për praninë e një sasi të mjaftueshme të kalciumit, e cila depozitohet në kocka. Pak para pjelljes rritet ndjeshëm nevoja e dosës për kalcium, por kalciumi është i përqëndruar në kocka. Kjo është një dukuri e zakonshme te dosat e vjetra.

Përqëndrimi i kalciumit në gjak ulet për shkak se sasia e tij në qumësht mbahet konstante.

Mungesa e kalciumit mund të çojë në shtyrjen e datës së pjelljes dhe kontraktimin e muskujve të mitrës. Teprica e kalciumit nxirret nga veshkat nëpërmjet rrugëve urinare, në të cilat formohen kristale që dëmtojnë veshkën dhe fshikëzën. Kjo shkakton infeksione të rrugëve urinare, të cilat ndikojnë negativisht në procesin e riprodhimit të dosave. Kalciumi i marrë nga ushqimi dhe përpunimi i mëtejshëm në aparatit tretës, kalon në mekanizma rregullatore komplekse, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në aparatit tretës. Vitamina D luan një rol të rëndësishëm veçanërisht në absorbimin e kalciumit nga zorrët.

#### Furnizimi me kalcium dhe fosfor

Kalciumi dhe fosfori janë ndër elementët kryesorë, që duhet t'u jepen derrave në sasinë e duhur. Nëse merret sasi më e madhe e një minerali, atëherë kjo do të ndryshojë absorbimin e mineraleve të tjera dhe oligoelementëve. Sasia e lartë e kalciumit ul ndjeshëm absorbimin e fosforit dhe magnezit. Kur përdoret panxhar i presuar me përmbajtje të lartë kalciumi, duhet të përshtatet gjithashtu edhe sasia e përzjerjes së lëndëve mineralo-vitaminoze.

Fosfori i pranishëm në ushqimet bimore, si për shembull te drithërat dhe te soja kokërr, mund të asimilohet vetëm në sasi të vogla nga derri, sepse sasia më e madhe e fosforit e pranishme në drithëra ndodhet në formën e fitazës së fosforit. Këtë formë mund t'a zërthejë vetëm fitaza e cila nuk ndodh në sistemin gastrointestinal të derrit. Në disa ushqime të tilla si gruri dhe thekra mund të vërtetohet aktivitete të fitazës. Tretshmëria e fosforit të elbit është 45% dhe e grurit 65%. Misri ka tretshmëri të ulët, 15%.

Për të përmirësuar furnizimin me fosfor është i këshillueshëm përdorimi i fitazës, sepse rrit tretshmërinë e fosforit nga racionet bimore. Nëpërmjet përdorimit të fitazës (mesatarisht 500 FTU) tretshmëria e fosforit nga komponentët bimorë mund të jetë 65%.

## Nivelet e rekomanduara të raportit Ca:P

Ca g/kg TM		P g/kg TM	Ca : P	Ca: vP
<b>Ushqimi në barrsmëri</b>				
<b>Ushqim në laktacion</b>	7,0	5,0	1,4 : 1	<b>2,5-3 : 1</b>
<b>Prestarter</b>	8,5	6,5	1,3 : 1	<b>2,5-3 : 1</b>
<b>Ushqim për gica (8-20 kg)</b>	8,5	6,0	1,4 : 1	<b>2,5-3 : 1</b>
<b>Ushqim për gica (20-30 kg)</b>	7,5	5,5	1,4 : 1	<b>2,5-3 : 1</b>
	7,0	5,0	1,4 : 1	<b>2,5-3 : 1</b>
<b>Majmëri</b>	7,0	5,0	1,4 : 1	<b>2,5-3 : 1</b>
<b>fillestare/universale</b>	6,5	4,5	1,4 : 1	<b>2,5-3 : 1</b>
<b>Majmëria e mesme</b>	6,5	4,5	1,4 : 1	<b>2,5-3 : 1</b>
<b>Majmëri përfundimtare</b>				

Thelbësor për një furnizim të mirë, është raporti i balancuar i kalciumit dhe fosforit. Raporte të vogla ose shumë të mëdha mund të çojnë në probleme shëndetësore, si për shembull një furnizim i lartë me fosfor dhe një raport i Ca:P më i vogël se 1:1, ul fortësinë e kockave.

Nivelet e rekomanduara të përdorimit Ca dhe P dhe raportet ndërmjet tyre mund t'i gjeni në tabelën e mësipërme. Një kërkim mbi përzierjet në laboratorin ushqimor të Rosenau-t, hodhi dritë mbi të ushqyerit me lëndë minerale. Nga përdorimi i fitazës mikrobike priten sasi të larta të fosforit.

### Përfundim

Përmirësimi i cilësisë së rritjes së dosave dhe majmërisë kërkon një furnizim të mjaftueshëm me kalcium dhe fosfor. Sidomos zhvillimi i thundrave, sistemi skeletor, pesha e lindjes, prodhimi i qumështit dhe procesi i rritjes mund të ndikohen negativisht nga mosfurnizimi i mjaftueshëm. Prandaj është e dobishmetë verifikohet përmbajtja e kalciumit dhe fosforit në racionet ushqimore dhe të merren masa të menjëhershme në rastet e mbifurnizimit ose mosfurnizimit me këto elementë.

Për më shumë informacion:



**QF PB** Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve

**Austria Praemix shpk**  
**Tel:** +355 (0)68 402 6311  
**e-mail:** agri@ap.com.al

#### 4. KËSHILLA PËR FERMAT E MBARËSHTIMIT TË DOSAVE ME RENDIMENT MBI 30 GICA NË VIT

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann, aksioner i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Kristian Maka

*Rendimenti i lartë përcakton rentabilitetin në rritjen e gicave. Me anë të rritjes dhe intensifikimit të prodhimit, mbarështuesit e gicave mund të rrisin ndjeshëm rendimentin e fermave. E ardhmja përcaktohet gjithmonë e më shumë nga cilësia e menaxhimit.*

Një rol të rëndësishëm në rritjen e rendimentit në pjellje ka edhe niveli i gjenetikës së aplikuar.

Ndërveprimi i të gjithë faktorëve vendos mbi rentabilitetin në rritjen e gicave. Revista „Sukses në stallë“ realizoi me klientët e Schaumann një intervistë mbi menaxhimin e fermave me këtë rendiment.

##### Rritja e paradosave dhe futja në prodhim

Tendenca e fermave moderne në ditët e sotme është heqja dorë nga remonti në fermë. Sot praktikohen disa metoda të paradosave në prodhim, me qëllim sigurinë e shëndetit në tufë. Një bazë e rëndësishme për këtë, është futja e një kontigjenti me shëndet maksimal. Futja e paradosave në tufë bëhet duke iu përshtatur ritmit të fermës çdo gjashtë deri në tetë javë, në një moshë nga 140 deri në 180 ditë. Një interval më i gjatë do të ndikonte në strukturën e tufës dhe do të kërkonte kapacitete më të larta dhe kujdesje të orientuar kundrejt paradosave.

Paradosat e blera, ushqehen me racione të përshtatura me energji, proteina dhe mikroelementë (me përmbajtje të lartë të fosforit dhe vitaminës E). Një racion tipik për paradosat në rritje, paraqitet në tabelën 1.



Përshtatja e kujdesshme e kafshëve të reja me popullacionin e bakteve të tufës ekzistuese ndodh nëpërmjet një programi të nevojshëm të vaksinimit përfshirë periudhën dyjavore të pritjes.

Rikthimi në stallë i dosave të vjetra mund të jetë shumë stresues. Mbajtja e dosave të reja mbas ndërimit në grupe të veçanta ka rezultuar pozitive. Ndërzimi i hershëm (2 ditë) i paradosave shkakton më shumë punë (në fundjavë), por siguron furnizim të mjaftueshëm të gicave në periudhën e mëmëzimit.

Racionet ushqimore të ushqimit të dosave

		Futja në prodhim e dosave të reja	Ushqimi ditor	Ushqimi në laktacion
Grurë	%	19,0	10,0	35,0
Eib	%	55,0	65,5	35,5
Mielli soje 42 RP	%	8,0	8,0	17,5
Krunde gruri	%	7,0	4,0	-
Melasse-Schnitzel	%	6,0	7,0	5,0
Vaj soje	%	1,0	0,5	2,5
SCHAUMANN-FASERKONZENTRAT	%	0,5	2,0	0,5
SCHAUMACID i lëngshëm	%	-	-	0,5
SCHAUMALAC JS 55 ATG	%	3,5	-	-
SCHAUMALAC Z 60 SPECIAL ATG	%	-	3,0	4,0
Përbërësit për kg				
ME (DLG)	MJ	12,2	11,9	13,0
ME (MFF)	MJ	12,3	12,0	13,0
Protein e papërpunuar	%	13,6	13,4	16,4
Fibër e papërpunuar	%	5,9	7,0	5,0
Kalcium	g	8,5	6,6	8,4
Fosfor	g	5,5	4,6	4,7
Lisin	g	7,5	7,4	9,7
BONVITAL		+++	+++	+++
AMINOTRACE		+++	+++	+++
AKTIPOSE		-	+++	+++

##### Qendra e inseminimit

Përpara futjes në qendrat e inseminimit, rekomandohet lënia e lirë e dosave (20 deri në 30 minuta nën mbikqyrje). Në fermat e suksesshme shpesh aplikohet për këtë fazë ushqim special ose ushqimi për laktacion. Kjo dhe faza fillestare e barsjes shikohet shpesh edhe si përmirësim i kushteve. Në varësi të kushteve sigurohet ushqim me energji 40 MJ ME në ditë. Këto teknika sigurojnë gjenetiksht rendiment të lartë dhe numër të lartë të gicave në pjellje.

##### Dosat barëse

Mbajtja në grupe, me madhësi nga 16 deri në 18 dosa është standarde. Shumë ferma që përdorin teknikat e ushqimit të thatë në maternitetin e kafshëve, përdorin në sektorin e pritjes teknika të ushqimit të lëngshëm. Rezultati: një ngopje e dosave me ushqim voluminoz dhe shpesh përdorimi i komponentëve ushqimor të lirë si p.sh. hurrë. Deri në ditën e 85 të barsjes aplikohet brenda tufës e njëjta sasi ushqimi (rreth 32-38 MJ ME/ditë). Mbas ditës së 85-të të mbarsjes sasia e ushqimit rritet ndjeshëm mbi 50 MJ ME në ditë deri para periudhës së pjelljes (grafiku 2).

Fermt monitorojnë intensivisht gjendjen e dosave në këtë periudhë. Për të garantuar një pjellje pa probleme dhe mëmëzim të suksesshëm është i rëndësishëm një ushqim cilësor në fazën e mbarsjes, siç paraqitet në tabelën 1. Kjo siguron jo vetëm ngopjen e dosave, por komponentët e tij aktiv ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e gicave që në barsmëri.

Përmbajtja e kalciumit në ushqimin e dosave duhet për faza të ndryshme në mënyrë që të sigurohet furnizimi me qumësht në të gjitha fazat.

## Zona e pjelljes

Normalisht një javë përpara datës së planifikuar të lindjes dosat kalojnë në maternitet (dita e 108-të e mbarsjes) dhe aplikohet ushqim për fazën e laktacionit. Disa ferma aplikojnë racione ushqimore speciale të pasur me celulozë dhe energji (deri dy ditë pas pjelljes). Përzgjedhja e ushqimeve shtesë si Schauma-Omni Acid ndihmojnë në sistemin tretës. Këto masa paraprake të lindjes aplikohen në kafshë të veçanta të tufës.



Në ditën e pjelljes sasia e ushqimit reduktohet ndjeshëm dhe pastaj shtohet në mënyrë graduale për 8-10 ditë nga 400 deri në 500 g. Kontrollat individuale në këtë fazë janë shumë të rëndësishme. Nëse nuk pranohet shtimi i ushqimit për 2-3 ditë mbetet konstant pastaj rritet. Fillimisht në shumë ferma dosat ushqehen dy herë në ditë dhe vetëm pasi arrijnë në nivelin Ad libitum ushqehen tre herë në ditë.

Në varësi të kohëzgjatjes së mëmëzimit duhet të vëzhgohet pas javës së 2-të dhe të 3-të të laktacionit gjendja e dosave dhe të përshtatet ushqimi sipas nevojave individuale, sidomos në teknikat e ushqimit të lëngshëm në laktacion.

## Bokset e pjelljes dhe faza e shkëputjes

Zhvillimi optimal i gicave kërkon një konsum sa më të hershëm të kulloshtërës. Për të kompensuar furnizimin me lëngje aplikohet të ushqyerit me elektrolite. Sistemimi i gicave të lindur duhet të përfundojë mundësisht në ditën e tretë.

Pjelljet në numër të mëdha (14-16 gica për dosë) kërkojnë ushqyerje të hershme. Praktiohen disa teknika si për shembull pije me qumësht Bi-Lactal Premium në sisteme me enë pirëse. Që në bokset e pjelljes aplikohet përdorimi i ushqimit bimor të tillë si Prestater të shijshëm dhe me tretshmëri të lartë si Schauma-Premium ose Ferkelin Wean. Këto ofrohen në ditët e para pas shkëputjes, në formë të pastër (në kohë të shkurtër ndërzimi) ose të përziera me ushqimin e fazës së parë të rritjes së gicave.

Gicat e vegjël duhet të ushqehen pas shkëputjes pavarësisht ushqimit aktual edhe me ushqim të butë. Prandaj ofrohet në sasi të vogël 2-3 herë në ditë për shembull me Ferkelin Wean të përzier me ujë të ngrohtë. E rëndësishme është që të përzihet aq shumë sa gicat në ditën e katërt të hanë edhe nga ushqimi i tyre normal edhe nga automatet me ushqim të thatë.

Vetëm te gicat shumë të vegjël do të vazhdohet kjo lloj ushqyerje për 10 deri në 14 ditë. Vendosija e enëve për pirje në bokset me elektrolitë ne tre ditët e para dhe shtimi i acideve (SchaumaCid Drink) në dy javët e para nxit konsumim të hershëm të ushqimit dhe shëndetin e zorrëve të gicave. Në fund të fazës së parë fermtat e suksesshme përdorin ushqim të gatshëm Schauman ose ushqim të bërë vetë i përbërë nga drithëra, sojë e shtypur, ushqim plotësues dhe mineral Schaumann.

## Përmbledhje

Rritja e kërkesave për cilësi në menaxhim karakterizon zhvillimin në fermtat e mbarështimit të gicave. Sa më i lartë rendimenti, aq më mirë do të jetë rentabiliteti. Fermtat me menaxhim të një niveli të lartë prodhojnë më shumë se 30 gica për dosë në vit. Përkujdesja e gicave fillon që me dosën barëse.

Një koncept i koordinuar i të ushqyerit si për shembull ai i zhvilluar nga Schaumann garanton siguri të lartë dhe përdor rezervat ekzistuese në të gjitha fazat e rritjes. Rëndësinë më të madhe të rritjes së rendimentit e ka përparimi i gjenetikës. Së fundmi bashkëveprimi i të gjithë faktorëve vendos mbi efikasitetin e rritjes së gicave.

**Për më shumë informacion:**



**QF** Qendra e Formimit  
**PB** Profesional të Blegtorëve

**Austria Praemix shpk**  
**Tel:** +355 (0)68 402 6311  
**e-mail:** agri@ap.com.al

## 5. NEVOJA ENERGITIKE E DOSËS

*Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann, aksioner i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Kristian Maka*

***Një faktor i rëndësishëm për hartimin e një racioni optimal ushqimor për dosat është përgatitja e një bilanci energjitik gjatë periudhës së mëmëzimit.***

Bilanci energjitik i një dose gjatë periudhës së mëmëzimit mund të llogaritet në këtë mënyrë:

Konsiderohet se një gic në lindje peshon rreth 1,5 kg dhe pas 4 javësh kur shkëputet nga gjiri peshon afërsisht 8 kg. Gjatë periudhës 28 ditore të gjirit, një gic merr mesatarisht 1 litër qumësht në ditë, për një rritje prej 6,5 kg peshë të gjallë nevojitet për çdo kg rritje 4,3 litër qumësht. Dosa pas pjelljes së 10 gicave prodhon 280 kg qumësht gjatë gjithë periudhës së mëmëzimit.



Për prodhimin e 1 litër qumësht dosës i nevojitet 7,3 MJ nga racioni ushqimor. Për të prodhuar një sasi prej 10 litra qumësht në ditë, një dose i nevojitet të marrë një sasi energjie prej 73 MJ energji, të përdorshme prej racionit ushqimor. Nevoja normale e konsumit llogaritet sipas kësaj formule:

**Pesha e gjallë 0,75 x 4,44. Bazuar në këtë llogaritje kuptojmë që një dose të re që peshon 180 kg i nevojitet një sasi energjie prej 94,6 MJ, ndërsa një dose të vjetër që peshon 230 kg i nevojitet 99 MJ energji.**

Një dosë gjatë periudhës së mëmëzimit nuk mund të plotësojë nevojat e saj ditore të energjisë vetëm nga racioni ushqimor. Ajo shkrin gjithashtu dhe yndyrnat e trupit. Për çdo kilogram humbje në peshë dosa mund të shfrytëzojë 25 MJ energji nga rezervat yndyrore të trupit.

Për një humbje në peshë të gjallë prej 14 kg gjatë periudhës së mëmëzimit llogaritet një sasi prej 12,5 MJ në ditë. Në qoftë se gicave u jepet ushqim shtesë atëherë për çdo MJ energji të marrë nga ky ushqim, gicat mund të kursejnë 1,58 MJ energji nga dosa. Në qoftë se gicat marrin 0,4 kg ushqim shtesë me 14,3 MJ energji në ditë, rezultati total është 9 MJ energji.

Nëse marrim si shembull një dosë të vjetër që ka nevojë për 99 MJ energji në ditë duhet të rishikohet llogaritja në këtë mënyrë: nga nevoja e konsumit mund të zbriten sasia e energjisë nga humbja e peshës së dosës si dhe energjia e marrë nga të ushqyerit e gicit me ushqim shtesë.

Pjesa që mbetet prej 77,5 MJ duhet të plotësohet totalisht nga ushqimi. Nëse dosa konsumon 5 kg ushqim, atëherë dendësia e energjisë në ushqim duhet të jetë 15,5 MJ, ndërsa në qoftë se konsumon 6 kg ushqim atëherë duhet të përmbajë 12,9 MJ energji.

Në qoftë se nevoja e mësipërme për energji nuk plotësohet, atëherë dosa duhet ta plotësojë këtë mungesë nga rezervat e trupit. Pasojat janë: një strukturë e keqe trupore si dhe ulje e rendimentit të qumështit.

### **Një start i sigurt në jetë: SCHAUMA-FERM FIT**

Çdo fermer është në dijeni të faktit që gicat e sapolindur nuk kanë ende mekanizmat e vet mbrojtës ndaj shkaktarëve të sëmundjeve. Ata vijnë në botë të pambrojtur dhe janë të ekspozuar edhe ndaj mikrobeve relativisht të padëmshme të mjedisit të ri. Ndërmarrja në kohë e masave mbrojtëse është e domosdoshme për të evituar humbjen e gicave dhe produkti Schauma-Ferm Fit ofron mundësi të reja për fermerët e dosave.

Mbrojtjen më të mirë ndaj sëmundjeve në orët dhe ditët e para të jetës e ofron kulloshtira. Ky produkt përmban nivel të lartë të substancave mbrojtëse për imunitetin, substanca të ashtuquajtura imunoglobulina, të cilat janë jetësore për shëndetin e gicit gjatë tre javëve të para të jetës. Mekanizmat mbrojtëse të imunitetit zhvillohen gradualisht pikërisht pas javës së tretë, periudhë në të cilën organizmi i gicave mund të reagojë në mënyrë aktive kundër shkaktarëve të sëmundjes.

Mbrojtja e imunitetit nëpërmjet qumështit të dosës nuk është gjithmonë optimale, ndoshta sepse gicat e lindur nuk e marrin në kohën e duhur kulloshtren ose sepse çerdhja e gicave është tepër e madhe në numër dhe jo të gjithë gicat e marrin kulloshtren. Në rastin më të keq nga mos konsumimi i qumështit të kulloshtres së dosës, të vegjlit nuk do të marrin të gjithë antitruapat maternale ose substancat imune, si rrjedhim nuk do të kenë mbrojtje kundrejt sëmundjeve.

Pasojat janë humbje e gicave, tumore kanceroze dhe predispozitë e lartë ndaj simptomave, të tilla si diare dhe kollë. Nëse krahas këtyre shtohen gjithashtu dhe kushtet e papërshtashme atmosferike (temperatura të ulta, korrent ajri, nivel i lartë lagështie), atëherë suksesi ekonomik i mbajtjes së gicave dëmtohet rëndë.

Por edhe konsumimi i duhur i qumështit të dosës në orët e para të jetës mund të përmirësojë sigurinë në rritjen e gicave. Produkti i ri Schauma-Ferm Fit krijon kushtet për t'iu lehtësuar të gjithë gicave startin në jetë.

### **Çfarë është Schauma-Ferm Fit?**

Schauma –Ferm Fit është një pastë, e cila i jepet gicit të posalindur dhe përmban nivel të lartë vitaminash dhe një probiotik, të lidhura në një material mbartës duke siguruar një stabilitet të substancave aktive.

### **Si aplikohet Schauma-Ferm Fit?**

Avantazh i madh i produktit Schauma-Ferm Fit është lehtësia në përdorim. Menjëherë pas pjelljes (maksimalisht 12 orë pas pjelljes) i jepet gicit një njësi Schauma-Ferm Fit nga pompa e dozimit. Në ditën e tretë pas lindjes gicat duhet të marrin përsëri një njësi të produktit. Këshillohet që produkti Schauma-Ferm Fit të përdoret sa më herët të jetë e mundur për të garantuar një efektivitet të lartë. Parimisht duhet që të gjithë gicat të marrin produktin Schauma-Ferm Fit dhe jo vetëm më të vegjlit e tufës.

### **Si ndikon Schauma-Ferm Fit?**

➤ Schauma-Ferm Fit ka efekt parandalues. Ky produkt stimulon forcën mbrojtëse dhe zvogëlon jo vetëm humbjet e gicave më të dobët dhe më të vegjël në peshë, por nxit gjithashtu dhe rritjen e gicave të tjerë që janë normal në peshë.

➤ Schauma-Ferm Fit parandalon diarrenë, duke parandaluar shtimin e koliformeve në mukozë, veçanërisht në pjesët e pasme të zorrëve.

➤ Schauma-Ferm Fit rrit fuqinë mbrojtëse të vetë trupit, kështu substancat për mbrojtjen e imunitetit që merren nga produkti Biestmielch formohen më herët në organizëm.

➤ Schauma –Ferm Fit rrit rezistencën, me anë të pasurimit me vitamina të zgjedhura, të cilat nuk mund të formohen vetë në javët e para të jetës dhe parandalon zhvillimin e disa shkaktarëve të veçantë sëmundjesh (koliformeve). Duke përdorur këtë produkt gicat janë në gjendje më të mirë dhe janë më të mbrojtur nga ndotja e ambientit.

### **Anët pozitive të produktit Schauma-Ferm Fit:**

- ✓ Aplikimi sa më i hershëm sjell mbrojtje më efektive
- ✓ Përdorim i thjeshtë
- ✓ Zhvillimi i njëtrajtshëm i rritjes së të gjithë gicave, veçanërisht në tufa të mëdha
- ✓ Parandalon kryesisht diarrenë
- ✓ Humbje më e ulët e gicave
- ✓ Numër më i madh gicash të rritur për dosë në vit

Rentabiliteti i rritjes së gicave përcaktohet kryesisht nga numri i gicave të rritur për dosë në vit.

Produkti Schauma–Ferm Fit sjell përfitime ekonomike për fermat në përgjithësi, si edhe për ato që nuk mund të përballojnë një numër të lartë të ngordhjeve të gicave.

**Për më shumë informacion:**



**Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve**

**Austria Praemix shpk Tel:**

+355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

## 6. KËRKESA TË MËDHA PËR USHQIMIN E GICAVE

Përpunuar nga Kristian Maka

***Për një performancë optimale të majmërisë të derrat, si dhe për shtim të lartë peshe, është shumë e rëndësishme një dietë efikase për gicat.***

Parakusht për këtë është pesha e lartë e lindjes prej të paktën 1.4 kg, mundësisht 1.5 kg dhe me pjelle të ekuilibruar. Te gicat me peshë më të vogël rriten humbjet dhe ritmet e rritjes së majmërisë ulen. Gicat e vegjël duhet të peshojnë rreth 8 kg në javën e 4 të jetës dhe 28 kg në javën e 10 të jetës. Ky nivel mund të arrihet vetëm duke siguruar kushte strehimi, higjienë dhe ushqim sa më të mirë.

Duhet të merren parasysh parimet e mëposhtme të të ushqyerit:

- duke u mësuar me ushqime të ngurta, me bazë bimore, të pasura me niseshte në një fazë të hershme;
- furnizim i vazhdueshëm me ushqim të shijshëm dhe me cilësi të lartë;
- ndryshimi gradual i ushqimit gjatë gjithë procesit të rritjes;
- përdorimi i aditivëve të provuar dhe aplikimi në kohë i masave për të filluar ushqimin dietik

Fillimi me kulloshtrë

Të ushqyerit e menjëhershëm të gicave të porsalindur me kulloshtrë është thelbësore. Marrja e mjaftueshme e kulloshtrës në tre orët e para të jetës është e rëndësishme në mënyrë që të sigurohet imunizimi i domosdoshëm i të porsalindurit. Duke filluar nga 24 deri në 36 orë pas lindjes gicat nuk mund t'i përdorin më antitruapat për shkak të uljes së përshkueshmërisë së murrit të zorrëve.

Gjatë dy javëve të para të jetës nevojat për lëndë ushqyese mbulohen kryesisht nga qumështi i dosës. Suplemente me cilësi të lartë në formën e një Prestarter-i mund të përdoren që në javën e 2-të të jetës. Ato përdoren kryesisht për formimin e enzimave të rëndësishme të tretjes, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të gicit. Suplementi stimulon, mbështet dhe stabilizon tretjen.

Prestarter-ët zakonisht janë të pajisur me përbërës me cilësi të lartë, kryesisht produkte qumështi. Deri në javën e 10-të të jetës derrat me peshë gati 30 kg konsumojnë 35 deri në 38 kg ushqim. Edhe nëse kjo sasi ushqimi duket e vogël, kërkesat shumë të ndryshme për ushqim gjatë kësaj kohe duhet të merren parasysh duke përdorur lloje të ndryshme ushqimi. Tabela rendit llojet e ndryshme të ushqimit që janë të dobishme për arritjen e rezultateve optimale të rritjes.

Krahasuar me rekomandimet e mëparshme, për shkak të rritjes më të shpejtë të gicave dhe përbajtjes më të lartë të mishit, gicat pritet të kenë një nevojë të përgjithshme të shtuar për aminoacide. Në të kundërt, supozohej se gicat do të kishin një kërkesë shumë të lartë të kalciumit dhe fosforit. Praktika e të ushqyerit ka treguar që nivelet më të ulëta, veçanërisht kalciumi, mund të menaxhohen pa çekuilibruar zhvillimin e gicave dhe pa pasur frikë nga humbja e performancës. Në nivelet e elementëve gjurmë dhe vitaminave kishte vetëm ndryshime të vogla.

Katër lloje të ushqimit

Në parim, rekomandohen katër lloje të ushqimit: Prestarter, 5 deri në 8 kg peshë të gjallë, një ushqim special për shkëputjen nga 8 deri në 12 kg dhe dy ushqime të ndryshme për rritjen e derrave deri në 20 kg dhe nga 20 deri në 30 kg peshë e gjallë. Në fazën e rreth 8 deri në 12kg peshë të gjallë, mund të përdoret një ushqim i veçantë diete për çrregullimet e tretjes në vend të ushqimit normal të shkëputjes nga gjiri.

Faza Prestarter fillon në javën e 2-të të jetës. Zakonisht ky është ushqim i plotë me cilësi shumë të lartë. Faza stresuese pas shkëputjes nga gjiri është gjithmonë kritike. Gjatë kësaj kohe të ushqyerit duhet të jetë sa më i butë që të jetë e mundur. Është provuar e dobishme që Prestarter të përdoret përtej kohës së shkëputjes së qumështit dhe pastaj gradualisht ta përzieni atë me ushqimin për shkëputjen nga gjiri ose ushqimin për rritjen e gicave. Në rastin e një periudhe të gjatë gjiri, Prestarter-i mund të përzihet me ushqimin vijues para se të hiqet nga gjiri. Nëse ka probleme me ndryshimin e ushqimit, siç janë çrregullimet e tretjes, atëherë rekomandohet përdorimi i ushqimit special dietik. Diarreja e shpeshtë mund të parandalohet me një ushqim më pak të përqendruar, për shembull me ushqim me përbërje mielllore, me një strukturë më të ashpër, sepse gicat e përtypin më mirë dhe e marrin atë më ngadalë duke parandaluar çrregullimet e tretjes që mund të ndodhin.

Në mënyrë që të shmangen kolapset gjatë rritjes, ndryshimi nga një ushqim në tjetrin duhet të bëhet me një fazë të mjaftueshme tranzicioni duke planifikuar një periudhë përzierjeje prej rreth pesë ditësh.

Pesha e gjallë	Prestarter 5 deri 8 kg		Ushqim zëvendëses 8 deri 12 kg		Ushqim dietik 8 deri 12 kg			Ushqim për rritjen e gicave I 12 deri 20 kg			Ushqim për rritjen e gicave II 20 deri 30 kg	
Energjia(ME)MJ	13,8	13,4	13,8	13,4	13,8	13,4	13,0	13,8	13,4	13,0	13,4	13,0
g Lysin/MJME	1,00		1,00		0,95			0,95			0,85	
Lysin** )*** )g	13,8	13,4	13,8	13,4	13,1	12,7	12,3	13,1	12,7	12,3	11,4	11,1
Proteina e papërpunuar g	190		190		165			185			180	
Fibra e papërpunuar g	-		40		min.40			35			30	
Kalcium g	8,5		7,5		6,5			7,5			7,5	
Fosfor*** ) g	5,5		5,5		5,0			5,5			5,0	
Fosfor i holluar g	3,5		3,5		3,3			3,5			3,3	
Natrium g	1,5		1,5		1,5			1,5			1,5	

\* Ushqim dietik për përdorim të kufizuar në çrregullimet e zorrëve: Lys: Met/Cys: Thr: Try = 1:0,53:0,63:0,

\*\*\* tretshmëria e supozuar prececale: 90%,

\*\*\*\* me shtimin e fitazës, Referenca: DLG 2008

Për më shumë informacion:



**Q F** Qendra e Formimit  
**P B** Profesional të Blegtorëve

**Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)



## 7. KTHIMI I AFSHIT

*Dr. Bettina Exel Specialiste për shëndetin dhe higjienën e kafshëve.  
Përpunuar nga Kristian Maka.*

Kthimi i afshit te dosa ose kafshët e tjera, të cilat gjatë kontrollit të barsmërisë rezultuan jo barëse shkaktuan shpenzime të padëshiruara (për kthimin në afsh shpenzimet shkojnë deri në 60 € duke llogaritur këtu edhe shpenzimet e stallës), duke ulur rendimentin e tufës dhe duke zvogëluar prodhimin bujqësor. Dosat që kanë pasur një kthim aciklik të afshit (mbas 3 apo 6 javësh) ose dallohen me vonesë që janë shterpë, kanë probleme të adaptimit në tufë.

Problemet e kthimit të afshit janë të shumëllojshme, si psh: dosat e dobëta, MMA (Mastiti, Metriti, Agalaktia) infeksionet, temperatura e lartë, çrregullime të metabolizmit, rënia e imunitetit, gjithashtu mbeten për t'u përmendur dhe sëmundjet dytësore virale dhe bakteriale.



### Shkaqet për rritjen e kthimit në afsh

- ◆ Menaxhimi i ndërzimit: Mangësi në identifikim gjatë periudhës së afshit, ndërzim në kohën e gabuar, përdorimi i kateterëve të ndotur (të papastër), ndërzimi i nxituar, stresi
- ◆ Kur temperatura e stallës është e lartë
- ◆ Kur dosat janë të dobëta
- ◆ Kur dosat janë të reja
- ◆ Adaptimi në tufë i dosave të reja
- ◆ Ngordhja e embrionit (kthimi i afshit në 28 ditë ku duhet të jetë dhe dita e barsmërisë) Stresi, Mykotoksina në ushqim, viruset, një mitër më pak e sforcuar (nën 5 embrione shpesh është inseminuar vonë)
- ◆ Kist (afshi tek dosat është shumë i gjatë)
- ◆ Rrjedhje (MMA, Endometrit)
- ◆ Materiali biologjik që nuk ka aftësi për t'u fekunduar (cilësia e materialit biologjik, ruajtja e gabuar)

### Këshilla të përgjithshme

1. Procesi i inseminimit duhet të zhvillohet në qetësi dhe nuk duhet të shkaktojë stres te dosa. Inseminimi duhet të shoqërohet nga prania e një harci në mënyrë që dosa të stimulohet mjaftueshëm.  
Mbas ndërzimit dosa ka nevojë të qëndrojë në qetësi (në boks individual)

2. Në temperatura të larta gjatë muajve të verës dhe në temperatura të ulta gjatë muajve të dimrit, rrymat e ajrit në stallë (pasohet me infeksion në rrugët urinare dhe në mitër) dhe përqindja e lartë e gazit të dëmshëm, ulin efektshmerinë e dosës dhe nxisin shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme.

3. Procesi i të ushqyerit duhet t'u përshtatet çdo dose sipas parametrave të tyre, si dhe fazës së riprodhimit. Mungesa e ushqimit cilësor si psh. drithërat që përmbajnë mykotoksina ndikojnë në uljen e rendimentit.

### Flushing- Ushqimi

Gjatë fazës së shkëputjes ushqimi duhet të reduktohet për çdo vakt nga 1 deri në 2 kg. Mbas kësaj dosa ushqehet pa kufi me ushqim, për dosat në laktacion deri në momentin e ndërzimit. Nëpërmjet kësaj mënyretë ushqyerit (rritje të energjisë), mbas shkëputjes nxitet procesi i afshit, pakësohen ditët në laktacion dhe shumohen vezët pjellore nga vezorja.

Shumë ferma përvec racionit për dosat në laktacion i shtojnë energjitë nëpërmjet misrit ose silazhit të misrit kokërr.

### Dosat e reja

Dosat e reja na tregojnë shpeshherë para afshit të parë shenja paraciklike si psh: skuqje të lehta dhe të enjtura të vulvës. Shenjat që vijnë nga stimulime të ndryshme si p.sh. transporti. Kjo ngatërrohet shpesh me periudhën e afshit. E rëndësishme është testimi i reflekseve të palëvizshmërisë. Tek paradosat nuk duhet të përdorim afshin e parë për ndërzim. Mund të arrijmë një pjellje optimale direkt pas ciklit të 2 dhe të 3. Tek e Bardha e Madhe (LARGE WHITE) procesi i ndërzimit ndodh më vonë. Ndërzimi i parë duhet të bëhet pas 240 ditësh ose kur dosa ka arritur peshën 130 kg.

1. Ndërtimi i stallës, madhësia e grupit, hapësira e disponueshme për çdo kafshë, dhënia e ushqimit dhe sistemimi i pirëseve të ujit mund të jenë faktorë që shkaktojnë stres. Kjo prek në të shumtën e rasteve dosat, të cilat në stallën e ndërzimit mbahen në grupe individuale të veçuara dhe shpeshherë privohen nga tufa gjatë të ushqyerit. Kur këto pengesa rriten, atëherë rritet dhe numri i ngordhshmërisë embrionale, i cili çon në pjellori të ulët ose ndërprerje të barsmërisë, që mund të shoqërohet edhe me kthim në afsh.

2. Në shumicën e fermave ambienti i stallave është i ftohtë. Në këto ferma infeksionet në rrugët urinare janë të përditshme duke shkaktuar kthim në afsh. Shpesh stallat nuk janë të izoluar mirë. Pa ngrohje dhe pa ajrim nuk krijohet thatësia e duhur në këto stalla. Temperatura minimale e stallës duhet të jetë 20° C.

3. Një mbajtje e rregullt e materialit biologjik. Cilësia e materialit biologjik të harcit dëmtohet nga:

- ♦ Temperatura e harcit.
- ♦ Parazitët (krimba, sarcoptes etj)
- ♦ Infeksionet (në testikuj dhe në rrugët urinare...) Ushqim i prishur
- ♦ Gjak në ejakulat
- ♦ Qëndrimi në kushte të këqija Të ushqyerit
- ♦ Mbajtja në errësirë
- ♦ Kërkesa të larta (marrja jo më shumë se 3 herë në javë e materialit)

**Për më shumë informacion:**



**Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve**

**Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al


## 8. NJË NDËRZIM I SUKSESSHËM

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann dhe aksioner i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Kristian Maka.

### Zbulimi i afshit

- e. Vëzhgim i organeve gjenitale (skuqje dhe enjtje vulvulës si dhe rrjedhje mykotike)
  - f. Refleksi i palëvizshmërisë (dosa qëndron e qetë dhe nuk lëviz)
- g. Nuk kërcen mbi dosat e tjera, shqetësohet, hungërin
- h. Qëndrim në formën e kaluçit kur harçi afrohet.
- i. Loja e veshëve
  - j. Kontrolli i afshit bëhet rregullisht 2 herë në ditë në momentet e qetësisë (mbas procesit të të ushqyerit)
  - k. Kontakti i kontrolluar me harçin, 15-20 min harçi duhet të qëndrojë përpara dosës
- l. Kontakti me harçin jo i vazhdueshëm (vijimësia e afshit) shihni grafikun

### Sa kohë qëndron një dosë?



Ndërzimi duhet të bëhet gjithmonë në të njëjtën kohë (pas fazës së të ushqyerit) dhe nga i njëjti person. Shqetësimet në ambientet e stallës si psh pastrimi i stallës, rigrupimi dhe të ushqyerit duhet të evitohen. Shpërqëndrimi ul reflekset e palëvizshmërisë dhe të të qëndruarit në qetësi. Dosat stimulohen me harçin dy herë në ditë (në mëngjes dhe në darkë) nga 15-20 minuta. Për këtë nevojitet që harçi të stacionohet përballë dosave. Dosat duhet të trajtohen me shumë qetësi dhe kujdes.

Sipas rregullave të EU në vitin 2002 dosat mbahen për një kohë në grup duke filluar nga 4 javë mbas ndërzimit deri në 1 javë para datës së pjelljes.

### Vërejtje

Një ribashkim për formimin e tufës mund të bëhet ose direkt mbas shkëputjes ose mbas ditës së 28 të barsmërisë. Para ditës së 28-të nuk është i këshillueshëm formimi i grupeve

### Stimulimi i dosës

Nga harçi	Nga njeriu
Vendosja e noçkës së harçit te dosa	Mbështetja e gjurit ose grushtit mbi faqen e dosës
Ngritje e lehtë e këmbës me anë të noçkës	Ngritja e gjurit
Mbështetja e noçkës te vithet e dosës	Mbështetja e duarve mbi vithet
Masazhi i noçkës mes njëri-tjetrit	Masazhi i noçkës të dosës nëpërmjet njeriut
Tentativa të ndërzimit naryral	Testi i kalërimit dhe i shtrëngimit

sepse mund të kemi probleme në ngjizjen e embrionit.

E rëndësishme për dosën është kontakti vizual, kontakti i nuhatjes dhe kontakti i prekjes me harçin.

### Momenti i inseminimit


Përcaktimi i momentit të inseminimit është në çdo fermë i ndryshëm.

Për një dosë është e mjaftueshme të inseminohet dy herë (përjashtim bën: afshi i parakohshëm, afshi i zgjatur dhe për këtë arsye inseminimi është i domosdoshëm të bëhet deri në 3 herë).

### Inseminimet e shpeshta janë më të suksesshme kur:

- ♦ inseminimi i parë ka ndodhur herët
- ♦ nuk është zgjedhur momenti i duhur për inseminim
- ♦ kohëzgjatja e afshit nuk dihet akoma (paradosat) dosat
- ♦ mbas shkëputjes tregojnë shpejt afsh

## Palëvizshmëria e dosës



1. Inseminimi i parë artificial: 8-12 orë pas shfaqjes së refleksit të palëvizshmërisë
2. Inseminimi i dytë artificial: 8-12 orë më vonë bëjmë një nderzim të dytë.

Te dosat në shkëputje që vijnë shpejt në afsh, inseminimi duhet të kryhet në ditën e dytë të afshit. Inseminimi i dytë është i domosdoshëm të bëhet mbas 12 orësh.

Dosat që vijnë vonë në afsh kanë një afat të shkurtër kohor afshi kështu që janë për t'u inseminuar sapo të dallohet që ato janë në afsh. Një inseminim i dytë nuk është në shumicën e rasteve i mundur.

Shembull për procesin e inseminimit

	E shtunë	E diel	E hënë	E martë	E mërkurë
mëngjes			A	C	E 1x; D 1x; C 2x
drekë				A 2x; B 1x	
darkë			B	B 2x; C 1x (A 3x?)	E 2x; D 2x (?)

- Stimulimi i afshit
- Kontrolli i afshit
- Inseminimi i afshit

### Dosat inseminohen

#### Aksesorët enevojshëm:

- Peshqirë të pastër(kartopoceta kuzhine)
- Kateterë me njëpërdorim (të ambalazhuar)
- Materiali biologjik

Vetëm dosat me refleksin e palëvizshmërisë mund të inseminohen.

Marrëdhënia mes inseminuesit dhe harçit është e rëndësishme. Harçi duhet të qëndrojë vetëm para grupit i cili do të inseminohet. Tek grupet e mëdha është e domosdoshme një ndarje, në mënyrë që të jetë i sigurt stimulimi i vetëm atyre dosave që do të inseminohen.

### Llojshmëritë e kateterit:

Për llojshmëritë e kateterëve diskutohet shumë. Forma e kateterit është shumë më pak e rëndësishme në arritjen e suksesit në inseminim krahasuar me faktorë të tjerë ndikues. Çdo fermë ka të drejtën e zgjedhjes së kateterit.

### Higjena gjatë inseminimit:

Higjena është e rëndësishme, një faktor kyç në inseminim dhe ul mbi të gjitha kthimin e afshit.

### Dosa:

- vendi i inseminimit duhet të pastrohet dhe të dezinfektohet shpesh
- para inseminimit vulva duhet të pastrohet me peceta njëpërdorimshme (kartopoceta kuzhine dhe letra tualeti) të thata.

### Kateteri:

- duhet që pak para inseminimit të nxirret nga paketimi dhe për këtë arsye kateterat shiten në sasi të mëdha kateteri
- nuk duhet të ketë kontakt me sendet e tjera si psh: (rrrobate trupit, pajisjet e stables ose me kafshët e tjera)
- kateteri është njëpërdorimshëm (për çdo dosë dhe për çdo inseminim)
- për kateterët shumëpërdorimshëm duhen marrë masat mbrojtëse: sterilizimi dhe kontrolli i kohës së skadencës

### Përdorimi i lubrifikantëve:

Për një përdorim të thjeshtë të kateterëve përdoren lubrifikantët përkatës: lubrifikanti më i mirë është materiali biologjik. Në përdorimin e lubrifikantëve duhet pasur parasysh edhe higjena. Përdorimi i lubrifikantëve nuk është një element i rëndësishëm në rezultatet e barsmërisë.

## Mbajtja shënim e të dhënave

Mbajtja e shënimeve të vazhdueshme janë një domosdoshmëri për çdo fermer. Mbajtja e shënimeve dhe krahasimi i të dhënave të fermës janë një mbështetje shumë e madhe në analizimin e pikave të dobëta dhe të forta të një ferme. Veçanërisht tek problemet e pjellorisë, të dhenat edosave janë një element shumë i rëndësishëm në zgjidhjen e këtyre problemeve.

## Kontrulli pas afshit

Për të shmangur ditët boshe të panevojshme deri në inseminimin e parë (max. 6 ditë boshe), bëhet një kontroll konsequent pas afshit, stimulimi dhe të ushqyerit e dosave (të ushqyerit flushing= energji) janë shumë të rëndësishëm. Për fermat që kanë kuota të ulëta të këthimit të afshitështë i mjaftueshëm përdorimi i aparatitecholot. Një informacion i sigurt rreth barsmërisë është i mundur vetëm me përdorimin e skanerit. Në situata problematike gjithashtu edhe tek kuotat e këthimit në afsh mbi 20% rekomandohet përdorimi i skanerit.

## Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve**

## Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)

## 9. MËNYRA E DUHUR E TË USHQYERIT TË DOSAVE

*Përpunuar nga Kristian Maka.*

Krahas menaxhimit të dosave (inseminimi, vaksinimi, higjiena), të ushqyerit e tyre është çelësi për riprodhimin e suksesshëm të gicave. Rekomandimet e paraqitura janë një përmbledhje e përvojës frytdhënëse, sipas standardeve të caktuara minimale, që të çojnë drejt suksesit të sigurt dhe klientëve të kënaqur. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që metodat të aplikohen 100% në të njëjtën mënyrë në fermat e mbarështimit të derrave.



### Shkëputja e gjirit dhe mënyra e të ushqyerit

Në ditën e shkëputjes së gicave, dosave këshillohet që t'u ofrohet maksimalisht 3 kg ushqim laktacioni edhe pak bar që ndihmon vetëm për ngopjen e tyre (fibër të pastër, bar apo kashtë). Në 2-3 ditët në vijim pas shkëputjes, dosat duhet të marrin të paktën 3kg ushqim laktacioni.

### Rekomandim:

Nga dita e dytë deri në të tretën pas shkëputjes krahas ushqimit të laktacionit që jepet rekomandohet dhe 1 kg Prestarter (BI-LACTIN PLUS, SCHAUMA PREMIUM ose SCHAUMA WEAN). Kjo mënyrë të ushqyerit është e domosdoshme sidomos për dosat pas pjelljes së parë. Si përzjerje mineralesh rekomandohet Schaumalac ZL.

### Të ushqyerit deri në ditën e 65-të të barsmërisë

Menjëherë pas ndërzimit të parë mund të jepet 2 deri 2,3 kg ushqim barsmërie. Dhënia e menjëhershme pas shkëputjes, e ushqimeve që janë burime të larta energjike sjell rritjen e vdekshmërisë së embrioneve. Dhjamosja e tepërt parandalohet me anë të kombinimit optimal të ushqimeve të ndryshme që përmbajnë celulozë. Si përzjerje mineralesh rekomandohet Schaumalac ZT.

### Të ushqyerit deri në ditën e 105-të të barsmërisë

Në këtë fazë kemi një rritje të sasisë së ushqimit në 2,5- 2,8 kg. Duke filluar nga dita e 90-të e barsmërisë sasia e ushqimit rritet në 3,0- 3,5 kg. Një sasi e lartë e ushqimit rrit peshën e lindjes së gicave. Vetëm për shkak të konsumit të lartë të ushqimit (200-300 kg më shumë për dosë në vit) në këtë fazë nuk lejohet të ushqyerit e dosave me ad libitum. Si përzjerje mineralesh edhe në këtë fazë rekomandohet të aplikohet Schaumalac ZT.

### Përgatitja për pjelljen duke filluar nga dita e 106-të e barsmërisë

Të gjitha masat e ndërmarra duhet të çojnë në një pjellje të shpejtë dhe në një prodhim optimal qumështi. Pengesat duhet të parandalohen. Kjo arrihet, duke ulur sasinë e ushqimit në më pak se 2 kg në dy deri tre ditët e fundit të barsmërisë.

Rekomandohet një përzjerje 50% ushqim barsmërie dhe 50% laktacioni si dhe aplikimi i SCHAUMACID minimalisht 40g për dosë në ditë për parandalimin e etheve të qumështit.

### Periudha e të ushqyerit me gji

Sasia e ushqimit duhet t'i përshtatet prodhimit të qumështit. Prandaj te dosat që pjellin për herë të parë sasia maksimale e ushqimit jepet afërsisht 10 ditë pas pjelljes, ndërsa te dosat e vjetra afërsisht 7 ditë pas pjelljes. Një furnizim i mjaftueshëm me ujë është kusht i domosdoshëm për një konsum të lartë dhe për një dosë të shëndetshme. 10% e masës trupore të dosës duhet të jetë ujë. Në stinën e ngrohtë të vitit duhet të shtohet të paktën 25%. Pra, një dosë që peshon 200 kg peshë e gjallë i korrespondon 20 l ujë në ditë. Sasia e ujit që kalon në pirëse duhet të jetë 2.5 l në minutë.

Gjatë periudhës së ushqimit me gji rritet mesatarja ditore prej 225 g për gic në ditë. Për të arritur këtë duhet të prodhohet çdo ditë 11 l qumësht dose.

Në këto 11 l qumësht ka 9 litër ujë. Këshillohet që koritat të mbushen me ujë për të pirë dosat. Në mënyrë që të kompensohet bilanci elektrolit sugjerohet të përdoret 0,5 kg ENERGIETRUNK (pije energjike) në 10 litër ujë. Sasia e ushqimit rekomandohet të jetë 2 kg për dosë dhe 0,5 kg për gic, kjo do të thotë në 10 gica 7 kg ushqim. Temperatura në stallën ku rri dosa me gicat e saj duhet të jetë 20°C. Përsa i përket mënyrës së të ushqyerit të dosave, përbërësit duhet të përdoren në kushte të përsosura higjienike. Sinkronizimi i ushqimit ditor dhe zëvendësuesit të qumështit është i rëndësishëm.

**Tab.1 Recetë ushqimore**

Komponentët	Ushqim ditor	Zëvendësuesi i qumështit
ELB	61,10	40,0
Misër	15,0	35,0
Sojë 44	10,0	17,0
Vaj	0,5	1,0
Celulose	10	5,0
Schaumalac ZT	3,5	-
Schaumalac ZL	-	4,0
Shuma	100	100
Përbërësit /kg sasi ushqimi		
Masë e energjisë në g	11,8	12,7
RP në g	142	160
RFA në g	62	49
Lizinë në g	7,1	9,5

**Për më shumë informacion:**



**Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve**

**Austria Praemix shpk**  
Tel: +355 (0)68 402 6311  
e-mail: [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)

## 10. GICAT E "USHQIMIN ACIDIKE"

## PËLQEJNË ME PËRMBAJTJE

*Përpunuar nga Kristian Maka.*



**Të ushqyerit e derrave:** Faza e shkëputjes së gicit është shpesh problematike. Dëshironi të informoheni mbi planin për një mbarështim të suksesshëm dhe rolin që luajnë strategjitë e të ushqyerit në fermat individuale?!

Të ushqyerit në fazën e shkëputjes, përveç menaxhimit, ka një ndikim të madh në rendimentin dhe në shëndetin e gicave. Qëllimi i të ushqyerit të shëndetshëm është kalimi i fazës së shkëputjes së gicave pa asnjë shqetësim, pavarësisht kushteve të fermave.

**Të ushqyerit:** Zhvillimi i gicit në fazën e mëmëzimit është i varur nga rendimenti i qumështit të dosës. Një furnizim i mirë me qumësht pas lindjes siguron një sistem imunitar të lartë dhe mbrojtje nga bakteriet e pranishme në stallë. Po kaq i rëndësishëm është të ushqyerit e gicit në mëmëzim nga dita e 12-të deri në të 30-tën me qëllimin e mëposhtëm:

Të mësuarit e të ushqyerit, shijimi i ushqimit dhe pirjes së ujit; fillimi i prodhimit të lëngjeve tretëse (prodhim i enzimave), acidit klorhidrik dhe pepsinës në stomak, enzimat në zorrën e hollë; nxitja e zhvillimit të mureve të zorrëve (rritja e vileve) për një rritje të kapacitetit të kosumit të ushqimit.

Eksperiencat tregojnë se të ushqyerit e hershëm ka një ndikim të ulët në peshën e gicit në fazën e shkëputjes, por luan një rol vendimtar për zhvillimin e mëtejshëm të gicit pas kësaj faze. Sa më i mirë të jetë përvetësimi i prestarteve në fazën e mëmëzimit (rreth 500gr Schaumlac F30 për gic në 28 ditët e mëmëzimit) aq më pak probleme hasen në kalimin e fazës së shkëputjes. Ndërmjet ditës 21 dhe 28 të shkëputjes, koha e përshtatjes të sistemit tretës është shumë e shkurtër. Për këtë arsye kërkesat në të ushqyer gjatë kesaj faze rriten shumë.

**Tranzicioni:** Për gicin, shkëputja nga dosa do të thotë një ndryshim rrënjësor në mënyrën e të ushqyerit. Qumështi i dosës, që deri para pak orësh përbente ushqimin e tij, zëvendësohet me ushqim të fortë. Sistemi i tretjes së gicit duhet të mësohet në pak orë në një ushqim të fortë dhe me përmbajtje proteinash me prejardhje bimore. Një përrthithje optimal e ushqimit nga gici është prioritet absolut në fazën e shkëputjes. Pra 1L qumësht në ditë para shkëputjes duhet të zëvendësohet me ushqimtë fortë. Kjo do të thotë që gici ditën e shkëputjes duhet të marrë minimalisht 200g deri në 250g ushqim nga prestarteri Schaumlac F30 për të siguruar të njëjtën sasi ushqimi si më parë. Për këtë arsye është e këshillueshme që prestarteri me përmbajtje të lartë vitaminash ushqyese, t'i jepet gicit dy ditë pas shkëputjes. Përveç kësaj ushqimi nuk duhet të ndërrohet direkt ditën e shkëputjes sepse mund të shkaktojë stres tek gicat. Masa të tjera për stimulimin e konsumit të ushqimit në periudhën e shkëputjes mund të jetë ndriçimi gjatë gjithë ditës i vendit të gicave si dhe i ushqimit.

**Vlera e pH:** Një tretje e "shëndetshme" tek gicat fillon me një zbutje të mjaftueshme të ushqimit në gojë dhe me një ulje të shpejtë të vlerës së pH në stomak. Të domosdoshme për këtë janë racionet e vogla të ushqimit. Mënyrën e të ushqyerit e kemi përfituar nga praktika. Koncepti i të ushqyerit luan një rol vendimtar në uljen e vlerës së pH në aparatit tretës. Të gjithë përbërësit e ushqimit asimilohen në mënyra të ndryshme sipas sasisë së prodhimit të acidit në stomak. Kështu racioni ushqimor përveç asimilimit të ushqimit ka një rol të rëndësishëm edhe në përqindjen e acidit në stomak. Kapaciteti i prodhimit të acideve (KPA) është një tregues për konsumin e acidit klorhidrik për çdo kg ushqim (meq/kg) të çdo komponenti të veçantë dhe ushqimit të përzier për të arritur një vlerën 3 të pH. Përgjithësisht në ushqimin e gicit duhet të arrihet që kapaciteti i prodhimit të acideve (KPA) të jetë <700 meq/kg ushqim.

**Kapaciteti i prodhimit të acideve tek çdo përbërës i ushqimit.**

Përbërësit	KPA(meq/kg)
Gruri	190
Elb	230
Misri	190
Sojë	970
Qumësht pluhur	935
Karbonat kalciumi	20140
Oksid magnezi	48600



**Përqindja e lartë e proteinave (> 17%)** në ushqimin e gicit, e shoqëruar me një tretje jo të mirë të proteinës, siç ndodh në rastin e sasive të mëdha të bimëve me përmbajtje të lartë proteinike (të tilla si sojë me >10%), çon në ulje të pamjaftueshme të pH në stomak. Kombinimi i produkteve të qumështit me përqindje të ulët hiri, koncentratit sojë dhe proteinë patatesh, me një pasurim të racionit me aminoacidin lizin, metionin, treonin dhe triptofan si dhe acide organike, mundëson një reduktim optimal të proteinës në stomak dhe ndalon një rritje të tepërt të vlerave të pH.

**Duhet të shihet në mënyrë kritike** përdorimi i komponenteve minerale, të cilët mund të ndryshojnë ndjeshëm kapacitetin e tyre buferik. Komponentët e fortë buferik neutralizojnë acidin klorhidrik në stomak, që është prodhuar nga gici si dhe acidet organike dhe inorganike që jepen me ushqimin. Eliminimi i baktereve dhe acidizimi i ushqimit për aktivizimin e enzimës tretëse pepsinë nuk ndodh në sasinë e nevojshme. Kështu rrezikohet që mikrobet të kalojnë murin e stomakut. Niveli i lartë i pH në ushqimin e butë sjell rritjen e pH në zorrën e hollë. Pra rritet rreziku i shumimit të pakontrolluar të mikrobeve (E.coli, Klostridia) dhe ngjitjen e mikrobeve të E.colit nga zorra e trashë. Kjo sjell stres shtesë nga ndryshimi i shpejtë i ushqimit, konsumit të ulët të ushqimit direkt pas shkëputjes (mungesë energjie) dhe pastaj mbingrënia, temperatura të ulëta të ambientit dhe mungesa e ujit sjellin probleme masive me diarrenë ose probleme me frymëmarrjen. Komponentët e pasur buferikë duhet të jenë të kufizuar në periudhën e shkëputjes. Përzierja e aminoacideve ose kombinimi i acideve e ul kapacitetin e racioneve për formimin e acideve. Në praktikë niveli i proteinës ndërmjet 16 – 17% si dhe niveli i kalciumit nga 0,6 – 0,7 % i ushqimit në shkëputje tek fermat me probleme ka dhënë rezultate pozitive. Me përdorimin e acideve organike mund të ulët edhe më shumë vlera e pH dhe e acideve të ushqimit. Një efekt shumë të mirë japin aminoacidet për arsye se ato janë më të konsoliduara se acidet e tjera organike. Në krahun tjetër kriprat e acideve organike e ndryshojnë shumë pak thartirën.

**Koncepti i të ushqyerit** duhet të përshtatet në mënyrë individuale sipas kushteve të secilës fermë. Në parim, ushqyerja e gicit bëhet me prestarter të një cilësie të lartë, i cili përdoret deri në 10 ditë pas shkëputjes për të mënjanuar stresin gjatë ndryshimit të ushqimit. Në një fermë të shëndetshme mund të jepet ushqim i pasur gjatë periudhës së shkëputjes. Tek fermat të cilat kanë probleme të shumta me diarrenë ose sëmundjen e edemave, të kushtëzuara nga E.coli, gjatë periudhës së shkëputjes, një ushqyerje e orientuar drejt rezultatit mund ta përkeqësojë më shumë këtë problem.

Zakonisht problemet e shfaqura me diarrenë shfaqen për shkak të konsumit të tepërt të ushqimit në ditët pas shkëputjes.

**Të ushqyerit në shkëputje** karakterizohet nga një përbërje e ulët me proteina, energji dhe minerale. Kapaciteti i formimit të acidit ulët ndjeshëm nga përbërësit e lëndës ushqyese, zgjedhja e lëndës së parë si dhe në të njëjtën kohë nga përdorimi i lartë i acideve organike. Gjatë përdorimit të komponentëve të pasuruar duhet patur kujdes në përqindjen e fibrave të papërpunuara, të cilat duhet të jetë rreth 4% për t' i paraprirë konstipacionit. Në shëmbujt e mësipërm të 2 fermave, kalohet rreth 10 deri në 14 ditë pas fazës së shkëputjes në një marrje të ushqimit prej rreth 4kg në fazën e të ushqyerit për mbarshtrim.

Fermave të specializuara ju këshillohet ndarja në 2 faza të periudhës së mbarshtrimit nga 12 deri në 30 kg peshë e gjallë.

**Përfundimi:** Të ushqyerit e qëllimshëm të gicit në mëmëzim me prestarter që metabolizohet lehtë si Schaumalac F30 dhe në të njëjtën kohë me sigurimin optimal të kushteve, është baza për sukses në mbarështim. Një rol vendimtar në të ushqyerit e gicave është marrja parasysh e kapacitetit të racionit për formimin e acideve. Kufizimi i lëndëve të para të forta buferike, proteinave dhe mineraleve në receptura sjell një lagje më të mirë të ushqimit në stomak. Për këtë arsye është e këshillueshëm përdorimi i ushqimit me kapaciteti të prodhimit të acideve të reduktuar.

**Për më shumë informacion:**



**Austria Praemix shpk**

**Tel: +355 (0)68 402 6311**

**e-mail: agri@ap.com.al**

## 11. DIARREJA DHE ENTEROTOKSEMIA: PROBLEMATIKA E VAZHDUESHME

*Përpunuar nga Kristian Maka*



***Diarreja dhe Enterotoksemia janë probleme serioze që prekin gicat në procesin e rritjes dhe shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike, si pasojë e ngordhshmërisë në nivele të larta dhe rritjes së depresionit të kafshëve.***

Gicat në mëmëzim të sapo ndarë nga dosa gjenden në një situatë stresuese. Gici duhet të përballet me ndarjen nga dosa, transportin, luftën për rang në tufë, presionin ndaj mikrobeve dhe zëvendësimin e qumështit të gjirit me ushqim. Gjatë periudhës së ushqyerjes me gji, gici konsumon nëpërmjet qumështit laktozë, yndyrë, proteina, pra lëndë lehtësisht të tretshme. Nga shpërbërja e laktozës në acid laktik, pH në zorrë ulet. Në këtë mënyrë bakteret koliforme (E.Coli) nuk mund të zhvillohen. I gjithë aparati tretës duhet të përshtatet me zëvendësimin e qumështit me ujë dhe ushqimit të ngurtë me ushqim me bazë drithërash. Kjo do të çojë në një rritje të vëllimit të zorrës së trashë dhe të hollë, ndryshim në florën intestinale dhe një ndryshim në prodhimin e enzimave. Prodhimi i pamjaftueshëm i acidit klorhidrik në stomak në 3-4 javët e para të jetës dhe lëvizshmëria e ulët e zorrëve, lehtëson kalimin e baktereve E.Coli përmes stomakut si dhe shtimin e baktereve në zorrën e hollë dhe të trashë. Në këtë mënyrë kemi një shtim masiv të baktereve E.coli në zorrën e hollë. Kjo situatë dhe ulja e aftësive mbrojtëse të shkaktuara nga stresi mund të çojë në devijim të gjendjes normale të kafshës dhe shfaqje të gjendjes patologjike të shëndetit të saj.

### Ushqimi i pakët

Gicat, në ditët e para pas shkëputjes nga gjiri, hanë më pak për shkak të ndërrimit të ushqimit dhe stresit. Gjatë kësaj periudhe ngadalësohet ripërtëritja e qelizave në mukozën e zorrëve dhe ulet prodhimi i enzimave, dhe si pasojë ulet ndjeshëm aftësia tretëse. Kur gicat fillojnë të hanë, rritet konsumi i ushqimit për të kompensuar defiçitet në energji. Për shkak të mostretjes së mirë të ushqimit në stomak, një sasi e madhe e ushqimit kalon e patretur në segmentet e zorrëve. Kjo çon në përhapjen e baktereve E.Coli, të cilat mund të shkaktojnë diarre dhe enteroksemi.

### Diarreja dhe enterotoksemia

Deri më sot janë të njohura me mijra stereotipa të E.Colit, ndërmjet të cilave bëhet dallimi midis baktereve patogjene (që shkaktojnë sëmundje) dhe atyre jopatogjene (që nuk shkaktojnë sëmundje). Bakteret jopatogjene janë të pranishme në traktin gastrointestinal. Bakteret patogjenë ndahen në enterotoksike (ETEC) dhe verotoksike (VTEC). Këto janë përgjegjëse për diarrenë dhe enterotokseminë te gicat e porsalindur dhe gicat në shkëputje.



**Fig. 1:** Zorra e hollë është e zgjeruar dhe e mbushur me lëngje

### Diarreja klinike

Shtamet enteropatogjene dhe shtamet enterotoksemike E. Coli shkaktojnë diarre. Ato kanë strukturë sipërfaqësore (fibrike) në mënyrë që të ngjiten në epitelin e zorrëve. Këto baktere prodhojnë enterotoksinë (toksinë), të cilat çlirojnë në qelizat e zorrëve ujë dhe elektrolitë (natrium, klorid kaliumi). Zakonisht sëmundja shfaqet pas shkëputjes ose pas ndryshimit të ushqimit (Prestarter → ushqim i shkëputjes/ ushqim i shkëputjes → ushqim për rritje).

Si pasojë ndodh diarre e ujshme me humbje lëngjesh dhe elektrolite. Tufat kanë një rritje johomogjene dhe mund të ngordhin nga dehidratimi.



**Fig. 3:** Nga edema e trurit kafshët shfaqin çrregullime ekulibri, qëndrojnë shtrirë dhe lëvizin këmbët në formë lopate

### Enteroksemia klinike

Enteroksemia shkaktohet nga E.Coli toksik. E.Coli zotëron mekanizma që ngjiten në murin e zorrëve dhe prodhojnë toksina, të cilat ndryshojnë përshkueshmërinë e mureve të enëve të gjakut. Post reaksionet janë humbjet e lëngjeve në indet përreth dhe si pasojë shkaktohen edema. Kafshët shfaqin enjtje të qepallave (bulbi i syve duket i rënë). Edema pulmonare shkakton ngulçim dhe dëmtim të sistemit kardiovaskular. Mukoza e lëkurës së veshëve, e hundës si dhe membrana e syrit marrin ngjyrë të kuqe në blu. Nga edema e trurit kafshët fillojnë të dridhen, shfaqin çrregullime ekulibri, qëndrojnë shtrirë dhe lëvizin këmbët në formë lopate. Nëse kafshët nuk do të trajtohen në kohë, ata do të ngordhin brenda 24 orëve nga shfaqja e sëmundjes.

Simptomat shfaqen zakonisht te gicat më të zhvilluar sepse këto kafshë marrin menjëherë sasi të mëdha ushqimi. Ushqimi tretet pak në stomak dhe një pjesë e madhe e tij depozitohet në pjesën e pasme të zorrëve.

### Diagnostifikimi

Në mënyrë që të mund të merren masa terapeutike dhe profilaktike sa më efikase, nevojitet një diagnozë sa më e saktë. Nga njëra anë duhet të vëzhgohen simptomat dhe nga ana tjetër bëhet çarja e kafshës së ngordhur për të marrë mostra të zorrëve dhe të indeve. Diagnoza bëhet duke specifikuar shkaktarin dhe zbulimittë toksinës.

Kafshët e ngordhura nga E.coli kanë një trup të thatë dhe sy të rënë, zorra e hollë është e zgjeruar dhe e mbushur me lëngje.

Kafshët e ngordhura nga enteroksemia paraqesin edema në hundë, në qepallat e syve, në muret e stomakut dhe zorrën e trashë. Përmbajtja e zorrës së hollë është e ujshme, me gjak dhe muret e zorrëve janë të skuqura.

### Terapia

Masat që duhen marrë:

- Trajtimi i menjëhershëm me antibiotikë, i të gjithë tufës nëpërmjet ushqimit (kolistin sulfat, linkomicin, neomicin sulfat) si dhe trajtimi individual i gicave të prekur me preparate për injeksione (Fluochinolone, Cefquinom, Trimetoprim- Sulfonamid, etj.)

- Të kufizohet ushqimi dhe të ofrohen sa më shumë lëngje
- Zëvendësim i lëngjeve të humbura (të jepen elektrolite dhe produkte me përmbajtje glukoze)

### Profilaksia

Ofrohen mënyra të ndryshme për të parandaluar diarrenë dhe sëmundjen e enteroksemisë.

Gica të shëndetshëm, ky është fillimi i një rritjeje të

mirë. Më poshtë gjenden disa vlerësime profilaktike:

#### 1. Shëndeti i gicave

- Trajtime përkatëse të simptomave të sëmundjeve (diarre, kollë, etj) në periudhën e gicave në mëmëzim. Të ketë sa më pak stres (mundësisht vaksinim për
- Mykoplasma dhe Circovirus disa ditë para shkëputjes). Gicat e prapambetur të eliminohen.

#### 2. Menaxhimi

Të praktikohet metoda brenda-jashtë në dhomat e shkëputjes e ndjekur nga pastrim i thellë dhe dezinfektim.

- Dhomat e shkëputjes të ngrohen paraprakisht nga 28°C-29°C, zona të izoluar ose të ngrohta, jo mbipopullim në stalla.

#### 3. Ushqimi

Gicat të ushqehen me Prestarter pas ditës së 10 të lindjes (përgatitja e enzimave tretëse nga përbërës bimorë) ndryshime të ushqimit nëpërmjet përzierjes së ushqimit,

- disa ditë para shkëputjes duhet të përdoret ushqimi i shkëputjes. Të nxitet konsumi i ushqimit pas shkëputjes (për të shkurtuar periudhën e urisë). Të ketë vende të mjaftueshme për të ngrënë (1:1 deri në 1:4).
- Të ofrohet ushqim edhe natën në mënyrë që gicat e dobët të mund të hanë.
- Të ofrohet ushqim disa herë në ditë në sasi të vogla, mundësisht i njomë.
- Të ofrohet ushqim me përmbajtje të lartë fibrash dhe me përmbajtje të reduktuar proteinash, të përdoren
- komponentë ushqimorë të tretshëm (produkte qumështi, produkte plazme, yndyrna të përpunuara).
- Ulje e pH në traktin gastrointestinal nga shtimi i acideve organike.

#### 4. Furnizimi me ujë

Pirëset e ujit të pastrohen rregullisht, vaskat e ujit të

- testohen me ujë të rrjedhshëm përpara futjes së tufës, për të hequr ujin e ndenjtur.

- Të kontrollohet prurja e ujit (0,5 deri në 1 l/minutë), t'f'i kushtohet kujdes raportit kafshë- lug (1:10).
- Ulje e vlerës së pH në traktin gastrointestinal nëpërmjet shtimit të acideve (psh. 500g acid citrik në 2.000 l ujë).
- Sisteme të dezinfektimit të ujit.

## 5. Zink

Në disa vende si Danimarka, ushqimi pas shkëputjes pasurohet me oksid zinku. Për të arritur efikasitetin, oksidi i zinkut duhet të përdoret në sasinë maksimale të lejuar në ushqim. Kjo është e ndaluar në Austri sepse sasi të mëdha të oksidit të zinkut nuk metabolizohen dhe si pasojë grumbullohen mbi plehun në tokë.

- Përdorim profilaktik i antibiotikëve kundër E.Coli-t në 1-2 javët e para pas shkëputjes.
- Vaksinim kundër E.Coli-t.
- Përdorimi i probiotikëve (baktere të acidit laktik, maja, sporet e bacilit), përdorim i erëzave bimore (si psh. rigon).
- Krijimi i një race rezistente kundër E.colit , e cila nuk ka receptorë për mikrobet e E.Coli-t. Problemi:

mungesa e receptorëve trashëgohet dhe është e lidhur me rezistencën ndaj stresit të kafshëve. Për këtë arsye, në ditët e sotme nuk mund të ketë kafshë në tufa të mëdha që nuk trashëgojnë receptorët.

## Përmbledhje

Në stalla profesionale të mbarshimit të derrave, në sektorin më delikat të shkëputjes mund të arrihet shmangia e E.Colit nëpërmjet ushqimit të duhur, klimës optimale në stallë dhe përmirësimit të menaxhimit.

## Për më shumë informacion:



**Austria Praemix shpk**

**Tel: +355 (0)68 402 6311**

**e-mail: agri@ap.com.al**

## 12. MËNYRA E DUHUR E TË USHQYERIT ME DRITHËRA

Përgatitur nga Franz Riegler, konsulent i Schaumann dhe aksioner i Austria Praemix shpk. Përpunoi: Kristian Maka

*Pjesën kryesore në ushqimin e derrave e përbëjnë drithërat. Megjithatë drithërat nuk duhet të përdoren direkt mbas korrjes, por vetëm pas disa javësh magazinimi, që të mos shkaktojnë asnjë problem të mundshëm shëndetësor.*

Në të ushqyerit e dosave, gicave dhe derrave, pjesën më të madhe të racioneve e përbëjnë drithërat. Përdorimi i grurit, elbit, misrit, etj, si komponentë thelbësorë të ushqimit të përzier, kërkon në parim para ushqyerjes, një bluarje ose ndryshim strukturor të kokrrave. Kjo vlen për të gjitha përpunimet dhe trajtimet e ndryshme. Korrja dhe magazinimi i drithërave të dëmtuar, zvogëlon vlerën e tyre ushqyese dhe mund të shkaktojë çrregullime shëndetësore si dhe ulje të rendimentit të kafshët.

### Proçesi i “djersitjes”

Proçesi i përpunimit nuk përfundon me korrjen e drithërave. Më saktë, në to kryhet një pjekje e mëvonshme gjatë ditëve dhe javëve të para pas korrjes. Për shkak të niveleve të ndryshme të maturimit, në kokërr vazhdojnë të ndodhin disa proçese enzimatike në lëndët ushqyese të depozituara. Maturimi i mëvonshëm i drithit, në thelb do të thotë: ndarje e lagështisë dhe koloideve (i pranishëm në përmasa shumë mikroskopike), pra diferencimi i ujit nga drithi nëpërmjet proçesit të “djersitjes”. Realizohet çlirimi i dioksidit të karbonit dhe ujit. Në të njëjtën kohë bëhet shndërrimi i lëndëve ushqyese.

Ekspertët e industrisë ushqimore, kanë vënë në dukje, mbi dy dekada më parë, se i ashtuquajtur “proçesi i djersitjes” ka aftësinë që një pjesë të drithit t’a konvertojë si jo të ushqyeshëm. Nga përdorimi i saj priten çrregullime në tretje, të cilat çojnë në rënie të performancës. Derrat dhe kuajt, janë më të prekur nga problemet gastrointestinale kur konsumojnë direkt drithërat pas procesit të korrjes. Testimet e kryera tregojnë rreth efekteve të dëmshme të të ushqyerit me drith të sapo korrur. Schaumann dhe nutricionistët e kafshëve kryen studime mbi derrat, duke i ushqyer me thekër të freskët dhe të vjetër.

**Rezultati:** Te derrat e ushqyer me thekër të freskët u zbulua mbi të gjitha një aktivitet i lartë mikrobik në stomak dhe në zorrën e hollë. Si te derrat e rinj edhe te derrat e vjetër, çrregullimet në tretje dhe në përthithjen e ushqimit mund të rriten nëse proçeset enzimatike që ndodhin në kokrrën e drithit përputhen me ndryshimet e brendshme metabolike. Kjo u konfirmua nga përvoja e tremujorit të tretë të vitit të kaluar. Në këtë periudhë u njoftua nga veterinerët mbikqyrës, se në disa vende pati një rritje të papritur të dështimeve. U bë e qartë që kjo kishte lidhje me të ushqyerit e mëparshëm të dosave me drith të freskët.

Në tufat e shëndetshme ndodhi një dështim në 100 raste barrsmërie. Në rast rritjeje të dështimeve duhet të tregohet kujdes i veçantë dhe veprim i menjëhershëm. Përvoja ka treguar se 70% e të gjitha dështimeve ose humbjeve të parakohshme të fetusit (pjellje e parakohshme) klasifikohen në kategorinë e problemeve jo infektive të lidhura me pjellorinë. Kostoja e një dështimi u vlerësua rreth 500€. Analizat e rekomanduara për vlerësimin e shkaqeve të mundshme të ndërprerjes së barrsmërisë, jo të lidhura me infeksionet, duhet të përfshijnë edhe kontrollin e cilësisë së ushqimit. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar kontrollit të ushqimit për myk në sektorin e dosave barrëse.

### Kufizimi i ushqimit

Për shkak të përvojave jo të favorshme të ushqyerjes me drith të freskët këshillohet që drithi të përdoret vetëm mbas katër javësh magazinimi dhe pas një konstatimi që vlera e lagështisë në drith të jetë në normat e lejuara. Për të mundësuar një ruajtje të mirë të drithit dhe për të mundësuar përdorimin e tij në ushqimin e kafshëve duhet të kemi parasysh që lënda e thatë të jetë minimalisht deri në 86%.

Ufijhtë e lejuar të sasisë për përdorimin e drithërave në sektorin e dërrit

Lloji i drithit	Dosat mbarëse/në laktacion	Gicat	Derrat
Elb	80/80	80	80
Grurë	20/50	50	50
Thekër	20/30	10	30
Tritikal	20/30	20	50
Tërshërë	30/10	5	10
Misërr (kokërr)	20/30	30	40

Burimi: LfL Bavareze- Informacion Botimi i 18 tetor 2011

Rekomandohet përdorimi i llojeve të ndryshme të drithërave tek dosat, viçat dhe derrat, sipas tabelës. Të dhënat janë nxjerrë nga vlera shkencore dhe nga përvoja e punës së përditshme. Përqindja e përdorimit nga fabrikat e koncentratit dhe nga përzierja në fermë nuk duhet t'i kalojë 30% të raportit ushqimor. Ky kufizim vlen edhe për ushqyerjen me drith të freskët. Nëse për konservim janë përdorur acidet atëherë procesi enzimatik që ndodh në kokrrën e drithit mbaron më herët dhe koha nevojshme për magazinim mund të përgjysmohet.

**Për më shumë informacion:**



**Austria Praemix shpk**

**Tel: +355 (0)68 402 6311**

**e-mail: [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)**

### **13. MASAT QË DUHEN MARRË PËR MENAXHIMIN E PERIUdhËS SË MËMËZIMIT**

Përpunoi: Kristian Maka

**Si t'ia dalësh mbanë në rrugëtimin e vështirë që finalizohet me fazën e shkëputjes.**

Me përdorimin e gjenetikave që japin numër të lartë të gicave të pjellë, lindja e 14 gicave të gjallë për pjellje nuk është më e rrallë. Rritja e sasisë së pjelljeve ndikon në zgjatjen e procesit të lindjes dhe në peshën reale të gicave. Pjellshmëria e lartë shoqërohet zakonisht me peshën e ulët në lindje, zgjatjen e procesit të lindjes dhe me rritjen e gicave me peshë të lehtë dhe i vë mbarështuesit e gicave para sfidave të reja.

Ing. Peter Salmutter - përfaqësues i Schaumann për Europën Juglindore

T'ia dalësh me sa më pak humbje në rastet e një numri të lartë lindjesh, mund të realizohet vetëm me një menaxhim kompleks të stallës dhe të të ushqyerit. Furnizimi i mjaftueshëm me kulloshtër vendos bazat për një mbarështim të suksesshëm të gicave në fazën e mëmëzimit. Një proces i natyrshëm gjatë ditëve të laktacionit, ndikon në një rritje graduale të sasisë ditore të qumështit të dosës. Veçanërisht gjatë ditëve të para, në pjelljet me 13 gica, sa vjen e krijohet një deficit në furnizimin me qumësht. Duke marrë parasysh edhe humbjen në peshë të dosave, të ushqyerit suplementar i gicave bëhet i paevitueshëm.

#### **Orët e para të jetës janë vendimtare**

Gicave me peshë të lehtë dhe të dobët u nevojitet që në fillim një përkujdesje e veçantë. Përdorimi i zëvendësuesve energjikë me pastë SchaumaLac Pro Activ ndihmon për një start maksimal në jetën e gicit. Pasta u duhet dhënë, që në orët e para të lindjes. Pasta në dispozicion dhe dhënia e energjitikëve i forcon gicat, të cilët janë të dobët për shkak të lindjes. Vitaminat e përzgjedhura dhe elementet gjurmë me tretshmëri të lartë ndihmojnë në rritjen e sistemit imunitar. Suplementi i Schauman-Probitikums Bonvital stabilizon florën intestinale dhe shtyp bakteriet që shkaktojnë sëmundje si E.coli. Austria Praemix me partnerin e saj Schaumann ofron zgjidhje optimale si për të ushqyerit me suplementë gjatë ditëve të para të lindjes, ashtu edhe për gicat e saposhkëputur, të cilët janë rritur me mënyrë teknike të të ushqyerit.

Krahas zëvendësuesve klasikë të qumështit si Bi-Lactal Premium dhe Bi-Lactal Plasma u fut përdorimi i qumështit Bi-Lactal Dessert në formë qulli si zëvendësues i qumështit të dosës. Për periudhën që vijon, sipas zgjedhjes, vihen në dispozicion variante produktesh të peletuara apo edhe qull i miellizuar.

#### **Të ushqyerit me Bi-Lactal Dessert**

Qulli i kremuar i qumështit Bi-Lactal Dessertia zë efektivisht vendin e qumështit të dosës që në ditën e parë të lindjes. Komponentët e përshtatur dhe të shijshëm nxisin të ushqyerit dhe ndihmojnë gicat gjatë fazës së parë, e cila është shpesh kritike edhe plot me humbje. Fermeri përfiton në shtimin e numrit të gicave të rritur për dosë në vit, një peshë më të madhe në fazën e shkëputjes dhe rritje më të shëndetshme. Mos prania e dosës në këtë fazë, përmirëson automatikisht nivelin e higjienës.

Në një eksperiment të bërë rishtazi, u evidentuan dhe u identifikuan sërish efektet pozitive të të ushqyerit fillestar me Bi-Lactal Dessert. Gicat e përdorur në eksperiment u ushqyen që nga dita e parë e deri në ditën e katërmbëdhjetë të lindjes me qull të kremuar qumështi.

Grupi i kontrollit nuk mori zëvendësues qumështi. Të dyja grupeve u fillua t'u jepej që nga dita e dhjetë e lindjes prestarters normal. Për një kalim me më pak probleme nga përdorimi i zëvendësuesve të qumështit në konsumimin e ushqimeve të thata të fazës së shkëputjes, përdorimi i Bi-Lactal Dessert ka funksionuar mirë.

Gicat në grupin e eksperimentuar arrinin një shtim më të lartë peshe ditore (+47 g), çka ndikonte në peshën e tyre në momentin e shkëputjes. Këta gica ishin ditën e shkëputjes së tyre (dita e 23-të) mbi 1 kilogram më të rëndë se ata të grupit të kontrollit.

Përparësitë e një peshe më të madhe në shkëputje duken qartë. Gicat janë më të shëndetshëm dhe janë kthyer tashmë në konsumues të mirë ushqimi. Ushqimit të mëvonshëm mund t'i reduktohet përqindja e përbërësve të futur si dhe e përbërësve të qumështit. Racionet ushqimore të cilat kanë konsum të lartë mund të përgatiten me një kosto më të leverdishtme. Mënyra e rritjes gjatë fazës së mëmëzimit ndikon shumë në rritjen e gicave deri në majmërim. Kështu shkurtrohet me disa ditë periudha e rritjes dhe e arritjes së peshës së plotë trupore.

Përdorimi i mënyrës teknike të të ushqyerit ka dy objektiva: të rrisë numrin e gicave të mbijetuar dhe kështu të bëjë që gicat e një zhvillimi të njëjtë të kenë peshë të kënaqshme në momentin e shkëputjes. Për rritjen e suksesshme pa dosë që nga dita e tretë e lindjes, Bi-Lactal plasma është veçanërisht e përshtatshme si edhe për përdorimin e saj në të gjitha mënyrat e zakonshme teknike të të ushqyerit.

### **Zëvendësues qumështi të një vlere të lartë**

Përbërësit dhe përbajtja e zëvendësuesit të qumështit i është përshtatur në mënyrë të përsosur qumështit të dosës. Kështu gicat marrin proteinë plazme me tretshmëri të lartë, yndyrë të disponueshme, qumësht i skremuar, imunglobulina specifike, vitaminë dhe mikroelemente. Kombinimi i fermentuesve të qumështit e mbron atë nga thartimi dhe ndihmon në tretjen. Probiotiku BonVital ndihmon në shëndetin e mirë intensinal dhe rrit sistemin imunitar.

Zëvendësuesi i fermentuar i qumështit, Bi-Lactal Premium, është i përshtatshëm si për të ushqyerit suplementar të gicave, të cilët marrin qumësht prej dosës, si edhe për gicat të cilët rriten pa praninë e dosës dhe kanë vështirësi në zhvillim. Përbajtja e qumështit të skremuar, i cili është lehtësisht i tretshëm, ndikon pozitivisht në rritje. Burime të disponueshme të yndyrave mbështesin energjinë e sistemit imunitar të gicit gjatë javës së parë të jetës.

Çdo kompleks blegtoral duhet të gjykojë nëse rritja pa dosë me ndihmën e anëve teknike është e realizueshme ekonomikisht dhe rentabël.

### **Si t'i përballojmë më mirë fazat e vështira?**

Diarreja, në fazën e mëmëzimit mund të ketë shkaktarë të ndryshme. Për një gic të sapolindur infeksionet prej bakterieve E.Coli (Escherichia Coli) dhe mikroorganizmave të tjerë përbëjnë një rrezik të veçantë. Me këtë lidhen edhe humbjet e mëdha në lëngje edhe elektrolitë. Gicat dobësohen edhe bëhen pre e sëmundjeve dytësore. Veç kësaj, masa të marra në mënyrë të pamjaftueshme dhe vdekshmëria e lartë janë pengesë për një sukses në rritje. Për një rritje me pak humbje në fazën e mëmëzimit, nevojitet profilaksi e diarresë. Me Schauman-Isolyt gicave u sigurohet një mbarëvajtje optimale në fazën e mëmëzimit dhe të shkëputjes. Natriumi dhe Kaliumi stabilizojnë përqindjen e elektroliteve. Glukoza rezulton në një furnizim të shpejtë me energji. Për më tepër substancat probiotike ndihmojnë në një tretje optimale si edhe eliminimin e bakterieve E.Coli dhe të mikroorganizmave të tjerë të dëmshëm.

### **Një rritje e shëndetshme me Bonvital**

Gjithnjë e më shpesh bëhen pyetje se si të gjendet zgjidhje për stabilizimin e imunitetit edhe të metabolizimit.

Në qendër të vëmendjes është mikroflora stabile e zorrës së hollë.

Studimet në universitetin e Berlinit tregojnë qartazi efektin pozitiv që ka Bonvital-i tek gicat në fazën e mëmëzimit. Duke shtuar Bonvital-in në ushqime, pesha e gicave në momentin e shkëputjes do të përmirësohet ballë asaj të grupit të kontrollit. Sidomos gjatë tre ditëve të para pas lindjes si edhe gjatë që prej javës së tretë të jetës, tek gicat u panë përpindje më të larta rritjeje.

Gicat e grupit të Bonvital morën më shumë prestarter. Ky efekt ishte veçanërisht i fortë në javën e katërt të jetës. Me Bonvital u përmirësua edhe përqëndrimi i jashtëqitjes gjatë gjithë periudhës së mëmëzimit. Në këtë rast ndryshimet u panë sidomos gjatë javës së tretë edhe të katërt të fazës së mëmëzimit.

Të gjitha produktet Schauma dhe SchaumaLac përmbajnë Probiotikun Bonvital, me anë të të cilit përmirësohet dhe stabilizohet shëndeti intensinal dhe i imunitetit dhe arrihen rezultate më të larta. Një sërë eksperimentesh edhe përvojash të punës në praktikë e vërtetojnë ekzistencën e suksesit me përdorimin e Bonvital-it në riprodhimin e gicave.

Edhe për rritjen në fazën e mëvonshme të gicave, koncepti me emrin Schauman ofron zgjidhje individuale, që të bëhet përzjerja e ushqimit në vetë fermat ose me apart ushqimi të transportueshëm.

### **Të rrisësh rendimentin me fermentues ushqimi Schaumann**

Kombinacione të caktuara të fermentuesve organikë janë një alternativë shumë efektive në stabilizimin e mikroflorës në aparatit tretës të derrave. Kjo sjell uljen në masë të përdorimit të medikamenteve.

Rritja e rendimentit si pasojë e ndikimit të fermentuesve organikë, bazohet në disa faktorë: Në përmirësimin e higjenes së ushqimeve, uljes së vlerës së pehashit në stomak, uljes së numrit të mikroorganizmave të veçantë atakues, rritjes së aktivitetit të enzimave, të zhvillimit pozitiv të indeve të aparatit tretës dhe të një vlerësimi më të mirë të përbërësve ushqimor. Këto efekte mund të intensifikohen nëpërmjet përzgjedhjes dhe kombinimit të fermentuesve të ndryshëm organikë.

### **Gicat kanë nevojë për mbrojtje të veçantë.**

Pas momentit të shkëputjes nga pirja e qumështit të një gici mund të bjerë niveli i përkujdesjes me fermentues qumështi. Një përzjerje fermentuesish që i korrespondon nevojave të gicit për qumësht të fermentuar, mundëson furnizimin me energji dhe bashkë me këtë aktivizimin e qelizave intensinale.



Stresi që shkaktohet shpesh nga kalimi nga një lloj ushqimi në një tjetër, reduktohet në masë dhe nxitet marrja e ushqimit nëpërmjet fermentuesve të shijshëm të qumështit (efekti CCM).

Suplementi i kombinimit të fermentuesve Schaumacid Protect me përmbajtjen e acideve yndyrore ka dhënë rezultate të mira në rritjen e gicave. Është vërejtur në praktikë një gjendje më e mirë shëndetësore dhe një stabilizim në rendiment.

### Rezultatet në praktikë

Një praktikë standarte në rritjen e derrave konfirmohet nga të dhënat e vetë fermave. U hulumtua efekti i Schaumacid Protect me MCFA (acidet yndyrore) në parametrin e rendimentit në rritjen e gicave, në rastet kur Schaumacid Protect zëvendësohet nga një përzierje e thjeshtë fermentuesish prej acidi formik dhe propionik.

1.200 gica u strehuan bashkë me 85-86 gica për boks, të cilët ishin me shtresa plastike. U caktuan 7 ndarje për grup ushqimi, dmth 600 gica. Gicat kishin në një moshë mesatare prej 28 ditësh (7 ditë pas shkëputjes) një peshë mesatare prej 7,5 kg. Të ushqyerit vijonte ad libitum me një pajisje ushqimi të lëngshëm me ushqim gjatë 42 ditëve të periudhës së rritjes.

Duke marrë parasysh kohën prej 42 ditësh të eksperimentit dhe peshën fillestare prej 7,5 kg, shtimi i peshës ditore me 500 g për ditë ishte në një nivel të lartë, aq sa në fund u arrit një peshë mesatare prej thuasje 29kg. Shtesat në peshë u përmirësuan në mënyrë signifikative, me thuasje 39g për ditë (+8%), me anë të përdorimit të Schaumacid Protect.

Me 1,55kg ushqim për çdo kg shtim në peshë, kostoja mesatare e ushqimit ishte krahasueshmërisht sa ajo e periudhës së rritjes. Me Schaumacid Protect u përmirësuan kostot e ushqimit gjatë gjithë kohës së rritjes në mënyrë signifikative 6% në krahasim me kontrollin. Kështu që u deshën 100g më pak ushqim për arritjen e 1kg shtimi në peshë. Eksperimenti shkoi pa ndonjë problem shëndetësor të gicave. Edhe në ushqimin e dosave, përzierja me fermentues qumështi dhe fermentues të tjerë ka dalë me sukses, si psh Schaumacid

F. Dosat marrin më shumë ushqim, janë më të shëndetshëm dhe rendimenti i tyre i qumështit rritet. Diarretë edhe zhdukja e E.Colit tek dosat bie dukshëm. Gicat e fazës së mëmëzimit edhe të fazës së shkëputjes mbrohen më mirë nga infeksionet. Pesha e tyre ditore rritet.

### Kërkesa specifike për ushqimin e majmerisë

Për derrat e majmerisë, acidet yndyrore këshillohen si masë profilaktike kundër diarresë. Ato eliminojnë bakteriet e dëmshme dhe forcojnë sistemin imun.

Ushqimi tretet më mirë. Përzgjedhja e përzierjes fermentuese duhet bërë respektivisht sipas sasisë së misrit në racion. Kombinimi ideal është ai me pjesë kryesore përbërëse të acidit formik dhe propionik. Ajo e plotëson në mënyrë optimale përmbajtjen natyrale me fermentues qumështi.

Një masë plotësisht efektive kundër salmonelës është përdorimi i Schaumacid S në kombinim me fermentues zinxhir të shkurtër dhe të mesëm. Efekti i menjëhershëm dhe minimizimi i vazhdueshëm i salmonelës, sikurse edhe zvogëlimi efektiv i përqindjes së sasisë së salmonelës në aparatit tretës bën që të ketë siguri në higjienë në të gjitha shkallët e prodhimit.

Programi i Schaumacid ofron fermentuesë speciale kompakte, me një ndikim të lartë antibakterial për përdorim tek gicat, dosat, derrat në majmëri, shpendët si edhe në ushqimin e lëngshëm. Në raste dhe probleme të veçanta kemi në dispozicion përzierje të tjera fermentuesish. Këshilluesi juaj i Austria Praemix ju ofron zgjidhje duke ju vizituar në vendin e punës.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)

website: [www.ap.com.al](http://www.ap.com.al)

## 14. OPTIMIZIMI I FURNIZIMIT ME CELULOZË

*Përpunuar nga Kristian Maka*

*Për të garantuar një ecuri të mirë fiziologjike të funksioneve tretëse, derrat kanë nevojë për një sasi të caktuar fibrash në ushqim. Synohet që në racionet ushqimore për derrat, gicat dhe dosat në laktacion, sasia e fibrave në ushqim të jetë 40g. Kjo vlerë për dosat barrëse duhet të jetë rreth 60g. Për shkak të organizimit të punës në ferma dhe për arsye të kostos së lartë, këto kushte nuk janë të realizueshme nga shumë ferma.*

### Funksioni i fibrave

Për derrat, që marrin një sasi më të vogël ushqimi sesa kapaciteti i tyre, furnizimi i mjaftueshëm me fibra ka ndikim sidomos për stimulimin e nevojshëm të muskujve dhe mureve të zorrëve, të cilat janë përgjegjës për qarkullimin e

ushqimit në aparatit tretës. Pjesët përbërëse të fibrave (celuloza) treten me më vështirësi ose nuk treten fare në krahasim me amidonin, karbohidratet ose proteinat dhe kanë vetinë të thithin ujë. Ushqimi i pasur me fibra çon në përthithjen e një sasive të madhetë ujit. Furnizimi i mjaftueshëm me fibër mundëson një feçe të butë dhe të lehtë për t'u eliminuar. Kjo ndikon në parandalimin e kapsllëkut.

Disa nga vetitë e fibrave janë të sigurojnë ndjesinë e ngopjes te dosat barrëse. Dosat barrëse që mbahen pa ushqim voluminoz, duhet që në periudhën e barrsmërisë të hanë ushqim të plotë me përmbajtje rreth 6% të fibrave në mënyrë që ato të jenë të ngopura, të qeta dhe tretja të funksionojë mirë.

### “Stërvitje” për periudhën e mëmëzimit

Përmbajtja e fibrës në racion e cila zërthehet me vështirësi përbën bazën ushqimore për mikroflorën e larmishme në traktin e zorrëve. Formimi i acideve yndyrore me varg të shkurtër, të cilat janë një faktor mbrojtës kundër shumimit të mikrobeve patogjene, varet nga furnizimi me SBF (substancia bakteriale të fermentueshme). Nëse mikrobeve në zorrë u mungon baza ushqimore, atëherë ekziston rreziku i shumimit të baktereve të dëmshme që nëpërmjet endotoksinave rëndojnë metabolizmin ose mund të shkaktojnë diarre.

Sasia e lartë e konsumit të ushqimit me përmbajtje energjike të ulët dhe me përmbajtje të lartë fibre, duhet të trajnohet tek dosat që në periudhën e barrmërisë, për t'i përgatitur ato të kenë mundësi të konsumojnë sa më shumë në periudhën e laktacionit. Kjo rezulton me efekte shumë pozitive në rendimentin e qumështit të dosave, në peshën e gicave në shkëputje dhe në kufizimin e humbjeve të peshës së dosës në maternitetit (max 15% të peshës trupore). Sipas përvojës së shumë fermerëve, tregohet se rritja e sasisë së fibrave të ushqimit në barsmëri, ul ndjeshëm problemin e MMA gjatë lindjes.

Sipas një studimi të kryer nga universiteti i Gisen në 177 ferma të rritjes së gicave tregoi se në fermat me furnizim me fibër të përmirësuar parametri i rendimentit “gica të lindur të gjallë për dosë në vit” është më i lartë se mesatarja. Studime të tjera shkencore tregojnë gjithashtu se përdorimi i ushqimeve të pasura me fibra, rrit konvertimin e ushqimit dhe çon në një përmirësim të përmbajtjes së azotit në jashtëqitje. Të ushqyerit me racione ushqimore me përmbajtje të lartë energjie dhe përmbajtje celuloze, kanë efekte pozitive në sasinë e numrit të gicave të lindur, si dhe konsumin e ushqimit në laktacionin e ardhshëm.

### Cilësia e fibrave

„Fibër” është një term i përgjithshëm për një grup të karbohidrateve që përcaktohet në bazë të analizave Weender të ushqimit. Këtu përfshihen lignina, celuloza, haimceluloza dhe pektina. Mbartësit e celulozës kanë përmbajtje të ndryshme të karbohidrateve dhe plotësojnë në shkallë të ndryshme nevojat e kërkua. Ushqimet me përqindje të lartë të ligninës, janë të përshtatshme për të stimuluar lëvizshmërinë e zorrëve dhe të thithinmjaftueshëm ujë si dhe i ofrojnë florës intestinale substrate pak të përshtatshme për formimin e acideve yndyrore mbrojtës me zinxhir të shkurtër. Komponentët me përmbajtje celuloze me SBF (substancia bakteriale të fermentueshme) të lartë, janë kryesore në racionet ditore të dosave.

**Tabela 1: Mbartës celuloze për dosat në mbarështim**

	Lëndë e thatë g/kg	Fibra g/kg	Energji MJ ME	Fosfor g/kg	SBF* G7KG
<b>Elb</b>	880	50	12,6	3,4	62
<b>Tërshërë</b>	880	102	11,2	3,2	66
<b>Himë gruri</b>	880	120	8,3	11,8	168
<b>Himë tërshëre</b>	910	245	5,7	1,5	120
<b>Panxhar i presuar</b>	910	150	9,5	0,8	460
<b>Bërsi luledielli</b>	900	201	10,7	9,6	204
<b>Jonxhë e bluar</b>	900	240	6,2	3,4	249
<b>Bërsi soje</b>	900	344	5,9	1,4	351
<b>Kashtë e bluar</b>	880	350	2,0	0,6	k.A.

\*substancia bakteriale të fermentueshme

#### Përzgjedhja e fibrave

Pyetja mbi mbartësit e celulozës çon shpejt në përfundimin se një mbartës celuloze i vetëm nuk mund t'i përmbush të gjitha kërkesat. Panxhari i presuar ka përmbajtje më të lartë me SBF (substancia bakteriale të fermentueshme). Përdorimi vetëm i panxharit të presuar shkakton jashqitje të hollë dhe dysheme rrëshqitëse. Hima e gruritka një përmbajtje mjaft të ulët të fibrave, rreth 12% dhe duhet të përdoret në sasi shumë të mëdha për të arritur 6% fibër në ushqim. Bërsia e sojës është më e vështirë për t'u gjetur dhe më e shtrenjtë. Kashta e bluar ka përmbajtje të lartë fibrashpor është e vështirë për t'u përpunuar dhe për sasi të mëdha e vështirë për t'u vlerësuar. Prandaj, zgjidhja e çështjes së fibrave për ushqimin e dosave për mbarështim qëndron në zhvillimin dhe sigurimin e përzierjeve me fibra që janë optimale në aspektin e përmbajtjes, cilësisë, shijes dhe higjenës së tyre.

#### PIGFASER®

Pas studimit të këtyre elementëve, SCHAUMANN ka konstatuar një hap inovativ në zhvillimin e fibrave me anë të PIGFASER®. Me markën PIGFASER® janë të disponueshme, në disa rajone të Austrisë, përzierje fibrash për derra me cilësi të përcaktuar.

Këshilluesi i Austria Praemix do t'ju informojë mbi këto mundësi të reja për një furnizim optimal të derrave me fibra.

#### Përmbledhje

Furnizimi me fibër të papërpunuar është një kusht i rëndësishëm për funksionimin e sistemit tretës dhe për rendiment të lartë të derrave dhe sidomos të dosave bartëse. Përzierjet e drithërave të papërpunuara janë më të mirë për të përmbushurkërkesat komplekse.

SCHAUMANN së bashku me PIGFASER® ka zhvilluar një produkt të ri dhe inovativ për ushqimin e dosave në mbarështim.

#### Për më shumë informacion:



**Austria Praemix shpk**

**Tel: +355 (0)68 402 6311**

**e-mail: agri@ap.com.al**

**Website: www.ap.com.al**

## 15. ORGANIZIMI NË STALLËN E DERRAVE

Përpunuar nga Kristian Maka

*Rritja e derrave: Dosat gjatë lindjes dhe gicat gjatë periudhës së pirjes, kanë nevojë për një vend të pastër me hapësirë të mjaftueshme e me temperaturë konstante. Bokset shërbejnë si mjet mbrojtës kundër dëmtimeve të gicave.*

Stalla e pjelljes është e veçuar nga të gjitha zonat e tjera të prodhimit. Një klimë optimale e stallës, si dhe mbrojtja nga luhatjet ekstreme të temperaturës janë të rëndësishme për shëndetin dhe mirëqënien e kafshëve. Në këtë kontekst, boksi i gicave ka një rëndësi kryesore. Nga ana e personelit përgjegjës, kontrolli duhet të bëhet si gjatë procesit të pjelljes ashtu edhe gjatë periudhës së laktacionit. Kjo kërkon që krevatet e martenitetit dhe bokset e gicave të jenë sa më të dukshëm nga syri i njeriut, me klimë sa më optimale. Kontrolli dhe pastrimi i lugut të ushqimit dhe pirësive së ujit duhet të kryhet lehtë dhe pa shumë shpenzime, ashtu si pastrimi dhe dezinfektimi pas shkëputjes. Në stallë me planimetri të drejtë, bokset e gicave vendosen në krah të dosës. Në stallë të ndërtuar me planimetri të zhdrejtë, trogu i ushqimit të dosës montohet në cep të boksit të lindjes ndërsa boksi i gicit përbri lugut.

Boksi duhet të jetë i lidhur, i fiksuar si dhe i adaptueshëm me gjerësinë dhe gjatësinë e dosës. Hapësira maksimale duhet të jetë të paktën me gjatësi 190 cm nga lugu i ushqimit dhe gjerësi 65 cm. Klima e stallës duhet t'u përgjigjet nevojave të gicave. Mënyra optimale për ngrohjen e gicave bëhet me pllakë ngrohjeje nga poshtë, me energji elektrike ose me ujë të ngrohtë.

### Sistemi i ajrimit

*Stallat e derrave: Rendimenti i lartë është i mundur vetëm nëse temperaturat dhe furnizimi me ajër të pastër plotëson nevojat e derrave. Në të kundërt duhet të merren masa: të përmirësohet izolimi, të rikuperohet nxehtësia e humbur dhe të ketë ngrohje shtesë.*

Për të shmangur lagështinë në shtresat izoluese të murit, duhet që tavanet dhe muret të ndërtohen në mënyrë të tillë që përshkueshmëria e avujve të ujit nga brenda jashtë dhe shtresë pas shtrese të rritet. Vetia izoluese e shtresave të murit (rezistenca termike) duhet të rritet gjithmonë nga brenda-jashtë. Nëse doni të llogarisni humbjen e nxehtësisë sot nuk përdoret më vlera "k" por "u" si parametër i përshkueshmërisë.



### Tingujt në stallë

*Studim: Një mjedis i larmishëm për derrat e majmërisë rrit gjithashtu cilësinë e mishit.*

Kjo u zbulua nga një studim i institutit të kërkimeve biologjike në kafshët e fermës në Dummerstorf, Gjermani. Derrat që lëvizin më shumë, ndërtojnë vazhdimisht fije muskulore që përmbajnë më shumë mioglobinë dhe janë më të kuqe. Studiuesit kanë vendosur në bokset e derrave tasa ushqimi me tinguj, në mënyrë që kafshët të jenë sa më aktive. Me ndihmën e një tingulli të ngjashëm me zilen e një telefoni celular, kafshët afrohen dhe ushqehen me ushqim 8 herë në ditë.

Secilës kafshë i caktohet një melodi individuale, në mënyrë që vetëm kjo kafshë të ushqehet në automatet e ushqimit dhe pa u shqetësuar nga kafshët e tjera. Në këtë mënyrë kafshët merren me një aktivitet, ka më pak stres gjatë ushqyerjes dhe më pak konkurrencë për ushqim.

### Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

## 16. SHKAQET E SËMUNDJES SË EDEMËS

Përpunuar nga Kristian Maka

Edema shkaktohet nga toksina Shiga-2e (Shigatoxin-2e) Stx2e, e prodhuar nga shtamet hemolitike E. Coli (STEC).


Termi Shigatoxin gjendet edhe si "Verotoxin". STEC hyn në organizmin e derrave përmes rrugëve orale dhe krijon habitatin e vet në zorrën e hollë, ku bashkohet dhe shumohet në qelizat e murit të zorrëve me ndihmën e fibrave të tyre.

STEC prodhon Shigatoxin në vilet intensinale të zorrëve, nga ku futet në qarkullimin e gjakut përmes murit të zorrëve. Më pas Stx2e shkakton dëme të konsiderueshme në enët e gjakut dhe organe. Edema vjen si pasojë e grumbullimit të lëngjeve në muret e dëmtuara të enëve të gjakut.

Vaksina inicion formimin e antitropave neutralizues ndaj shigatoksinës. Kjo parandalon dëmtimin e kapilarëve dhe të organeve. Faktorët e rrezikut për vendosjen dhe përhapjen e STEC/ fillimin sëmundjes së edemës:

- Ndryshimi i ushqimit
- Raporti i pafavorshëm i kafshëve me vendet e ushqimit
- Fillimi i një recete të re ushqimore
- Sasia Puferike e lartë (vlera të çrregullta të pH)
- Mungesa e acidifikimit të ushqimit për stabilizimin e pH dhe mbrojtjes së stomakut

### MËNYRA E VEPRIMIT TË E.COLI-SHIGATOXIN 2E



- Stresi i ndryshimit të ambientit (kalimi nga boksi në boks, përplasje për hierarkinë, temperaturë shumë e lartë ose shumë e ulët e ambientit)
  - Transporti
  - Ndërprerja e antibiotikëve dhe/ ose oksidit të zinkut
- Përveç shigatoksinës, një pjesë e konsiderueshme e STEC përmban edhe enterotoksinë, kjo është arsyeja pse diarreja ndodh në disa ferma menjëherë pas shkëputjes nga dosa, por humbje të mëdha për shkak të sëmundjes së edemës ndodhin gjatë procesit të rritjes.

### Simptomat e sëmundjes

Pasi janë shfaqur shenjat klinike të sëmundjes së edemës, praktikisht çdo trajtim është i vonë.

Shigatoksina është një nga helmet më të fuqishme dhe shkatërron murin e kapilarëve të vegjël të gjakut. Kjo çon në akumulimin e lëngut në inde. Veçanërisht të prekur janë zorrët, indet nënlëkurore dhe truri. Rezultati është edema e qepallave, urë e hundës dhe zorrëve/ mesenteries. Për më tepër, kafshët tregojnë konvulsione, paralizë dhe lëvizje të pakontrolluara si rezultat i deficiteve neurologjike.

Nëse E. Coli formon edhe enterotoksina të tjera, vërehet diarre dhe dehidratim. Sidoqoftë, në varësi të përmbajtjes së toksinave, shfaqen sëmundje parakute të ndryshme të kafsha. Në këtë rast, ka ngordhje të papritur, madje edhe pa shfaqje tipike të edemës. Nëse kafshët i mbijetojnë sëmundjes, ato mbeten prapa në rritjen dhe shtimin në peshe në krahasim me gicat e tjerë në boks.

Simptomat e mëposhtme mund të vihen re:

- Shenja subakute deri në akute
- Proces i zgjatur i rritjes
- Paraqitje me kurriz të valëzuar të gicit (sporadike)
- Rritje të humbjeve për një periudhë më të gjatë kohore

Për më shumë informacion:



**Q F** Qendra e Formimit  
**P B** Profesional të Blegtorëve

**Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)

**Website:** [www.ap.com.al](http://www.ap.com.al)

## 17. SUKSESI NË STALLË

Përpunuar nga Jon Zeneli

Austri 2014: për çdo pjellje kanë lindur mesatarisht 11.7 gica për dosë dhe 10.8 gica për paradosë, pra mesatarisht kemi 25.5 gica për çdo dosë në vit.

Si të reduktojmë ngordhjen e gicave? Gjenetika?

Kushtet e stallës? Ulja e stresit?

Lidhja njeri-kafshë?

Sektor kritik: menaxhimi i ndërzimit dhe i lindjes

### Menaxhimi i pjellorisë

Mekanizmat hormonale reagojnë ndjeshëm ndaj ndryshimeve të jashtme. Funksonimi i ciklit pas shkëputjes dhe shfaqja e sjelljeve të afshit, ndikohen nga shumë faktorë. Gjatë laktacionit duhet të pinë minimumi 8 gica, përndryshe dosa vjen në afsh. Mbas fazës së shkëputjes fillon të punojë përsëri „sistemi i të dhënave“ i cili nëpërmjet një bashkëveprimi të zonave të caktuara të trurit, rregullon vezoret dhe mitrën. Përgjegjës për këtë janë hipotalamusi dhe hipofiza, pjesë të diencephalonit, që luajnë rol edhe në mekanizma të tjerë hormonalë si për shembull tiroidet dhe veshkat. Transmetimi i impulseve nga truri drejt vezoreve dhe mitrës bëhet me ndihmën e hormoneve. Folikulat rriten dhe prodhojnë vezë. Mitra përgatitet për të pritur vezët e fekunduara. Këto mekanizma duhet të merren parasysh në një mbarështim bioteknik. Ka edhe faktorë të tjerë që ndikojnë në këtë sistem të dhënash. Pra një ushqyerje e mirë nxit gjendjen e afshit dhe trashësinë e duhur të dhjamtit në kurriz. Zhvendosja e rrugës së hormoneve nga prodhimi i qumështit lehtësohet edhe duke bërë një ndryshim të ambientit. Masat që duhen marrë:

- ♦ Kalimi direkt nga marteniteti në qendrën e ndërzimit
- ♦ Formimi i menjëhershëm i grupeve mbas shkëputjes, në kafaze të ndarë me hapësira të bollshme dhe të shtruar, përpara se të futen në bokse të veçantë në qendrën e ndërzimit
- ♦ Reduktimi i racionit ushqimor, ditën e shkëputjes
- ♦ Që nga dita e tretë pas shkëputjes, të mundësohet kontakti me orë të zgjatura me një harç dhe nëse është e mundur një stimul nga një harç i dytë
- ♦ Një qendër ndërzimi me 12 orë ndriçim dhe me një intensitet të lartë drite

Gjatë kohës së afshit dhe ovulacionit, furnizimi i lartë me ushqim të pasur me karbohidrate (energji 40 MJ) ka gjithashtu një efekt pozitiv për periudhën pas shkëputjes.

### Koha optimale për ndërzim

Ovulimet ndodhin në fillim të fazës së tretë të afshit. Praktikisht kjo nuk mund të parashikohet me saktësi. Përveç kësaj, jetëgjatësia e spermatozoidëve në dosë është e kufizuar në afërsisht 18 orë dhe spermatozoidët në mitrën e dosës duhet të kalojnë një proces pjekurie derisa të jenë të aftë për fekondim. Pas ovulimit, fekondimi i vezës mund të ndodhë në një periudhë kohore prej 4 orësh.

Prandaj është e rëndësishme të njihni sjelljet e afshit të kafshës për të kuptuar kohën optimale për ndërzim dhe më pas të organizoni hapat e punës. Nga vëzhgimet e shumta, fermerët mund ta kategorizojnë tufën e tyre në tre tipa të afshit:

–Afsh i parakohshëm: Dosat, të cilat pas ditës së tretë të shkëputjes „qëndrojnë“ para harçit. Këto dosa duhet të ndërrehen relativisht më vonë pas ardhjes në afsh (sipas sjelljes së dosës). Zakonisht afshi i dosës zgjat disa ditë. Ndërzimi i parë ndodh 24 orë pas fazës së moskundërshtimit. Një ndërzim i dytë optimal ndodh pas 12 deri në 16 orësh. Një ndërzim i tretë duhet të aplikohet vetëm tek ato dosa të cilat tregojnë një moskundërshtim të mirë, sepse nga një ndërzim shumë i vonë ulet mbrojtja e uterusit kundër infeksioneve dhe rritet rreziku i infeksioneve në mitër.

–Afshi normal: Kalojnë në afsh ditën e pestë pas shkëputjes. Pas kalimit në moskundërshtim duhet të pritet rreth 12 orë deri në ndërzim.

–Afshi i vonshëm: Me kalimin në moskundërshtim dosat duhet të ndërrehen menjëherë, meqënëse koha në afsh është shumë e shkurtër.

Monitorimi i ndërzimeve ndihmon në verifikimin e kohës së ndërzimit. Për këtë shënohet dita e shkëputjes, ora, numri i pjelljeve, fillimi, mbarimi i afshit dhe takimet e ndërzimit. Këto shënime japin një panoramë shumë të mirë të sjelljes afshore të dosave.

Këto lloj shënimesh tregojnë që shumica e kafshëve e përjetojnë të njëjtin tip afshi gjatë gjithë jetës së tyre. Kërkimet tregojnë, se dosave, të cilave u duhen më shumë se gjashtë ditë nga shkëputja deri në kalimin në afsh, kanë një përkeqësim të performancës së pjelljes. Nëse ka shumë dosa me një ndërzim shumë të vonshëm duhet të verifikohet menaxhimi i pjellorisë, shëndeti i kafshëve, ushqyerja dhe higjiena e ushqimit.

### **Përfundim**

Për një performancë të mirë duhet që të optimizohen të gjithë faktorët e tjerë si: kushtet e rritjes dhe masat e menaxhimit. Ndërzimi është një nga këta faktorë. Kush dëshiron të arrijë një përmirësim, duhet të bëjë një panoramë të sjelljes afshore të tufës së tij dhe të verifikojë nëse përputhet koha dhe shpeshtësia e ndërzimit në ecurinë e fermës.

**Për më shumë informacion:**



**Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve**

**Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)

**Website:** [www.ap.com.al](http://www.ap.com.al)



## 18. PARANDALIMI I KAFSHIMIT TË BISHTIT TE GICAT

*Përpunuar nga Jon Zeneli*

*Në kuadër të eksperimenteve që në qendër të tyre kanë kafshimet e bishtit të gicave, janë përdorur pajisje dhe mjete të ndryshme. Çfarë është tërheqëse dhe argëtuese për gicat? Këto janë vlerat e para të përvojës për përdorimin e pajisjeve me anë të të cilave mund të pengohet një kafshim akut.*

### **Pajisjet duhet të jenë përherë tërheqëse**

Te pajisjet që përdorim duhet të kemi parasysh që të jenë përherë tërheqëse. Të pafavorshme në këtë drejtim janë pajisjet që varen veç e veç në murin ndarës të bokseve dhe mund të "arrihen" vetëm nga një gic.

Në përgjithësi vlen: Numri i pajisjeve duhet të shtohet me rritjen e numrit të kafshëve. Për gjashtë deri në dymbëdhjetë derra duhet të jetë e disponueshme minimalisht një lodër. Eksperimentet tregojnë, që gica të veçantë kanë "preferenca" të veçanta. Disa gica preferuan lodrën Bite-Rite, të tjerë pëlqyen më tepër shtrëngimin e litarit, disa preferuan copën e drurit në dysheme, të cilën e shtynin me hundë dhe mund ta ngrinin lart. Prandaj është e rëndësishme të ofrohen sende të ndryshme, në mënyrë të tillë që të përmbushet deri diku çdo preferencë.

### **Burimet materiale - të kushtueshme, por të pëlqyera**

Si burime materialesh janë marrë materialet organike jo të dëmshme, të cilat kafshët mund t'i ndryshojnë ose mund t'i hanë. Kombinimi i objekteve me ushqimin, i bën gicat më të tërhequr ndaj lodrave. Në direktivën austriake të 2004 për mbajtjen e kafshëve quhen: kashtë, sanë, dru, tallash, përzierje kërpudhash ose torfe. Sigurimi i materialeve përbën gjithmonë disa shpenzime, si gjetja e enëve të përshtatshme, sasia dhe higjiena e kontrolluar në mënyrë periodike.

Dhënia e celulozës dhe e ushqimit të strukturuar apo materiali i përdorshëm në eksperimentet tona rezultoi efektiv kundër kafshimit të bishtit. Interesant ishte fakti, që dhënia dy herë në ditë në sasi të vogla e kashtës dhe e jonxhës reduktonte dukshëm kafshimin dhe madje e ndalonte atë. Edhe pse përdorimi i pajisjeve zgjati pak, kafshimi i bishtit u reduktua brenda një dite nga 50 - 90 %.

### **Të krijojmë zbavitje dhe të gjejmë kafshuesin.**

Parimisht këshillohet, që në rast të kafshimeve të bishtit, të tentohet si fillim të krijohet zbavitje. Në këtë pikë fantazisë nuk i vendosen limite, nëse përdoret bar apo kashtë, degë të pemëve frutore apo pemë halore, bimë misri, qese letre ose litar, gjithçka që nuk dëmton kafshën, është përpjekje e vlefshme dhe për gicat është diçka e këndshme.

Nëse kafshimi i bishtit nuk është shmangur ende përmes kësaj përpjekje, atëherë shfaqen plagë të lehta. Kafshët ngacmuese janë ato kafshë të cilat prekin në bishtat e gjakosur, pa shkaktuar dëmtime të këqija në to. Vetëm kështu kemi mundësinë për të gjetur "keqbërësin" e vërtetë, i cili nuk tërhiqet nga kjo zbavitje.

Për të gjetur kafshuesin, duhet të gjejmë një moment, kur të gjithë gicat në boks janë aktivë. Zakonisht kjo ndodh në orët e mbasdites. Normalisht mjafton të qëndrosh 10 minuta në anë të boksit, për të përcaktuar një apo dy gica të dyshuar si kafshues. Këtyre u bëjmë si fillim një shenjë me një marker që përdoret për të shënuar bagëti. Ditën tjetër përsërisim të njëjtën gjë dhe nëse një nga dy gicat e shënuar kafshon, atëherë jemi relativisht të sigurt se kemi gjetur shkaktarin. Është e qartë sidomos, nëse kafsha e vëzhguar kafshon fort.

Me kafshim të fortë kuptojmë, nëse kafsha e kafshuar bërtet dhe tenton të largohet. Zakonisht kafshuesi nuk e lëshon bishtin e gicit të rënë pre, çka çon në dëmtime të mëdha dhe shkaktan dhimbje. Një gic i tillë duhet të largohet nga boksi. Kashta në koritat e kashtës me pjesë mbajtëse në fund dhe me rogoz shtesë, si dhe ushqimi me jonxhë nuk shkaktuan te gicat e eksperimentuar asnjë problem me sistemin e plehut organik, edhe pse ajo ishte në dispozicion gjatë gjithë periudhës së rritjes së gicave. Veçanërisht jonxha u konsumua totalisht nga ata. Maksimalisht bien vetëm disa gram në ditë nga rrjeta e koritës.

Për më shumë informacion:



**Austria Praemix shpk**


**Tel: +355 (0)68 402 6311**

**e-mail: agri@ap.com.al**

**Website: www.ap.com.al**

## 19. TEMPERATURAT E LARTA NË VERË-FAKTOR I RËNDËSISHËM PËR T'U KONTROLLUAR

Përpunuar nga Jon Zeneli



Verë, diell, ditë të nxehta- për derrat këta faktorë janë stresues. Marrja e masave të parakohshme do të parandalojë stresin nga i nxehti. Koncepti SHAUMANN ofron zgjidhje individuale për rezultate sa më të mira.

### Konsumi i ushqimit

Frymëmarrja e shpeshtë është një tregues i temperaturës së lartë trupore të derrat. Derrat dhe dosat reagojnë ndaj temperaturave të larta duke kufizuar marrjen e ushqimit. Temperatura e përshtatshme për dosat dhe derrat është 18-21°C. Çdo rritje e temperaturës do të thotë 100-150 gram ushqim më pak për çdo gradë celcius. Pasojat e humbjes së oreksit, mungesa e energjisë dhe lëndëve ushqyese, gjatë muajve të verës, shoqërojnë të gjitha fazat e prodhimit. Te dosat rendimenti i prodhimit ulet nga temperaturat e larta.

### Qarkullimi i ajrit në stallë

Qarkullimi i ajrit në stallë është një nga masat e shumta për të parandaluar stresin nga nxehtësia. Temperatura do të ulet me 2-3°C, nëse me ndihmën e masave teknike shpejtësia e ajrit do të rritet me 0,5 m/s.

### Rritja e burimit energjistik

Rritja e burimit energjistik gjatë muajve të verës ndikon në reduktimin e konsumimit të ushqimit dhe kjo gjë çon në reduktim të problemeve si p.sh.:

zgjatje e procesit të lindjes, qarkullim i dobët te dosat, mungesë qumështi dhe humbje peshe gjatë laktacionit. Përmbytja e yndyrave të papërpunuara në racionin ushqimor mund të rritet deri në 5%. Rritja e sasisë së sojës dhe vajit të kozlës është e kufizuar. Këtu gjen përshtatjen dhe përdorimin në mënyrë perfekte yndyra e koncentruar e thatë Schauma Lipo Plus, e cila ofron përmes formës së saj si pluhur, një përzierje më të mirë. Shtimi i dekstrozës, saharozës dhe qumështit pluhur, siguron shpërndarjen e energjisë dhe shije të mirë.

**SchaumaCid Energiemix**, kombinim i lëngshëm i glicerines, acidit laktik dhe atij formik, ka përdorim të lartë. Mikrobet e padëshiruara reduktohen, sigurohen nevojat për glukozë, sidomos për problemet metabolike.

### Qetësimi i metabolizmit

Gjatë procesit të zbrërthimit të proteinave të papërpunuara në organizëm, çlirohet shumë nxehtësi. Nëpërmjet ushqimit të pasur me aminoacide, mund të reduktohet sasia e sojës me qëllim që metabolizmi të funksionojë. Temperaturat e larta kanë ndikim negativ mbi dosat që kanë probleme me pjellorinë, pasi problemet me ardhjen në afsh shtohen. Mundësia e ndërzimit zvogëlohet.

**SchaumaLac RF** stimulon afshin dhe përmirëson pjellorinë.

Në periudhën e paralindjes është provuar që përdorimi i **Schauma Omni-S** ka efekte të dobishme. Kombinimi i vajit të salmonit me cilësi të lartë dhe fibrave të papërpunuara ndihmojnë në tretje. Në këtë mënyrë bëhet largimi më i shpejtë i mikrobeve të dëmshme.

**Acidet yndyrore Omega-3** forcojnë sistemin imunitar dhe japin vitalitet. Rezultati është një konsumim më i lartë i ushqimit.

Ndikimi i qarkullimit të ajrit në temperaturën („Efekti Chill“)

IST-Temperatura °C	Lagështia relative %	Perceptimi i temperaturës me shpejtësi ajri m/s			
		0	0,5	1,0	1,5
35	50	35,0	32,2	26,6	24,4
29,5	50	29,5	26,6	24,4	22,8
24	50	24,0	22,8	21,1	20,0

Sipas: R. Barnwell, Pittsburg, Texas 2002

## Cilësia e ujit të pijshëm

Kontrrollet e rregullta të cilësisë së ujit të pijshëm dhe pirja e ujit të pastër dhe pa mikrobe, duhet të kryhet vazhdimisht nga ndërmarrjet blegtorale. **SchaumaDes Clean WS**, dezinfektues i ujit të pijshëm, tretet në tubacionet e ujit dhe frenon shtimin e mikroorganizmave të dëmshme.

## Parandalimi i stresit nga vapa

- ♦ Racionimi i ushqimit duhet të lehtësojë funksionin e metabolizmit (përmbajtje e ulët e proteinave, përdorimi i burimeve energjike p.sh.: nga vaji bimor, duhet të merret parasysh gjithashtu përmbajtja e lartë në energji në periudha të nxehta).
- ♦ Përdorimi i komponentëve ushqimorë të shijshëm. Përdorimi i produkteve specialë (psh. SCHAUMALAC FIT ose SME-STABIL) për të reduktuar stresin.
- ♦ Përdorimi i SCHAUMACID për luftimin e mikroorganizmave.
- ♦ Të jepet ushqim me intervale të shkurtra dhe me racione të vogla.
- ♦ Qasje në ujë të pastër dhe pa mikroorganizma. Reduktimi i faktorëve të tjerë stresues si p.sh.: ndërrimi i stallës apo vaksinimi të bëhen në mëngjes ose në darkë, kur temperaturat janë më të ulta.
- ♦ Të shmangen rrezet e diellit të drejtpërdrejta, të errësohen përkohësisht dritaret.
- ♦ Përkujdesja për qarkullimin e mjaftueshëm të ajrit dhe përshtatja e një sistemi ajrimi me spërkatje ajri.
- ♦ Spërkatja e dyshemesë me ujë. Spërkatja e derrave me ujë.

## Për më shumë informacion:



**QFBP** Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve

## Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**Website:** www.ap.com.al

## 20. SHMANGNI STRESIN NGA TEMPERATURAT E LARTA GJATË TRANSPORTIT TË KAFSHËVE

Përgatitur nga Franz Riegler, këshillues i Schaumann dhe aksioneri i Austria Praemix shpk. Përpunuar nga Jon Zeneli



Vera ka ardhur dhe temperaturat e larta tashmë kanë mbërritur. Në temperatura të larta, ekziston një probabilitet shumë i lartë që transporti të ketë një ndikim negativ në integritetin fizik të kafshëve që transportohen. Prandaj, transportet në distancë të gjatë duhet të shmangen dhe udhëtimet e shkurtra duhet të bëhen gjatë natës.

Nëse pavarësisht nga temperaturat e larta transportet kryhen, duhet të merren masat e mëposhtme parandaluese për të shmangur stresin e nxehtësisë sa më shumë që të jetë e mundur dhe për të mbrojtur shëndetin e kafshëve.

### 13 këshilla për të shmangur stresin nga temperaturat e larta

1. Nëse gjatë transportit pritet që temperaturat të shkojnë mbi 35 °C, atëherë mos i transportoni kafshët.
2. Kafshët duhet të lëvizin sa më pak të jetë e mundur (gjatë ngarkimit, udhëtimit, etj.)
3. Inspektimi i shpeshtë i kafshëve për shenja të stresit nga vapa (p.sh. frymëmarrja me gojë të hapur, frymëmarrje e shpejtë, djersitje, qafa e shtrirë te gjedhët).
4. Sigurohuni që të gjitha kafshët të kenë akses pranë ujit të freskët.
5. Merrni me vete sisteme lëvizëse të pirjes për të lehtësuar aksesin e ujit për të gjitha kafshët.
6. Ulni densitetin e ngarkesës me të paktën 30%, veçanërisht në pjesët më të nxehta të automjetit (afër pjesës së përparme të kabinës dhe në kuvertën e sipërme). Sigurohuni që të gjitha kafshët të kenë hapësirë të mjaftueshme për të ekuilibruar nxehtësinë e trupit.

7. Mjetet transportuese duhet të kenë hapësirë dhe lartësi ndërmjet kafshëve dhe pjesës së tavanit për të maksimizuar qarkullimin dhe shkëmbimin e ajrit.
8. Transportet rekomandohen të kryhen natën, shmangni orët më të nxehta të ditës.
9. Gjithmonë parkoni në hije, idealisht në kënd të drejtë nga fryn era.
10. Gjithmonë ndizni ventilimin kur automjeti është i ndaluar.
11. Përdorni automjete me një mbulesë me ngjyrë të hapur për të shmangur grumbullimin e nxehtësisë (e detyrueshme për transporte mbi 8 orë).
12. Hartoni një plan emergjence për të gjitha transportet: çdo vonesë, bllokim trafiku, prishje e automjetit, etj. mund të ketë pasoja serioze (e detyrueshme për transporte mbi 8 orë).
13. Planifikim i kujdesshëm për të shmangur kohën shtesë të pritjes, p.sh. në kufij.

### Për më shumë informacion:



### Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**Website:** www.ap.com.al

## 21. KLIMA NË STALLË

Përpunuar nga Kristian Maka



### Klima në stallë

Në mënyrë që të shfrytëzohet më së miri kapaciteti prodhues i tufës në fermë është e rëndësishme që kafshët të ndihen mirë në ambientin e tyre. Një ndikim të konsiderueshëm në këtë aspekt ka klima në stallë. Stallat e mbyllura duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që temperaturat e brendshme të jenë të pavarura nga temperaturat e ambientit të jashtëm, gjithashtu dhe gjatë ndërtimit të stallave me ajrosje të lirë duhet të shfrytëzohet fuqia e erës si dhe të përdoren materiale me izolim termik.

Në stallat e mbyllura ventilatorët dhe kondicionerët sigurojnë ajrosjen e duhur duke mundësuar kështu largimin e nxehtësisë, avullit dhe gazeve. Në praktikë, në stallat e derrave dhe në kapanonet e pulave përdoren sistemet e vakumit. Vitet e fundit synohen si pasojë e zhvillimit dhe rritjes së numrit të kafshëve si dhe zgjerimit të hapësirave në stalla gjithnjë e më shumë zgjidhje të decentralizuara, pasi dhe rregullat janë dhe më të lehta për t'u hartuar. Qarkullimet qendrore të ajrit mund të jenë të favorshme, nëse merret në konsideratë mbrojtja e ambientit ose sistemet e rikuperimit të nxehtësisë. Tek sistemi qëndror i thithjes së ajrit vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmasave të kanaleve të ajrosjes. Në stallat e pulave punohet që prej disa kohësh edhe me të ashtquajturin sistem ventilimi në formë tuneli. Këtu përthithet i gjithë ajri nga pjesa ballore e stallës, ndërsa furnizimi me ajër bëhet nga pjesa e pasme.

Në rastet kur sistemet e ajrosjes janë të detyrueshme, ventilatorët janë baza e sistemit dhe përmes tyre stimulohet qarkullimi i nevojshëm i ajrit. Në praktikë përdoren më së shumti ventilatorët boshtorë. Mënyra se si ato janë ndërtuar ka një ndikim të konsiderueshëm në konsumimin e energjisë elektrike. Në varësi të kërkesave ndaj nivelit të presionit dhe zhurmës së ventilatorëve janë ndërtuar ventilatorë të shpejtë dhe të ngadaltë. Kursimet e energjisë në varësi të llojit mund të shkojnë deri në 50%, kështu amortizimi, pavarësisht kostove të larta të blerjes, është i mundur nga tre deri në pesë vjet.

**Teknikat e shkarkimit të ajrit** përfshijnë tubat për shkarkimin e ajrit, difuzorë, hundëza dhe pajisje të tjera. Diametri i tubit të shkarkimit duhet të përshtatet me ventilatorin, për të shmangur turbulencat e panevojshme, të cilat janë pasojë kryesisht e vakumeve të krijuara. Vendi më i përshtatshëm për instalimin e ventilatorit është poshtë tubit të shkarkimit të ajrit. Përdorimi i difuzorëve

dhe i hundëzave çon në reduktimin e presionit deri në 30 Pa, kjo pasi hyrja dhe dalja e ajrit në stallë lehtësohet në mënyrë të konsiderueshme. Në praktikë është rritur në mënyrë të konsiderueshme numri i instalimit të këtyre pajisjeve, të cilat gjithashtu ndikojnë në kursimin e energjisë elektrike.

**Ajrosja** duhet të garantohet pavarësisht nga lloji dhe mënyra e ndërtimit të stallës. Ajri duhet të qarkullojë pa pengesa në zonën ku rrinë kafshët dhe është e nevojshme që të ndërtohen sisteme ajrosjeje fleksibël me fuqi ajrimi të lartë. Kështu ajrosja do të përshtatet nevojës së kafshëve. Shpejtësia e lejuar e qarkullimit të ajrit në stallë varet nga struktura e kafshëve, nga temperatura e ajrit që hyn dhe nga përmbajtja e ajrit në stallë. Vitet e fundit ventilimet me zhvendosje kanë qënë më të përdorshme krahasuar me ventilimet me përzierje.

**Hyrja dhe shpërndarja e ajrit** në stallë funksionon siç duhet nëse respektohen kriteret e mëposhtme: shpejtësia e ajrit në kanal duhet të mos i kalojë 2,5 m/s; qarkullimi i ajrit të jetë ndërmjet 200 dhe 300 m<sup>3</sup>/h dhe m<sup>2</sup> sipërfaqe; në rastet kur ajri hyn vetëm nga njëra anë gjatësia e kanalit nuk duhet të kalojë 15 m dhe kanali nuk duhet të jetë i vendosur direkt në mur. Bazuar në këto kriteret zakonisht kanali ka një lartësi prej 30-50 cm. Edhe mbi këtë metodë furnizimi me ajër janë kryer teste mbi cilësinë e metodës dhe janë hartuar raporte.

Një mënyrë tjetër e aprovuar e ventilimit me zhvendosje është depërtimi i ajrit nga grazhdi i ushqimit. Faktor kufizues është matja e volumit të qarkullimit të ajrit në çdo hapësirë të stallës. Në mënyrë të përmbledhur kriteret e mëposhtme kanë rëndësi të veçantë: shpejtësia e ajrit në grazhdet e ushqimit nuk duhet të kalojë 2,5 m/s; gjatësia e koridorit nuk duhet të jetë më shumë se 15 m dhe muret ndarëse për grazhdet e ushqimit duhet të jenë minimalisht aq të lartë sa hapësira në derë, nga ku hyn ajri. Vrima nga ku thithet ajri në stallë duhet të jetë mundësisht në afërsi të hyrjes së ajrit në stallë, në mënyrë që të garantohet qarkullimi i duhur i ajrit.

**Si alternativë** për ventilimin me zhvendosje në praktikë instalohen dhe ventilimet me përzjerje, sidomos për mbajtjen e shpendëve dhe mbjelljen e bimëve. Në këtë rast gjatë planifikimit duhet të respektohen parametrat e mëposhtëm:

- shpejtësia maksimale e hyrjes së ajrit në verë duhet të jetë 4m/s
- shpejtësia minimale e hyrjes së ajrit në dimër duhet të jetë 1,0 m/s
- instalimi i pjesëve të ventilimit duhet të bëhet në pjesën e sipërme të mureve të jashtëm
- raporti i lartësisë me gjatësinë e hapësirës në stallë duhet të jetë maksimalisht 1:4.

Parimisht është i vlefshëm parimi, që ajri në verë të mos largohet nga çatia, pasi për shkak të rrezatimit të lartë të diellit në stallë mund të depëtojnë temperatura të larta nga 70°C deri në 80°C. Ajri në sistemin e ventilimit duhet të hyjë në anën e djathtë të ndërtesës së stallës dhe në rast se kjo nuk është e mundur, atëherë është e këshillueshme mbjedhja e pemëve ose shkurreve për të krijuar hije. Ulja e temperaturave në stallë mund të arrihet dhe nëpërmjet përdorimit të pajisjeve për avullimin e ujit ose nëpërmjet spërkatjes me ujë të kanaleve të ajrimit.

**Ngrohja:** shumica e metodave të mbajtjes së gjedhëve të mirëprovuara në praktikë parashatrojnë nevojën e përdorimit të sistemeve të ngrohjes. Karakteristikat specifike të stallave përcaktojnë dhe zgjedhjen e sistemeve të duhura. Për pjesët e stallës ku nevojitet temperaturë e ulët dhe për ngrohjen e hapësirave të stallës si p.sh. pas pastrimit përdoren cilindrat me gaz. Këto pajisje janë të karakterizuara nga një spektër i gjerë përdorimi dhe janë relativisht të kushtueshme. Në rastet kur ka kërkesa të veçanta mbi ajrosjen në stallë, si p.sh. rregullimin e temperaturës në zonën ku qëndrojnë kafshët ose përcaktimin e luhatje të vogla të temperaturës në stallës etj. këshillohen sisteme më të sakta nga ana funksionale.

Nisur nga specifikat e stallës dhe kategorive të kafshëve mënyrate mëposhtme të ngrohjes janë konsideruar si të vlefshme:

1. Konvektorët e gazit- në këtë rast ajri i nxehtë shpërndahet me anë të spiraleve në mënyrë të njëtrajtshme në stallë;
2. Ngrohja me ujë të ngrohtë- këtu ambjentet e stallës ngrohen nëpërmjet tubave delta ose dopio si dhe tubave 1,5" deri në 2", përcaktimi i shpërndarjes së nxehtësisë mundësohet duke përdorur sisteme standarde;
3. Ngrohja e zonave- sidomos në sektorin e rritjes së gicave, praktikohet akoma ngrohja dyshemesë me ujë të ngrohtë, kjo mundësisht e kombinuar me rreze infra të kuqe (për të parandaluar humbjen e nxehtësisë, sipërfaqja e dyshemesë duhet të jetë e izoluar termikisht. Me kalimin e viteve u zhvilluan dhe panele ngrohjeje të parafabrikuara me beton të lehtë ose plastikë.)
4. Sistem ngrohës me radiatorë- këtu përdoren që prej disa kohësh radiatorët, veçanërisht në stallat e mbajtjes e shpendëve. Nxehtësia në dysheme gjatë përdorimit të sistemit ngrohës me radiator është e njëtrajtshme.

**Pajisjet rregullatore** moderne ofrojnë shumë funksione. Përveç mundësisë për të përcaktuar temperaturën e dëshiruar ekziston dhe mundësia e kontrollimit të kapakëve të furnizimit dhe të shkarkimit të ajrit, e kontakteve të ngrohjes dhe e sistemit të alarmit etj. Nëpërmjet përdorimit të pajisjeve kompjuterike për ajrosjen e stallës, funksioneve të mësipërme mund ti shtohen dhe të tjera. Kështu mundësohet dhe paraqitja e kurbave të temperaturës në varësi të peshës së kafshës, regjistrimi dhe aksesimi i të dhënave me lehtësi, si dhe marrja në konsideratë e gazrave dhe lagështirës etj.

Për të mbrojtur kafshët në rastet e ndërprerjes së rrymës elektrike instalohen sisteme alarmi që mund të jenë akustike ose optike. Në stallat e jashtme sinjali i alarmit transmetohet nëpërmjet telefonit ose radios. Gjithashtu përdoren dhe pajisje monitoruese në formën e kamerave të cilat mundësojnë kontrollin nga tavolina e punës.

### **Stallat me ventilim natyror**

Për mbajtjen e lopëve janë të përshtatshme stallat me ventilim natyror, të cilat janë të thjeshta dhe kanë kosto të ulët. Këtu bëhet fjalë për ndërtesa të mëdha me minimalisht një apo më shumë anë të hapura. Çatia duhet të jetë rreth 4-5 m e lartë dhe duhet të krijojë një kënd maksimalisht 20 gradë që të sigurohet shkarkimi i duhur i ajrit dhe ujit të kondensuar.

Grazhdi ose korridoret nuk janë të nevojshme të mbulohen. Në rast se kreshta, për shkak të strukturës së stallës, gjendet mbi hapësirën që lëvizin lopët, atëherë formohet një mbulesë transparente.

Muret anësore përbëhen nga pllaka të thjeshta, kryesisht nga dërrasa me elemente të lëvizshëm për ajrosje, ose pjesë anësore mekanikisht të rregullueshme si p.sh. rrjetë, perde etj.

Në rastet kur kafshët mbahen gjatë gjithë vitit në regjim stallor është i domosdoshëm izolimi termik për të minimizuar të nxehtin.

Lopët në dimër mund të përballojnë shumë mirë të ftohtin në stalla të tilla, por në periudha të gjata dhe të nxehta të verës përballemi me ulje të rendimentit të prodhimit të qumështit, sepse kafshët nuk çlirojnë dot nxehtësinë e duhur.

Në këto situata të pazakonta mund të ndihmojë krijimi i ajrosjes artificiale me anë të ventilatorëve për t'i lehtësuar kafshëve sadopak vapën. Rekomandohen ventilatorë me një volum ajri 500-2000 m<sup>3</sup>/h. Vendndodhja specifike, përcaktimi i nevojshëm i volumit të ajrit dhe planifikimi për vendosjen e tyre në stallë duhet të bëhet nga një specialist i fushës.

Parimisht duhet t'i kushtohet rëndësi dhe vendit ku ndërtohet stalla. Efikasiteti më i lartë i ventilimit arrihet, nëse ndërtesa është e pozicionuar në drejtim të erës me qëllim që të qarkullojë ajër i pastër.

Ndërtimi i stallës në vende ku ajrosja pengohet nga plantacione ose ndërtesa të tjera mund të dëmtojë në mënyrë të konsiderueshme rehatinë dhe mirëqënien e kafshëve.

Ventilimi natyror përdoret për mbajtjen e derrave, veçanërisht për derrat e majmë në regjim stallor.

Sisteme të tilla shfaqin një mesatare vjetore të volumit të ajrit për kafshë shumë më të lartë krahasuar me stallat me sistem ventilimi. Ajrosja perceptohet më mirë nga kafshët. Mundësitë e kufizuara të kontrollit gjatë stinës së verës mund t'i shkaktojnë kafshëve probleme me çlirimin e nxehtësisë. Stallat duhen të ndahen në zona me temperatura të ndryshme, në mënyrë që mbajtja e kafshëve të përshtatet më së miri me kushtet e motit sipas sezonit.

## Përfundim

Në sistemet e mbajtjes së lopëve janë të përshtatshme stallat me ventilim natyror, të cilat janë të thjeshta dhe kanë kosto të ulët.

Në sistemet e mbajtjes së derrave dominojnë ndërtesat tradicionale me sistem ventilimi mekanik, kjo për shkak të kërkesave mbi higjienën dhe politikave për mjedisin. Numri i stallave me ventilim natyror, me zona temperature të ndryshme vazhdon të rritet.

Në sistemet e mbajtjes së shpendëve përdoren metodat mekanike të ventilimit, në ndërtesat e reja kryesisht ventilimi në formë tuneli, si dhe sistemet që shfrytëzojnë energjinë e erës.

## Për më shumë informacion:



**Q F** Qendra e Formimit  
**P B** Profesional të Blegtorëve

## Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**website:** www.ap.com.al

## 22. RRUGËT E FRYMËMARRJES, PATOGENËT DHE SHKAKTARËT

*Përpunuar nga Kristian Maka*



### Kufizimi i dëmeve

Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes përbëjnë një pjesë të madhe të problemeve shëndetsore të derrave. Ato mund të jenë përgjegjëse për humbjet më të mëdha, për reduktimin e rritjes së peshës ditore dhe për uljen e konsumit të ushqimit. Në këtë mënyrë ato shkaktojnë dëme ekonomike të konsiderueshme.

Shkaqet e sëmundjeve të rrugëve të frymëmarrjes janë të ndryshme. Krahas shkaqeve infektive duhet të merren parasysh dhe shkaqet joinfektive (mikroklima në stallë, dendësia e tufës, qëndrimi). Në rast se shfaqen shpesh p.sh. infeksione të rrugëve të frymëmarrjes me temperaturë të ulët në të njëjtën grupmoshë, atëherë shkakut mund të jetë ventilimi.

Mbi të gjitha lagështia e ajrit është e rëndësishme: në rastet kur ajri është shumë i thatë, atëherë rritet prevalenca për sëmundjet e mushkërive. Lagështia e ajrit duhet të jetë ndërmjet masës 70 dhe 90 % dhe në rastet kur norma e ventilimit është e lartë, niveli i lagështisë është shpesh më i ulët. Ndryshimet e normave të ajrit është e këshillueshme të shmangen.

### Hulumtimi i saktë i shkakut është i rëndësishëm

Niveli i infeksionit dhe gjendja e imunitetit në një fermë janë parametra shumë dinamike, që ndikohen nga ndryshimet në fermat e rritjes së gicave (p.sh. shkallë e lartë remonti, rritje e tufës).

Krahas patogjenëve primarë, ekzistojnë dhe ato sekondarë.

Prandaj është e domosdoshme, që të kryhen analiza të sakta për gjetjen e shkakut, për të përcaktuar diagnozën e saktë. Para fillimit të trajtimit duhet gjithmonë të bëhet kontrolli nga veterineri. Gjatë kontrollit duhet të merren parasysh veçanërisht pikat e mëposhtme:

- ◆ Niveli i temperaturës është një tregues për shkaqet e mundshme, ndërsa kolla e shkaktuar nga bakteret shoqërohet me temperaturë relativisht të ulët ose pa temperaturë fare, kafshët që janë të prekura nga sëmundje të shkaktuara nga viruset si p.sh. gripi, Sindroma e Riprodhimit dhe Rrugëve të Frymëmarrjes shfaqin shpesh temperaturë të lartë mbi 40,5°C.
- ◆ Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes të shkaktuara nga viruset çojnë shpesh në reduktimin e konsumit të ushqimit, sepse ato shkaktojnë inflamacion të indeve të mushkërive, ç'ka pengon shkëmbimin e ajrit dhe shkakton lodhje të kafsha.
- ◆ Simptomat e sëmundjes mund të jenë tregues të qartë të shkakut të sëmundjes. Një mortalitet i lartë mund të jetë një tregues i një sëmundjeje progresive (kryesisht Actinobacillus -pleuropneumonia APP), por me raste të ngordhjes së kafshëve përballemi edhe kur kemi të bëjmë me një sëmundje për një kohë të gjatë dhe me shfaqje temperature të lartë (p.sh gripi).
- ◆ Kolla me sekrecione nga hundët është një tregues i bronkopneumonisë bakteriale, ndërsa dhimbja e fortë e barkut është një treguesi qartë për një bronkopneumoni, që shkaktohet shpesh nga viruset (Sindroma e Riprodhimit dhe Rrugëve të Frymëmarrjes, gripi, PCV). Inflamacionet e syrit konsiderohen shpesh si infeksione SRRF (sy të skuqur), megjithatë ata shkaktohen nga chlamydia dhe mund të jenë një tregues i një ventilimi të dobët.
- ◆ Për zbulimin e shkakut është e rëndësishme koha gjatë së cilës janë sëmurur derrat. Ndërsa shumica e sëmundjeve shfaqen në fazën e parë të mbarështimit të derrave (p.sh infeksioni bakterial i shkaktuar nga Haemophilus Parasuis), APP haset shpesh në fazën përfundimtare. Nga ana tjetër gripi mund të shfaqet gjatë gjithë periudhës së mbarështimit. Veçanërisht nëse hasen probleme me rrugët e frymëmarrjes në çdo fazë tek e njëjta grupmoshë është e domosdoshme të kryhen analiza të mëtejshme.



- ♦ Sa më e madhe të jetë dendësia e tufës në stallë, aq më shpejt mund të përhapen sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes. Nëse në një vendqëndrim ndodhen vetëm derra të një grupmoshe, atëherë derrat e rinj nuk duhet të vendosen me të vjetrit. Kjo ndodh për të favorizuar dhe procesin e pastrimit të stallës (derrat vendosen në një stallë “karantine”, pas një qëndrimi të caktuar nxirren përsëri nga kjo stallë, në mënyrë që të bëhet dezinfektimi i saj).

### Diagnostifikimi siguron rezultate

Pas kontrollit të kafshës përcaktohet se çfarë analizash të tjera janë të domosdoshme. Ka shumë mënyra diagnostifikimi. Me anë të testeve serologjike diagnostike përcaktohen antitrupe kundër patogjenëve të rrugëve të frymëmarrjes. Këtu duhet patur parasysh, që sistemi imunitar krijon antitrupe dy deri katër javë pas infeksionit.

### Patogjenët kryesorë të sëmundjeve të rrugëve të frymëmarrjes te derrat

Patogjen primar	Patogjen sekondar
Mycoplasma hyponeumoniae	Haemophilus parasuis
Gripi	Bordetella bronchiseptica
Virusi PRRS	Pasteurella multocida, Streptococcus
Actinobacillus pleuropneumonia	Actinobacillus pleuropneumonia
Parazitet (Ascaris suum etj.)	PCV2

Prandaj është e domosdoshme të merret një mostër gjatë fazës së parë të infeksionit dhe një mostër tjetër e dytë tek e njëjta kafshë katër javë më vonë.

Testet serologjike për mykoplazmat janë aplikuar para së gjithash te kafshë barrëse, të painfektuara. Në këtë mënyrë mund të konstatohet, nëse derrat infektohen me mykoplazma gjatë regjimit stallor. Nëse vaksinimi kundër mykoplazmave ndërpritet, përdoret si metodë për të gjetur nëse kafshët e pavaksinuara infektohen në stallë.

Testimet virologjike duhet të kryhen në fillim të procesit të infektimit, pasi është probabiliteti më i lartë për të zbuluar virusin në gjak. Në këtë fazë gjaku analizohet shpesh për virusin PRRS dhe PCV2. Për arsye kostosh mund të grumbullohen deri në pesë mostra. Nuk rekomandohet një testim virologjik i gjakut për virusin e gripit për shkak se virusi zbulohet vetëm për një kohë shumë të shkurtër ose nuk zbulohet fare në gjak.

### Seksionet e dyshimta dhe kontrolli i thertoreve

Me rritjen e numrit të kafshëve të ngordhura, disa kafshëve duhet t'u bëhet autopsia për të qartësuar shkakun e ngordhjes dhe për të shqyrtuar më saktësisht ndryshimet në organe. Nga organet që kanë pësuar ndryshim mund të merren mostra për ekzaminimet e mëtejshme bakterologjike, virologjike dhe testimi për parazitë.

Gjithashtu janë të mundshme ekzaminimet histopatologjike, ku shqyrtohen me mikroskop pjesë të holla të prera të një organi. Nëse ekziston dyshimi i infeksionit bakterial i shkaktuar nga Haemophilus parasuis atëherë ekzaminimi duhet të bëhet sa më herët sepse patogjeni që është përgjegjës për sëmundjen, Haemophilus parasuis, mund të zbulohet dy deri tre orë pas ngordhjes së kafshës.

Nëse hasen probleme me frymëmarrjen në fazën përfundimtare të regjimit stallor, atëherë organet e gjithë pjesës së therur mund të analizohen me ndihmën e kontrollit të një thertoreje. Në këtë rast ekzaminohen para së gjithash mushkëria, zemra dhe mëlçia.

### Gjatë ekzaminimit të organeve duhet të konstatohen arsyet dytësore

Interesante është sidomos përqindja e ulët, e mesme dhe e lartë e pneumonisë, dmth e inflamacionit të parenkimës mushkërore që shkaktohet kryesisht nga mykoplazmat, por herë pas here shkaktohet dhe nga patogjenë të tjerë. Zakonisht pneumonia vazhdon të shfaqet në një përqindje të ulët edhe te kafshët e vaksinuara, pasi një vaksinë kundër mykoplazmës nuk e parandalon infeksionin me mykoplazëm, por vetëm e zbut atë. Prandaj është i rëndësishëm statusi i mushkërisë dhe gjendjes kur është dorëzuar për vlerësimin e gjetjeve në thertore.

Nëse kafshët të cilat nuk janë mbartëse të mykoplazmës infektohen në stallë, atëherë shfaqet një përqindje mesatare ose e lartë e rasteve me pneumoni.

### **Konkluzion**

Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes kanë shumë shkaktarë. Prandaj rezultatet duhet të shihen me kujdes me anë të testimeve të kafshëve, diagnostifikimit dhe nëse është e nevojshme me anë analizës së organeve, para se të bëhet një diagnozë. Shkaktarë mund të jenë edhe një ventilim jo i mirë ose menaxhimi i stallës.

Për gjetjen e zgjidhjeve për problemet e rrugëve të frymëmarrjes duhet të merren parasysh të gjitha mundësitë e mundshme nga është shkaktuar problemi. Disa problemeve mund t'iu gjendet zgjidhja duke ndryshuar momentin e vaksinimit ose me anë të hyrjes së vaksinave të reja, si dhe probleme të keqmenaxhimit mund të zgjidhen duke përmirësuar metodat e menaxhimit.

### **Për më shumë informacion:**



**Q F Qendra e Formimit**  
**P B Profesional të Blegtorëve**

### **Austria Praemix shpk Tel:**

+355 (0)68 402 6311

**e-mail:** [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)

**website:** [www.ap.com.al](http://www.ap.com.al)

## 23. PRODUKTET SCHAUMANN – ACIDET YNDYRORE RRSIN RENDIMENTIN

Përpunuar nga Kristian Maka

*Kombinimi i acideve organike është provuar të jetë një alternativë shumë efektive për stabilizimin e mikroflorës në sistemin tretës të derrave. Në këtë mënyrë do të reduktohet ndjeshëm dhënia e medikamenteve.*

Ndikimi i acideve organike në rritjen e rendimentit prek shumë faktorë: përmirësimi i higjienës në ushqim, ulja e vlerës së pH në stomak, reduktimi i mikrobeve, rritja e aktivitetit enzimatik, zhvillimi pozitiv i procesit tretës në zorrë dhe përthithja e lartë e lëndëve ushqyese. Këto efekte mund të kontrollohen dhe të shtohen nëpërmjet përzgjedhjes dhe kombinimit të shumë acideve të ndryshme organike.

### Gicat kërkojnë përkujdesje të veçantë


Pas shkëputjes së gicit nga qumështi, niveli i furnizimit me acid laktik ulet. Një përzjerje acidesh duhet të plotësojë nevojat e gicit për acid laktik, të sigurojë furnizimin me energji si dhe të rrisë aktivitetin e qelizave në zorrë. Stresi i shkaktuar nga ushqimi reduktohet ndjeshëm dhe konsumi i ushqimit stimulohet pozitivisht nëpërmjet acideve laktike (efekti CCM).

Kombinimi i acideve Schaumacid Protect me acidet yndyrore me zinxhir të mesëm (MCFA) është aplikuar gjatë rritjes së gicave. Fermat raportuan për një gjendje shëndetësore të mirë të gicave dhe stabilizim të rendimentit. Vetëm forma e pashkëputur e acideve organike ka efekt antimikrobik. Meqënëse shkalla e shkëputjes së MCFA nga vlerat e larta të pH që mbizotërojnë në zorrën e hollë dhe të trashë, është e ulët, atëherë MCFA vepron rregullisht. Acidet yndyrore të mesme zinxhir kanë një veprim antimikrobik mbi vlera të ndryshme të pH, siç haset në traktin e tretjes.

### Rezultatet e provës


Prova eksperimentale në rritjen e derrave konfirmuan reagime pozitive nga fermat. Schaumacid Protect u zëvendësua me një përzjerje të thjeshtë të acidit formik dhe acidit propionik dhe u studiua efekti i Schaumacid Protect në kombinim me MCFA në procesin e rritjes së gicave. 1.200 gica u vendosën në kabina me skara plastike me 85-86 kafshë të gjinive të ndryshme. Çdo grup u nda në

1. SCHAUMACID PROTECT përmirëson shtimin ditor të peshës. 7,5 kg deri 29 kg



7 kabina, domethënë 600 kafshë gjithësej. Gicat kishin moshë mesatare 28 ditë (7 ditë pas ndarjes) dhe peshë trupore 7,5 kg. Ushqyerja është bërë pothuajse e paracionuar me ushqim të lëngshëm gjatë gjithë periudhës së rritjes.

Duke marrë parasysh kohën e testimit 42 ditore dhe një peshë fillestare prej 7,5 kg, shtim në peshë prej 500 gr, shtesë ditore, është në nivelet më të larta. Shtimi në peshë është përmirësuar ndjeshëm me rreth 39 g/ditë falë përdorimit të Schaumacid Protect (Grafiku1).



Me Schaumacid Protect u përmirësua konsumi i ushqimit gjatë gjithë periudhës së rritjes në 6% në krahasim me grupin e kontrollit. Në këtë mënyrë u përdor 100 g më pak ushqim për të përfituar 1 kg shtim në peshë (Grafiku2). Eksperimenti me ushqimin u zhvillua pa ndikuar në shëndetin e gicave.

Përdorimi i acidit laktik dhe i acideve të tjera si për shembull: Schaumacid F në ushqimin e dosave, ndikoi në rritjen e konsumit të ushqimit, i bëri më vitale dhe rendimenti i qumështit u rrit. Gicave në mëmëzim dhe gicave në shkëputje iu mundësua mbrojtje më e mirë nga infeksionet. Shtimi ditor në peshë u rrit.

### Kërkesat specifike të ushqimit në majmëri

Përdorimi i acideve ushqimore në derrat e majmërisë është i rekomandueshëm për parandalimin e diarresë. Acidet pengojnë zhvillimin e baktereve të dëmshme dhe lehtësojnë sistemin imunitar. Lëndët ushqyese mund të përthithen më mirë. Nëse racioni përmban sasi të mëdha të Corn-Cob-Mix CCM (përzjerje misër kokërr-kalli), atëherë përzgjedhja e përzjerjes së acideve duhet të jetë e përshtatshme. Ideal është kombinimi i komponetëve kryesorë të acidit formik dhe propionik. Ky kombinim plotëson më së miri përmbajtjen natyrore të acidit laktik.

Si një masë efektive kundër salmonelës është provuar të jetë përdorimi i Schaumacid S në kombinim me acidet me varg të shkurtër dhe të mesëm. Vërehet ndikimii menjëhershëm në uljen e numrit të baktereve si dhe në reduktimin e tyre në sistemin e tretjes duke siguruar mbrojtje higjienike në të gjitha fazat e prodhimit.

Programi Schaumacid siguron furnizimin me acide me aktivitet të lartë antibakterial dhe me tolerancë të mirë për përdorim në gicat, dosat, derrat e majmërisë dhe shpendët si dhe në ushqimin e lëngshme.

### SCHAUMANN- Acidet ushqimore

#### Ushqimi i pastër

##### SCHAUMACID M (Granulat)

Kombinim acidesh për derrat. Ideal për racionet CCM

##### SCHAUMACID DRINK C (i lëngshëm)

Kombinim acidesh për marrjen nëpërmjet ujit.

Për derrat, shpendët dhe për acidifikimin e qumështit për viçat.

##### SCHAUMACID CLEAN (i lëngshëm)

Një kombinim shumë i mirë acidesh për rritjen e higjienës në sistemet e lëngshme të ushqimit.

##### SCHAUMACID PROTECT (Granulat)

Kombinim i acideve yndyrore zinxhir të shkurtër dhe të mesme me efektshmëri për derrat dhe shpendët.

##### SCHAUMACID ENERGIEMIX (i lëngshëm)

Ushqim shtesë i pasur me energji për derrat me efekt ruajtës.

### Për më shumë informacion:



**QF** Qendra e Formimit  
**PB** Profesional të Blegtorëve

### Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**Website:** www.ap.com.al

## 24. KUJDES NGA USHQIMI I MYKUR

Përpunuar nga Jon Zeneli

### Mykotoksinat

Kafshët e fermës, veçanërisht derrat, të cilët hanë ushqim të kontaminuar me toksina të mykut të ngjashëm me kërpudhat, janë veçanërisht të rrezikuar. Në Austri ekziston një program monitorimi për mykotoksinat në misër.



Qartësia në lidhje me ndotjen e ushqimit të kafshëve në fermë me mykotoksina mund të arrihet vetëm përmes testeve laboratorike. Ekzistojnë mykotoksina të ndryshme, të cilat kanë efekte dhe shfaqin simptoma të ndryshme të sëmundjes. Misri kryesisht është i kontaminuar me mykotoksina nga kërpudhat *Fusarium*. Në ushqimin e derrave, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet deoksinivalenolit (DON), zearalenonit (ZEA), fumonisinave (FUM) dhe aflatoksinave (AFLA). Kafshët e fermës dhe derrat janë zakonisht më të ndjeshëm ndaj ushqimit të mykur sesa derrat e majmërisë.

Zearalenoni është i rrezikshëm, sepse ai është përgjegjës për forma të ndryshme të çrregullimeve të pjellorisë. Në praktikë, veçanërisht në kafshët më të reja, shpesh vërehet një pseudo-intoksikim në grup, trup i fryrë dhe i skuqur pa refleksin e tolerancës. Pjelljet e të vegjëlve me peshë të ulët, më shumë aborte ose rritja e zhurmës përkeqësojnë performancën në prodhim.

Deoksinivalenoli në ushqim, në varësi të sasisë, ndikon në reduktimin e konsumit të ushqimit deri në një refuzim të plotë të tij. Te derrat e majmërisë, shpesh shfaqet në formën e të vjellave. Sjellja agresive çon në kafshime dhe beteja në grup midis kafshëve. Përveç kësaj, sistemi imunitar dobësohet, si pasojë favorizohen infeksionet dytësore. Rritja e kafshëve të ndara krijon vështirësi në marketing dhe sjell dëme ekonomike.

Meqenëse monitorimi kryhet në mënyrë selektive, rekomandohet që të merren masa për të kryer një ekzaminim të ushqimit për të shmangur mykotoksinat në mënyrë që të ruhet shëndeti i kafshës dhe të shfrytëzohet potenciali i performancës së tyre.

Në përgjithësi, çdo fermer që mbarështon derra duhet gjithashtu të ketë njohuri për përbërësit e ushqimit që përdor. Kostot e ushqimit për kafshë janë kostot më të mëdha në kultivimin e derrave. Një ekzaminim i lëndëve ushqyese të ushqimit është padyshim i vlefshëm. Ka luhatje çdo vit, veçanërisht në lidhje me përmbajtjen e proteinave dhe përmbajtjen e lagështisë së ushqimit individual. Dhomat e bujqësisë dhe këshillat e grupit të punës për mbarështimin e derrave kryejnë fushata vjetore inspektimi në mënyrë që të krijojnë racione të bazuara nga praktika dhe nevoja, me kosto efektive.

**Për më shumë informacion:**



**QF** Qendra e Formimit  
**PB** Profesional të Blegtorëve

**Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)

**Website:** [www.ap.com.al](http://www.ap.com.al)


## 25. FRESKI DHE VITALITET ME SCHAUMALAC ENERGIETRUNK

Përpunuar nga Kristian Maka

Një ndër faktorët që ndikon pozitivisht në performancën e lartë të kafshëve është tretja e qëndrueshme dhe mirëfunktionale.

Shkaktarët e diarresë janë të shumtë, veçanërisht te derrat.

Të gjitha rastet e diarresë kanë një të përbashkët: humbje masive e lëngjeve dhe mineraleve, kjo dobëson më shumë kafshët, të cilat janë në gjendje të keqe shëndetësore. Diarreja mund të jetë shkaku i ngordhjeve të konsiderueshme të derrave, ku shpesh primar nuk është infeksioni, por pasojat që vijnë nga dehidratimi dhe mungesa e energjisë. Furnizimi me ujë dhe elektrolite mund të ketë një efekt shpëtimtar.



### Çfarë janë elektrolitet?

**Elektrolitet** janë kripëra të cilat kur treten në ujë shndërrohen në jone:

- ♦ jonet natrium (Na<sup>+</sup>)
- ♦ kalium (K<sup>+</sup>)
- ♦ kloruret (Cl<sup>-</sup>)
- ♦ bikarbonat (HCO<sub>3</sub><sup>-</sup>)
- ♦ kalcium (Ca<sup>2+</sup>)
- ♦ magnez (Mg<sup>2+</sup>)

Balanca e tyre është shumë e rëndësishme për funksionin normal të organizmit.

Funksioni i tyre bazohet në parimin e difuzionit të ujit nga zonat me përqendrim më të ulët drejt zonave me përqendrim më të lartë. Trupi e përdor këtë mekanizëm për të rregulluar përthithjen e ujit nga zorrët, për shembull: natriumi "pomphet" nga zorrët në qeliza, ndërsa konsumon energji; uji përpiqet të kompensojë përqendrimin më të lartë të kripës në qeliza dhe shpërhapet më pas.

### Çrregullime në balancën e elektroliteve

Balanca e elektroliteve kryhet kryesisht nga veshkat, te kafshët e shëndetshme. Diarreja shkakton prishje të këtij ekuilibri. Detoksifikimi nga patogjenë si E.Coli ose clostridia, fillon me çlirimin në zorrë të elektroliteve (veçanërisht Cl<sup>-</sup> dhe HCO<sub>3</sub><sup>+</sup>), më pas kalon uji, duke bërë që përmbajtja e zorrëve të lëngëzohet. Përthithja e ujit nga zorrët zvogëlohet, sepse vilet e zorrëve dëmtohen nga patogjenët e diarresë.

### Hiperaciditet gjatë diarresë

Humbja e bikarbonatit çon në acidozë metabolike. Organizmi reagon me frymëmarrje më të shpejtë, më të thellë dhe me një rënie të presionit të gjakut. Kafshët duken të zbehta dhe të dobëta, në raste ekstreme acidoza çon deri në vdekje. Faktor vendimtar është furnizimi i shpejtë me lëngje, përdorimi i glukozës për energji dhe tretësirave buferike.

### SCHAUMALAC ENERGIETRUNK- Pije energjike dhe elektrolitike

Përdorimi i pijeve energjike SchaumaLac lehtëson ndjeshëm efektet anësore të diarresë. Kompensimi i humbjes së lëngjeve kontribuon dukshëm në rigjenerimin më të shpejtë të organizmit.

### Për më shumë informacion:



### Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311


**e-mail:** agri@ap.com.al

**Website:** www.ap.com.al

## 26. USHQIM I MIRË PËR KAFSHË TË SHËNDETSHME

Përpunuar nga Kristian Maka

Efikasiteti i mbarështimit të derrave është i lidhur ngushtë me shëndetin e zorrëve të kafshëve. Balancimi i mikroflorës është i rëndësishëm. Formula e re për performancë dhe shëndet më të mirë quhet Bonvital Impuls.



Përthithja efikase e lëndëve ushqyese, elektroliteve dhe ujit është një nga funksionet më të rëndësishme të zorrëve. Në organizëm hyjnë baktere dhe patogjenë të dëmshëm, për këtë arsye shumica e mbrojtjes së trupit (80%) janë të përqendruar në zorrë.

### Mbrojtje maksimale

Zorrët janë krijuar për të parandaluar hyrjen në trup të substancave të dëmshme dhe patogjenëve të gëlltitur nëpërmjet ushqimit. Qelizat imune në traktin e zorrëve ofrojnë impulse të rëndësishme, që stimulohen nga kontakti i vazhdueshëm me mikrobet e florës së zorrëve.

### Bakteret

Flora e zorrëve përfshin baktere, protozoarë dhe kërpudha nga disa qindra lloje, bakteret përbëjnë pjesën kryesore të këtij ekosistemi. Në zorrën e trashë gjenden deri në  $10^{14}$  baktere/gram të përmbajtjes së përgjithshme.

Zorra e hollë është kryesisht e populluar nga baktere anaerobe si laktobacilet, enterokoket, streptokokët, stafilokokët dhe koliformët, ndërsa pjesa fundore e traktit intestinal është e populluar nga bakteret anaerobe si bifidobakteret, eubakteret, anaerobeserogramet, dhe striktologët.




Shtirja dhe përbërja e florës intestinale ndikohet nga faktorë të tillë si pH, aktiviteti i zorrëve dhe aktiviteti imunitar. Të gjitha masat e të ushqyerit kanë një efekt të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në florën e zorrëve. Nëse një mikrob arrin të shumohet më tepër se të tjerët, mund të bëhet problematik - veçanërisht nëse ka veti patogjene. Si rezultat, mund të shfaqen simptoma të diarresë, të cilat zhvillohen në pjesë të ndryshme të zorrëve në varësi të patogjenit. Për shembull, brakispiri, i cili mund të përhapet në pjesën fundore të zorrëve, është i vështirë për t'u asgjësuar vetëm duke vendosur masa në të ushqyer.

### Kombinimi i duhur bën diferencën

Përdorimi i probiotikëve (mikroorganizmave të gjallë) në kombinim me acide organike të zgjedhura ndikon pozitivisht në florën e zorrëve dhe pengon rritjen e mikrobeve patogjene. Linja e re SchaumaLac Protect kombinon efektet sinergjike të këtyre dy komponentëve në Bonvital Impulse.

Një kombinim i koordinuar i acideve aromatike, me zinxhir të shkurtër dhe të mesëm mund të pengojë rritjen e baktereve gram-negative (coli, salmonella) si dhe bakteret gram-pozitive (clostridia, stafilo- dhe streptokoket) në pjesët e përparme dhe të pasme të aparatit tretës, pa efekte negative që ndikojnë në zhvillimin e Bonvital (Enterococcus faecium). Kjo lejon që probiotiku Bonvital të zhvillohet në mënyrë optimale në zorrë dhe të zhvillojë më mirë vetitë e tij pozitive, si stabilizimi i florës së zorrëve, formimi i një filmi mbrojtës biologjik, stimulimi i sistemit imunitar, reduktimi i toksinave mikrobike dhe përthithja e përmirësuar e lëndëve ushqyese. Kjo do të thotë: më shumë efikasitet në performancë dhe më shumë shëndet në të gjitha fazat, madje edhe ato kritike të prodhimit të derit.

### Ulcerat dhe sëmundjet e zorrëve

<p>Një zorrë e shëndetshme përbëhet nga një mur i hollë me vile të gjata dhe të theksuara, që mundësojnë sipërfaqen më të madhe të mundshme.</p>	
<p>Në rastin e Porcine intestinal adenopathy (PIA), procesi i djegies së viljeve të zorrëve është i çrregullt, duke bërë që muri i zorrëve të trashet. Kjo dëmton rëndë rritjen e kafshëve, por nuk është e dukshme menjëherë.</p>	
<p>Koronavirusi shkakton djegien e viljeve të zorrëve, si rezultat, sipërfaqja totale e zorrëve zvogëlohet shumë. Rezultati është ngadalësim i rritjes dhe një përkeqësim në konvertimin e ushqimit.</p>	

**Për më shumë informacion:**



**Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve**

**Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**Website:** www.ap.com.al



## 27. FILLIM I RI ME DOSA TË SHËNDETSHME

Përpunuar nga Jon Zeneli

Ferma e mbarështimit të derrave në Kublank ka zëvendësuar dosat dhe ka modernizuar stallat. Kjo ka përmirësuar ndjeshëm shëndetin e tufës në përgjithësi.

"Qëllimi i këtij ndryshimi është një tufë e re dosash të shëndetshme. Ne kemi optimizuar më tej stallat, gjenetikën dhe menaxhimin tonë", thekson Toin Smolders. Toin Smolders është menaxher ferme tek ambientet e mbarështimit të derrave në Kublank, në rrethin Seenplatte të Mecklenburg-ut.

Objekti ekzistues daton që prej viteve 1960. Mbarështuesi hollandez e bleu atë në 2011 dhe e rinovoi gjerësisht. Synimi i stallës që prej vitit 2019, ka qenë ofrimi i 2500 gicave të shëndetshëm në javë. Kompania Westfleisch merr pjesën më të madhe të derrave dhe ua tregton klientëve në shtetet e vjetra federale gjermane.



*Humbjet tek të sapolindurit janë më pak se 10%, me përmirësimin racor të dosave.*

### Organizimi

Njësitë e stallës në ambientet e fermës u riorganizuan, si një nga masat e para përmirësuese. Stalla e dosave u ndërtua në një zonë larg qendrës së banuar, për të shmangur çdo shqetësim ndaj erërave të këqija apo zhurmave.


Zonat e prodhimit u ndanë nga njëra-tjetra. Kjo synon të parandalojë transferimin e baktereve. "Punonjësit janë caktuar sipas zonave të veçanta në fermë. Ata nuk lejohen të shkojnë për gjuheti apo të shfrytëzojnë derrat për interesa vetjake," shpjegon Smolders- menaxheri i fermës .

Pajisjet e përdorura janë të ndara në mënyrë specifike për çdo zonë. Ato dallohen nga ngjyra karakteristike për zona të caktuara. Dezinfektantët janë lehtësisht të aksesueshëm në çdo zonë. Në fermë, në zona të ndryshme përdoret gëlqere, në mënyrë që të minimizohet lagështia dhe të dezinfektohet ambienti nga ndotësit e mundshëm.

Ferma i nënshtrohet kërkesave të rrepta për siguri. Vendi është i rrethuar nga gardhe me porta. Kanalet e higjienës me dushe automatike mbrojnë tufën. Vizitorët duhet të nënshkruajnë një dokument, ku thuhet se nuk kanë patur kontakt me derra për të paktën 48 orë.

Të gjitha materialet e prodhimit si produktet për pastrim, ushqimi, materiali biologjik hyjnë në stallë nga hyrjet e autorizuara. Ato janë sterilizuar më parë me rreze UV për të asgjësuar patogjenët.

Ferma i dezinfekton gjithashtu automjetet e transportit, të cilat përdoren për transportin e dosave. Izolimi i karkasave është gjithashtu i rëndësishëm. Mjetet e asgjësimit të tyre mbahen larg zonave të banuara.



Menaxheri i fermës Toin Smolders është specialist në vlerësimin e shëndetit të qëndrueshëm të kafshëve në mbarështimin e derrave.

### Optimizimi i tufës

Menaxheri i fermës Smolders i kushton një rëndësi të madhe tufës së kafshëve, sjelljes gjatë ditës, në mënyrë që të identifikojë ndonjë anomali të mundshme.

Pastrimi në mënyrë efektive i korridoreve lidhëse të zonave të ndryshme, realizohet me anë të solucioneve izoluese dhe rezistente ndaj rrëshqitjes.

Korridoret duhet të pastrohen pas çdo transporti, për të parandaluar përhapjen e mikrobeve midis sektorëve të stallës.

Gjatë rindërtimit, pajisjet e stallës u modernizuan plotësisht. Zonat e pjelljes për periudhën katërjavore të gjidhënies u pajisën me sisteme ajrimi. Në të gjithë sektorët e stallës, u zgjerua hapësira e dritareve. Gjithashtu të gjitha zonat e stallës u pajisën me materiale, të cilat mbajnë në aktivitet të vazhdueshëm kafshët. Termoizolimi u realizua nëpërmjet dyshemesë me anë të shtrojës me shtresë të dyfishtë. Elementët plastikë plotësojnë nevojën e gicave për ngrohtësi. Elementët me rrasa betoni përmirësojnë shpërndarjen e nxehtësisë së gicave.

## Gjenetika

Ferma e derrave Kublank e zëvendësoi gjenetikën e dosave të tyre me variantin Topigs Norsvin. Në fund të vitit 2017, ferma fillimisht boshatisi stallën. Gradualisht, dosat më të vjetra dhe gicat u larguan nga ferma.

E gjithë ferma iu nënshtua më pas një operacioni të gjerë pastrimi.

Pas një periudhe qetësie, dosat e para të reja u zhvendosën në Kublank në pranverën e 2018. Ato u çiftëzuan dhe lindën të vegjël shumë të shëndetshëm me gjene TN-70. Dosat lindën për herë të parë në qershor 2018.

Investimet në rinovimin e stallave dhe zëvendësimin e dosave dhanë frytet e para. Menaxheri i fermës Toin Smolders synon efikasitet deri në 33% të gicave të shkëputur nga gjiri për dosë në vit. Pavarësisht lindjeve të shumta, humbjet e gicave janë nën 10%. Shkalla e ulët e humbjeve prej më pak se 0.5% në hapësirat e përbashkëta tregon për shëndetin e mirë të tufës. Kjo reflektohet tek trajtimet e pakta tek derrat.

Si rezultat, ferma e mbarështimit ka qenë në gjendje të reduktojë përdorimin e antibiotikëve në minimum, veçanërisht me ndihmën e higjienizimit të tufës. Programi i vaksinimit për derrat është gjithashtu i menaxhueshëm. Gicave u bëhet periodikisht vetëm një vaksinë kundër rotaviruseve për t'i mbrojtur ata gjatë majmërisë.

## Analizat e gjakut

Për të siguruar një nivel të lartë të gjendjes shëndetsore, kryhen ekzaminime të rregullta të tufës. Çdo tre muaj, veterineri i fermës merr mostra për analizë. Zakonisht, veterineri i nxjerr rezultatet para se të shiten derrat.

Kjo procedurë ka dëshmuar vlerën e saj, duke i lejuar fermës të reagojë shpejt dhe specifikisht nëse lindin pyetje më vonë gjatë procesit të majmërimit. Nëse është e nevojshme, diagnostikime të mëtejshme kompletojnë kontrollet rutinë. Ekzaminimet e mëtejshme kryhen duke u konsultuar me klientët e derrave ose partnerët e marketingut.

Në të njëjtën kohë, monitorimi shëndetësor shërben si një sistem paralajmërimi i hershëm. Nëse, për shembull, shifrat e antitropave të salmonelës vazhdojnë të rriten, prodhuesi mund të marrë masa në kohën e duhur. Aktualisht gjendja shëndetësore është e shkëlqyer. Ambientet e dosave nuk bien në sy për salmonelë dhe nuk dyshohet as për PRRS, APP dhe mykoplazmë.

Përveç klientëve që i blejnë derrat, edhe punonjësit e stallës përfitojnë nga modernizimi i funksionimit të lindjeve dhe nga shkëmbimi i tufës. Tufa e organizuar e kafshëve dhe gjendja e mirë shëndetësore e bëjnë punën shumë më të lehtë. Stallat me shumë dritë dhe të pastra motivojnë edhe punonjësit. Kjo ndihmon për të siguruar higjienë dhe shëndet të mirë.

## Konkluzion

- Zhvendosja e dosave në Kublank ka rinovuar gjerësisht stallën e saj dhe ka zgjedhur dosa me shëndet të lartë gjenetikisht.
- Frytet janë humbje të pakta të të sapolindurve dhe përdorimi i ulët i barnave.
- Stabiliteti i gjendjes shëndetësore sigurohet nëpërmjet kontrolleve periodikë çdo 3-4 muaj.
- Monitorimi i shëndetit shërben si një sistem që rezultojnë në gica të shëndetshëm. Nëse është e nevojshme, vaksinimi i mëtejshëm bëhet për të mbrojtur gicat gjatë fazës së majmërisë.

## Për më shumë informacion:



**QF** Qendra e Formimit  
**PB** Profesional të Blegtorëve

## Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**Website:** www.ap.com.al

## 28. PROBIOTIKËT NË USHQIMIN E KAFSHËVE-PERFORMANCË MË E MIRË PËRMES SHËNDETIT MË TË MIRË

Përpunuar nga Jon Zeneli



Fillimet e përdorimit të probiotikëve në ushqimin e kafshëve datojnë që prej më shumë se 15 vjet më parë. Eksperiencia ka treguar shkallë të ndryshme suksesi dhe së fundmi efektet biologjike të tyre të miratuara në Gjermani, janë pozitive.

Qëllimi është i njëjtë si me antibiotikët: përmirësimi i gjendjes shëndetsore dhe performancës së kafshëve.

### Çfarë janë probiotikët?

Probiotikët janë preparate bakteriale ose maja, që përdoren në ushqimin e kafshëve si aditivë në vend të përmirësuesve të performancës ose sëbashku me to.

Aktualisht, në Gjermani përdoren:

- ◆ Shtami M 74 nga *Enterococcus faecium*
- ◆ Shtami SF 68 nga *Enterococcus faecium*
- ◆ *Bacillus toyoi*

Dy preparatet e para janë baktere të acidit laktik, preparati i tretë përmban si përbërës aktiv spore të *Bacillus toyoi*.

Termi probiotik përdoret më shpesh, pasi përshkruan më së miri aspektin e ruajtjes së shëndetit të organizmit (probios = për jetën). Emra të tjerë janë: bioregullatorë, biostabilizues dhe stabilizues të florës së zorrëve. Ligji gjerman i ushqimit i konsideron aditivë mikrobikë për të stabilizuar florën e zorrëve.

### Efektet e probiotikëve

Prof. Dr. Gedek, një mikrobiologe me përvojë e Universitetit të Mynihut, është marrë intensivisht me

përdorimin, efektin dhe vlerësimin e probiotikëve. Ajo zbuloi se shqetësimet në traktin tretës të kafshëve shoqërohen gjithmonë me ndryshime në përbërjen e florës së zorrëve, të cilat si pasojë mund të kenë ndikim në performancën e tyre.

Në gjendje normale, flora bakteriale e zorrëve është në një gjendje ekuilibri, e cila quhet eubiosis. Për kafshën, kjo gjendje nënkupton stres më të pakët në bashkëjetesën me mikroorganizmat në traktin tretës. Flora kryesore përbën më shumë se 90% të florës totale dhe në thelb përbëhet nga bakteret e acidit laktik dhe bakteret bacile. Flora shoqëruese, më pak se 1% përbëhet kryesisht nga m.o enterokokesh dhe coli. Pjesa tjetër e florës është edhe më e dobët.

Çdo ndryshim në ekuilibër në florën e mbetur dhe/ose shoqëruese nënkupton një rritje të stresit, zhvillim më të ngadaltë, konvertim më të dobët të ushqimit dhe performancë më të ulët. Ndryshimet e forta në florën e zorrëve çojnë në diarre dhe rritje të ngordhshmërisë së kafshëve.

Kafshët e reja kanë një strukturë relativisht të paqëndrueshme të florës së zorrëve. Gjatë fazës së ushqyerjes me gji dhe rritjes, edhe streset e vogla si p.sh. ndryshimi i ushqimit, lëvizja e stallës, klima jooptimale, kushtet e stallës ose përdorimi i antibiotikëve mund të çojnë në një çekuilibër në florën e zorrëve. Si rezultat përqindja e florës shoqëruese rritet (veçanërisht një rritje e ndjeshme e koliformeve të padëshiruara), kështu që situata kritike arrihet shumë shpejt.

Përdorimi i probiotikëve te kafshët e reja bën të mundur eliminimin e mikrobeve patogjene (bakteret coli) në traktin e zorrëve. Sipas studimeve të deritanishme, kjo arrihet nëpërmjet vendosjes së probiotikëve në murret e zorrëve, shumimit të tyre dhe formimit të një biofilmi mbrojtës. Në këtë mënyrë ndodh „zhvendosja“ e baktereve patogjene.

Bakteret e acidit laktik ndihmojnë në eliminimin e mikrobeve patogjene.

### Dallimet: përmirësuesit e performancës dhe probiotikët

Efekt	Antibiotikët	Probiotikët
Origjina	Produkt i metabolizimit të mikrobeve	Mikrobe të gjalla
Ku?	në zorrë dhe pjesë të tjera	vetëm në zorrë
Si?	frenim i drejtpërdrejtë i bakteve të zorrëve	frenim indirekt i bakteve të zorrëve
Aktiviteti	fushëveprimi i kufizuar	Parandalimi i ngjitjes ose zhvendosjes diapazoni i kufizuar i veprimt ndaj bakteve enteropatogjene
Kur	menjëherë (nga disa minuta deri në disa orë)	me vonesë në kohë (disa ditë)

Tab. 1 Ndryshimet midis antibiotikëve dhe probiotikëve

Grupi	Kontroll pozitiv 250 ppm	Toyocerin + përmirësues i performancës 100 ppm + 150 ppm
Periudha e ushqyerjes me gji:		
Numri i gicave të lindur	11,41	11,33
Pesha e lindjes kg	1,43	1,42
Pesha periudha e laktacionit kg	9,05	9,25
Shtesë ditore në peshë g	234	234
Pas shkëputjes nga gjiri		
Pesha përfundimtare kg	18,60	19,60
Shtesë ditore në peshë g	425	475
Relativ %	-	+11,8
Periudha totale		
Shtesë ditore në peshë g	310	328
Relativ %	-	+5,8
Konvertimi i ushqimit %	1,52	1,39
Relativ %	-	-8,5

Tab. 2 Toyocerin në recetën ushqimore të gicave gjatë ushqyerjes me gji (33 ditë, 24 litra) dhe menjëherë pas shkëputjes nga gjiri

## Rezultatet te gicat

Përdorimi i probiotikëve te derrat shoqërohet me shtim të marrjes së ushqimit suplementar dhe në vazhdim, rritje më të mirë, reduktim të diarresë dhe humbjeve gjatë rritjes. Këto efekte mund të konfirmohen në një studim të botuar së fundmi për rritjen e dosave dhe derrave, i cili u krye në Institutin për Ushqimin e Kafshëve në Universitetin Freien, Berlin.

(n = 12 Gica)

Ditët e diarresë (% e totalit të ditëve të mundshme të diarresë)			
Ditë pas fillimit të eksperimentit	0-9	0-16	0-31
Kontrolli	51.6	50.0	38.0
Toyocerin (1 x 10 <sup>6</sup> /g)	30.0	33.3	27.1

Tab. 3 Ndikimi i toyocerinës në derrat e infektuar me E. coli

Në këtë eksperiment u përdor shtami SF 68 i Streptococcus faecium.

Efektet pozitive në rritjen dhe përdorimin e ushqimit mund të demostohen gjithashtu në një eksperiment për rritjen e derrave Huelenberg, në të cilin u përdor probiotiku Toyocerin në kombinim me një përmirësues të performancës (Tab 2).

Rezultatet u qartësuan pas shkëputjes nga gjiri. Konsumi i ushqimit në grupin e testit ishte më i lartë se ai i grupit të kontrollit dhe për shkak të performancës më të mirë të rritjes, çoi në një epërsi në konvertimin e ushqimit prej 8.5%. Ky konstatim tregon se flora e zorrëve ishte e rënduar në periudhën pas shkëputjes nga gjiri.

(n = 12 gica)

Diarre e rëndë			
Ditët e diarresë (% e totalit të ditëve të mundshme të diarresë)			
Ditët pas fillimit të eksperimentit	0-9	0-16	0-31
Kontrolli	13.8	34.3	22.4
Toyocerin (1 x 10 <sup>6</sup> /g)	7.8	19.6	10.4

Tab. 3 Ndikimi i toyocerinës në derrat e infektuar me E. coli

Tabelat 3 dhe 4 tregojnë rezultatet e një eksperimenti me gica të kryer nga nga Kompania Kërkimore IS në Wahlstedt. Gicat ishin të infektuar me E. coli. Ato kafshë që morën edhe probiotikun Toyocerin kishin simptoma më të lehta diarreje.

Një rezultat nga praktika tregon reduktim drastik të ngordhjeve të kafshëve, kur produkti special i Schaumann, Schauma-Ferm, u përdor menjëherë pas lindjes (shih Fig. 1). Schauma-Ferm - ndërkohë i zhvilluar më tej në Schauma-Ferm Fit - përmban shtamin M 74 të Enterococcus faecium si një përbërës aktiv shumë i rëndësishëm si probiotik.

Tab.5: Rezultate nga përdorimi i Schauma-Ferm në Niedersachsen

	Schauma-Ferm	Kontrolli
Gica te lindur	10.6	10.6
Ngordhshmëria gjatë rritjes	6.6	12.3
	0.7	1.3
Gica të shkëputur nga gjiri	9.9	9.3

## Për më shumë informacion:



## Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

## 29. SINDIKON STREPTOKOKU TE DERRAT

Përpunuar nga Jon Zeneli

Streptokoku, ky mikroorganizëm bakterial përhapet mjaft shpejt dhe bën akoma më të rëndësishme marrjen e masave parandaluese për të ulur rrezikun e infeksioneve që shkakton.

Streptokokët lulëzojnë në qelizat e gjitarëve, njerëzve dhe shpendëve dhe mund të shkaktojnë sëmundje infektive të moderuara deri në të rënda. Derrat preken nga një grup i veçantë streptokokesh: Streptococcus suis. Aktualisht njihen 35 lloje të kësaj specijeje: disa prej tyre mund të shkaktojnë shumë humbje ekonomike.

Lajmi i mirë është se në mjedis, Streptococcus suis mbetet ngjites vetëm për një kohë të shkurtër. Në stallë, bakterit mbijeton për maksimumi tetë ditë në temperatura nga 22 deri në 25°C. Streptococcus suis është relativisht i lehtë për t'u eliminuar me solucione dezinfektuese konvencionale (të bazuara në klor, jod dhe fenol).

### Higjiena është e rëndësishme

Streptokokët transmetohen me kontakt të drejtpërdrejtë nga derri në derr. Gicat, përshebull, mund të infektohen para ose gjatë lindjes, nëpërmjet kontaktit me mukozën e lindjes, me dosën nënë ose me gica të tjerë, nëse ata janë bartës. Mizat dhe brejtësit luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në transmetim.

Streptococcus suis mbijeton te mizat deri në pesë ditë. Kjo nënvizon nevojën për dezinfektim. Streptokokët hyjnë në trupin e derrat përmes plagëve ose lëndimeve. Këto plagë mund të shkaktohen nga kushtet e pafavorshme të strehimit, të tilla si dyshemeja e ashpër, skajet e mprehta ose objektet me majë. Prerja e dhëmbëve në ditën e parë të jetës, e cila ndonjëherë kryhet ende, shkurtimi i bishtave dhe kastrimi gjithashtu formojnë pika hyrëse.

Kujdes i veçantë duhet treguar gjatë administrimit të hekurit, vitaminave ose vaksinave mbrojtëse: Nëse agia nuk ndërrohet rregullisht, patogjenët mund të përhapen me shpejtësi.

Shfaqja dhe zhvillimi i një infeksioni streptokoksik varet gjithashtu në raste individuale nga statusi imunitar i kafshëve, përbërja e patogjenit dhe faktorë të ndryshëm mjedisorë.

### Pasojat e mundshme të infeksionit streptokoksik

- ♦ Inflamacion i kafkës dhe trurit (meningjiti dhe encefaliti)
- ♦ Infeksion i shkaktuar nga bakteret ose toksinat në gjak (septicemia)
- ♦ Inflamacion i kyçeve (poliartrozë)
- ♦ Inflamacion i perikardit, kraharorit dhe/ose peritoneumit (poliseroziti)
- ♦ Pneumoni (inflamacion i mushkërive)
- ♦ Inflamacion i pareteve të brendshme të zemrës, shtresës së jashtme të pareteve të zemrës dhe shtresës muskulore të zemrës (endokarditi, epikarditi dhe miokarditi)
- ♦ Infeksionet e kërthizës
- ♦ Inflamacion i mukozës së hundës (rinitit) Sekretionet dhe aborti
- ♦ Përfshirja në MMA<sup>1</sup> së bashku me baktere të tjera si E. coli, Klebsiellae dhe Staphilococcus.

*1Mastit metrit agalaksia*

- ♦ Inflamacion i testikujve (orkit)
- ♦ Nekroza e bishtit
- ♦ Sëmundjet infektive të transmetueshme nga kafsha te njeriu si dhe nga njeriu te kafsha (patogjenët e zooantroponozës: meningjiti, septicemia, endokarditi)




**Fig. 1.** Inflamacion i kyçeve për shkak të streptokokut



**Fig. 2:** Shtypja e dhëmbëve me pincë mund të hapë një pikë hyrje për streptokoket

**Fig. 3:** Pneumonia me abscese si pasojë e infeksionit streptokok



### Trajtimi dhe parandalimi

Trajtimi i një infeksioni streptokoksik duhet të kryhet pas testimit të ndjeshmërisë (antibiogramit) ose efikasitetit të përshtatshëm. Aktualisht, preparatet me përbërësit aktivë penicilinë G, arnoksicilinë, ampicilinë, ceftiofur, cefquinom dhe enrofloxacin janë në dispozicion për trajtim. Prej disa kohësh në treg kanë dalë edhe medikamente me efekte afatgjata, duke mundësuar që mbarështimi modern i derrave të jetë më efikas. Nëse vetëm derrat individualë në një tufë janë të infektuar me *Streptococcus suis*, këshillohet që të trajtohet i gjithë grupi i kafshëve (p.sh. të gjithë gicat e një dose, ose të një stalle) në mënyrë që të reduktohet shpejt presioni i infeksionit.

### Masat parandaluese efektive janë:

- ♦ Sistemi strikt i ndarjes së dhomave me procedurë ndarjeje të përsosur: pa përzierje të gicave të moshave të ndryshme
- ♦ Minimizimi i numrit të gicave
- ♦ Në rastin e dyshemeve të vrazhda në zonën e pjelljes dhe rritjes së gicave, duhet të kryhet zëvendësimi ose rinovimi i shpejtë (p.sh. me veshje epokside).
- ♦ Optimizimi i kushteve klimatike në hambar: shmangni luhatjet e temperaturës, rrymat, përmbajtjen e gazit ndotës (veçanërisht dioksidin e karbonit) dhe përmbajtjen e pluhurit.
- ♦ Higjiena në zonën e pjelljes: hiqni rregullisht jashtëqitjet nga prapa dosave; nëse është e nevojshme, lani dosat për mbarsje përpara se t'i transferoni në stallën e pjelljes; strehoni dosa për mbarsje vetëm në vende të pastruara dhe të dezinfektuara.
- ♦ Shkurtimi i dhëmbëve në ditën e parë ose të dytë të jetës duhet të bëhet vetëm nëse është e nevojshme dhe me ndihmën e një aparati bluajtes.
- ♦ Kur pritët bishti, duhet të përdoren mjete që sigurojnë që plaga të jetë zhdukur dhe kështu të parandalohet hyrja e streptokokut.

- ♦ Kastrimi i gicave duhet të bëhet deri në ditën e shtatë të jetës. Nëse përdoret vetëm një bisturi, tehu duhet të fshihet me një leckë të pastër pas çdo gici. Nëse përdoren disa bisturi, vendosini në një tretësirë dezinfektuese. Kjo siguron një kohë të përshtatshme ekspozimi. Pas kastrimit, plaga duhet të trajtohet me një pluhur antibiotik ose llak. Në fermat me raste të shpeshta të infeksioneve streptokoksike, duhet të konsideroni trajtimin metafilaktik me antibiotikë së bashku me veterinerin.
- ♦ Largimi i kafshëve me plagë të hapura
- ♦ I gjithë parandalimi është zbulimi dhe trajtimi në kohë i kafshëve të sëmura. Këto duhet të ndahen menjëherë nga tufa dhe të zhvendosen në një stallë të posaçme kafshët e sëmura.

Vaksinat komerciale aktualisht nuk janë të disponueshme, por kompanitë farmaceutike po punojnë intensivisht për zhvillimin e tyre. Prodhimi i vaksinave specifike për stalla është i vështirë sepse zhvillimi i imunitetit pas infektimit të shtameve të ndryshme varion. Efektiviteti në praktikë është trajtuar në mënyrë kontraversiale deri më tani.

Si një alternativë ose trajtim shtesë, mund të aplikohet acidi laurik në ushqim ose trajtimi i kafshëve me probiotikë.

### Konkluzioni

Masa mund dhe duhet të merren në të gjitha fermat për të minimizuar rrezikun e shfaqjes së sëmundjeve të lidhura me streptokokun, të cilat ulin suksesin e fermave!

### Për më shumë informacion:



### Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**website:** www.ap.com.al

### 30. KONCEPTI I TË USHQYERIT PËRCAKTON SUKSESIN

Përpunuar nga Jon Zeneli

Gjenetika me performancë të lartë nënkupton sfidë për prodhuesit e suksesshëm të derrave: rritja e tufave të mëdha me vdekshmëri të ulët.

Një numër i lartë i gicave të shkëputur për dosë në vit mund të arrihet vetëm nëpërmjet strategjive të ushqyerjes dhe të menaxhimit. Dosa shpesh nuk mund t'i furnizojë në mënyrë optimale me qumësht të gjithë gicat. Rekomandohet të vendoset nga ferma në fermë, nëse rritja pa nënë me ndihmën e një dose zëvendësuese është fitimprurëse dhe e realizueshme në aspektin ekonomik.

Ushqyerja intensive e suplementuar e gicave në gji që nga dita e dytë e jetës përmirëson performancën e rritjes së tufave të forta të derrave. Schaumann ofron një program gjithëpërfshirës për ushqimin suplementar të gicave në gji, të përshtatur për strategjitë individuale dhe kërkuese të të ushqyerit.

Ushqimi i përshtatshëm për gicat është i shijshëm dhe i tretshëm. Komponentët e përzgjedhur me kujdes sigurojnë konsum të mirë të ushqimit, pëfitime të larta dhe zhvillim uniform të të sapolindurve. Probiotiku Bonvital mbështet në mënyrë efektive shëndetin e zorrëve.

Veçanërisht në ditët e para të jetës, mund të krijohet deficiençë e produktit kur ka numër të madh gicash. Kjo mund të korrigjohet me ushqyerje intensive shtesë që nga dita e parë. Në këtë mënyrë krijohen themelet për prodhimin e suksesshëm të gicave me vdekshmëri të ulët, sidomos kur dosat kanë një fillim të vështirë të laktacionit.

#### **Gjatë ditëve të para të jetës po përdoren dosa zëvendësuese.**

Përveç rritjes së shkallës së mbijetesës, qëllimi është që të prodhohen gica më të zhvilluar në mënyrë uniforme me pesha të kënaqshme pas shkëputjes nga gjiri.

**Bi-Lactal Premium** - që nga dita e parë e jetës. Zëvendësuesi i acidifikuar i qumështit mbulon dy fusha: ushqyerjen suplementare të gicave në gji si dhe rritjen pa nënë. Mikro-përbërësit lehtësisht të tretshëm dhe përmbajtja e ekuilibruar e qumështit pluhur të skremuar rrisin performancën e rritjes. Burimet e disponueshme të yndyrës mbështesin rezervat e energjisë endogjene të derrave në javët e para të jetës.

**Bi-Lactal Dessert** quhet produkti i ri i ushqimit suplementar të tufave të mëdha të të porsalindurve që nga dita e tretë e jetës. Shumë ferma përdorin Bi-Lactal Dessert me rezultate të kënaqshme. Përparësitë: Arrihet marrja e lartë e lëndës së thatë dhe energjisë. Tranzicioni në ushqim të thatë lehtësohet. Probiotiku Bonvital gjithashtu stabilizon shëndetin e zorrëve të gicave të rinj dhe mungesa e dosave gjidhënëse përmirëson higjienën.

Gjithashtu gicat më të rinj e pranojnë me lehtësi përzierjen kremoze të qumështit, që plotëson qumështin e dosës. Shkalla e mbijetesës së tyre përmirësohet ndjeshëm në ditët e para, shpesh kritike të jetës.

Mbarështuesët e gicave përfitojnë gjatë gjithë proceseve. Rezultati është më shumë gica për dosë në vit, shtimi më i lartë i peshës dhe performanca më e mirë në përgjithësi.

#### **Rritja e suksesshme e gicave**

Koncepti Schaumann ofron shumë mundësi për përgatitje përzierjesh ushqimi, për rritjen e mëvonshme të gicave. Këto programe disponojnë suplemente të gicave që mund të përdoren për të prodhuar prestarter shumë të tretshme, ushqime për fazën e shkëputjes nga gjiri dhe për fazën e rritjes, që janë të pajisura në mënyrë optimale me energji dhe proteina, pa sojë.

Përveç burimeve proteinike shumë të tretshme, këto suplemente përmbajnë përbërës qumështi me cilësi të lartë dhe një kombinim të veçantë yndyre, të përshtatur për nevojat e veçanta të gicave.

**SchaumaLac 50 Plasma G** është produkti më i mirë për fazën e shkëputjes nga gjiri. Përbërësit me proteina shtazore dhe përmbajtje të lartë të energjisë lehtësisht të tretshme rezultojnë në rritje e shpejtë dhe uniforme të gicat e vegjël.

**SchaumaLac Ferkelmix** është suplementi i proteinave dhe energjisë për konceptet individuale të rritjes. Ai është i kombinuar me ushqimin përkatës mineral të derrave SchaumaLac - me të mund të realizohen edhe përzierje për shkëputje nga gjiri dhe rritje të cilësisë së lartë dhe të sigurt.

Përzierjet minerale për rritjen e gicave përshtaten me bazat e ndryshme të racioneve të elbit/grurit ose përzierjeve me përmbajtje të lartë misri. SchaumaLac Protect Top 5 është një mineral inovativ gicash për performancë të lartë.

**SchaumaLac Protect Top 5** është përshtatur në mënyrë ideale për nevojat e derrave. Përveç katër aminoacideve, lizinës, metioninës, treoninës dhe triptofanit, ai përmban gjithashtu valinë, një lëndë ushqyese jetike që duhet t'i jepet derrit përmes ushqimit. Shtimi i këtij aminoacidi të pestë thelbësor rrit ndjeshëm vlerën biologjike të proteinës së papërpunuar.

Furnizimi me valinë në përputhje me kërkesat e kafshëve është thelbësor, nga eksperiencat e suksesshme në praktikë, një prej tyre vijon si më poshtë:

Grupi eksperimental dha rezultat mjaft të mirë në krahasim me grupin e kontrollit pa plotësim valine, me shtime peshe më të larta prej 10.9% dhe një përmirësim 4.3% në konvertimin e ushqimit.

SchaumaLac Protect Top 5 gjithashtu përmban aroma dhe shije, të cilat sigurojnë konsumim të lartë të ushqimit. Përmbajtja e vitaminës që rrit performancën, për shembull, me më shumë biotinë dhe vitaminë E përmirëson metabolizmin e energjisë dhe statusin imunitar të derrave. Një paketë e optimizuar e acidit, fitazës dhe Bonvital-it garanton sigurinë optimale.

#### Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve**

#### **Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)

**website:** [www.ap.com.al](http://www.ap.com.al)



## 31. DERRAT KANË NEVOJË TË VAZHDUESHME PËR UJË

Përpunuar nga Kristian Maka

Uji është një komponent mjaft i rëndësishëm, prandaj vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sasisë, që u jepet derrave në përditshmëri.

Uji luan një rol vendimtar për metabolizmin. Funkcionaliteti normal i tij realizohet vetëm kur furnizimi me ujë është i mjaftueshëm. Nëpërmjet ujit arrihet një temperaturë e ekuilibruar trupore. Avullimi i ujit nga gjëndrat e djersës, nëpërmjet lëkurës është shumë i kufizuar te derrat. Transporti i lëndëve ushqyese dhe tretja e tyre gjithashtu kryhet nëpërmjet ujit.

Forma dhe presioni i brendshëm ndërqelizor rregullohen nga përmbajtja e ujit në qelizë. Uji është përbërësi kryesor i qumështit, gjakut, lëngut sinovial dhe palcës kurrizore. Ai luan një rol kryesor në shëndetin e derrave. 75 deri 80% e masës trupore të gicave përbëhet nga uji. Përmbajtja e ujit tek dosat është rreth 50% e masës trupore, në varësi të moshës së tyre.

### 1 pirëse për 10 derra

Kërkesa për ujë ndikohet nga mosha, pesha, niveli i performancës, temperatura e mjedisit dhe përbërja e ushqimit. Kur temperatura rritet nga 20° në 30° C, konsumi i ujit pothuajse dyfishohet. Për të siguruar sasinë e duhur të ujit, duhet të ofrohet të paktën 1 pirëse për çdo 10 derra. Gicave dhe derrave të majmërisë mund t'ju nevojitet rreth 1 litër ujë/10 kg peshë trupore.

### Gicat e sapolindur kanë nevojë për ujë

Gicat e sapolindur, e marrin një pjesë të madhe të ujit nëpërmjet qumështit të dosës, prandaj kanë nevojë për ujë të pastër. Në ditët e para të jetës, ata konsumojnë rreth 50 ml ujë në ditë. Sasia totale e ujit duke përfshirë qumështin është 1-2 litra/gic. Në temperaturën 28°C, nevoja për ujë tek gicat është rreth 4 herë më e lartë se në 20°C, në dhomën e pjelljes. Rëndësia e furnizimit me ujë për gicat e sapolindur qëndron te shkëputja e tyre nga gjiri. Gicat e shkëputur nga gjiri, si edhe ata ende në gji, që marrin ujë të mjaftueshëm, janë më të shëndetshëm dhe zhvillohen më mirë. Kombinimet e pirësive me bilbila kanë rezultuar efektive. Pozicionimi i ujit në dhomën e pjelljes nuk duhet të jetë në zonën e feçeve të derrave dhe duhet të shmanget lagështia në pjesën e shtretërve.

### Më shumë ujë gjatë fazës së shkëputjes nga gjiri

Gjatë fazës së shkëputjes, rekomandohet të merret parasysh sasia e duhur e ujit dhe ushqimit, veçanërisht në ditët e para. Pozicionimi i duhur i lugut të ushqimit dhe pirësive të ujit, si dhe sasia optimale e ofrimit të ushqimit dhe ujit shkurtojnë kohën e tranzicionit nga gjiri në ushqyerje të rregullt. Kjo parandalon problemet me tretjen dhe mungesat e energjisë. Lartësia e pirësive duhet të rregullohet çdo javë për gicat e shkëputur nga gjiri.

### Higjiena

Kërkesat për ujë të dosave variojnë nga 10 deri në 15 litra ujë/ditë. Dosat gjidhënëse kanë nevojë për rreth 1,5 litra/ditë ujë shtesë për çdo gic. Sidomos gjatë lindjes, rekomandohet mbushja e lugut të dosës me ujë 2 herë në ditë. Pirëset, që tregojnë dhe nivel kanë rezultuar të suksesshme. Kjo mënyrë pirjeje është më afër natyrale dhe rezulton në marrjen më të mirë të ujit, veçanërisht kur ka një kërkesë të shtuar.

### Cilësia e ujit

Po aq e rëndësishme sa sasia e ujit të freskët është edhe cilësia e tij. Lidhja e ujit të stallës me rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm, qoftë publik apo lokal, është një çështje diskutimi në shumicën e rasteve. E rëndësishme është gjithashtu që depozitat e ujit dhe pirëset të jenë të pastra. Rekomandohet shpëlarja dhe pastrimi i thellë i linjave të ujit dhe hapësirave boshe në intervale të rregullta.

### Për më shumë informacion:



### Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

## 32. PNEUMONIA ENZOOTIKE ËSHTË PROBLEM PËR TUFËN

Përpunuar nga Kristian Maka

Kolla me sekrecione dhe gulçimi janë shenja të pneumonisë enzootike. Ajo çon në ulje të performancës dhe është një pararendëse e sëmundjeve të tjera.



Kolla dhe gulçimi janë problemi mbizotërues në majmëri. Përqindja e kafshëve që kolliten rritet me moshën, vërehet kanibalizmi si pasojë e rritjes së stresit në tufë. Ka një shtim të mortalitetit gjatë majmërimin në mbarështimin e derrave.

Në një fermë të kombinuar është zhvilluar një studim (cikli 4-javor, 250 dosa mbarështuese, 1900 vende majmërimi). Dosat- SPF e blera ishin pa PRRSV, Mycoplasma hyopneumoniae dhe APP. Dosat u futën në karantinë për disa javë, u pastruan, vaksinuan (parvovirus, PRRSV) dhe u testuan serologjikisht. Vaksinimet e zakonshme kundër etheve kryhen në javët e para të jetës.

Gjatë një kontrolli rutin në stallë, u vunë re disa simptoma: ankthi dhe kolla. Një prej kafshëve (drejt fundit të majmërimin) ishte në gjendje të rëndë (kollë, veshët cianotik/ turiri) dhe për këtë arsye u zgjodh për disekcion diagnostik. Në përfundim të disekcionit rezultoi se mushkëria ishte me seksione të ajrosura dobët, në zonën e lobeve anteriore dhe abscese të vogla.

U morën mostra për ekzaminim të mëtejshëm. Ekzaminimi bakterologjik zbuloi praninë e patogjenëve të ndryshëm respiratorë dhe piogjenë si dhe Mycoplasma hyopneumoniae të shkallës së lartë.

### Të gjitha grupmoshat në rrezik

Mycoplasma hyopneumoniae është shkaktari i pneumonisë enzootike (EP), një sëmundje respiratore që mund të prekë kafshët e të gjitha moshave. Fokusi kryesor është në humbjet indirekte për shkak të performancës së reduktuar, shtesave të ulëta ditore, si dhe të kafshët e vogla dhe të dobëta. Sëmundja është e përhapur në mbarë botën. Dosat që nuk bien në sy klinikisht janë rezervuar kryesor i patogjenit. Gicat infektohen menjëherë pas lindjes. Për shkak të transmetimit, është e vështirë të frenohet sëmundja brenda një ferme.

### Dosat mbartëse të bakterit

Në rastin konkret, mungesa e ekspozimit ndaj patogjenëve të pranishëm në fermë, të dosave në karantinë duket se është arsyeja e problemeve të frymëmarrjes. Për kafshët e painfektuara nga Mycoplasma hyopneumoniae, gjatë karantinimit rekomandohet një program i përshtatshëm vaksinimi. Dosat e integruara në tufë që infektohen me Mycoplasma hyopneumoniae mund të vazhdojnë ta mbartin atë deri në ditën 214 dhe kështu kontribuojnë në mënyrë të ndjeshme në përhapjen e patogjenit. Vaksinimi i gicave (në fund të javës së parë dhe në fund të javës së katërt të jetës) duhet gjithashtu të merret parasysh për të reduktuar presionin e patogjenit në grupmoshat pasuese. Para trajtimit me antibiotikë, duhet të kryhet një antibiogram. Aplikimi i vaksinimit të dosave dhe ndryshimet në menaxhimin e higjienës kanë përmirësuar ndjeshëm situatën në fermë.

### Për më shumë informacion:



### Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**website:** www.ap.com.al

### 33. TË USHQYERIT E DERRAVE

Përpunuar nga Kristian Maka

#### Higjiena e ujit dhe ushqimit si faktorë suksesi

*25 dhe më shumë gica të shkëputur nga gjiri, për dosë në vit - ky është potenciali i rezultateve të mbarështimit modern të derrave.*

Shtimet në peshë ditore prej më shumë se 500 g janë të mundshme gjatë rritjes së derrave dhe mbi 900 g gjatë majmërimit. Ky është një nivel i lartë, i cili në thelb përcaktohet nga cilësia e ushqimit.

E rëndësishme është cilësia e ushqimit, e cila duhet të ruhet në të gjitha fazat. Kjo vlen për transportin e ushqimit për në fermë, ruajtjen e drithërave të blerë dhe kalimin e ushqimit nga magazina në lug.

Cilësia duhet të jetë gjithashtu e mirë deri në stomakun e kafshës. Prandaj: identifikoni pikat e dobëta në kohën e duhur.

#### Higjiena në sistemet e ushqimit të thatë

Ushqimi i thatë përdoret në më shumë se gjysmën e të gjitha fermave të derrave. Efektet e higjienës së dobët të ushqimit zakonisht nuk janë aq të dukshme sa në sistemet e ushqimit të lëngshëm. Problemet e higjienës me ushqimin e thatë nuk duhet të nënvlerësohen.

Pikat e dobëta të tilla si dalja në silos, makineria ushqyese nën silos, tubi i sistemit transportues në zonën e murit të stallës, rrotullat e devijimit, dozuesi i vëllimit ose kontejneri i magazinimit të ushqimit, ushqyesit automatikë ose lugjet, duhet të kontrollohen me kujdes.

Këto procese mund të hyjnë në fuqi edhe më shpejt në stallë, sepse nxehtësia përshpejton rritjen e mikroorganizmave. Sasi të vogla të mbetjeve të ushqimit mbeten brenda rrotullave të devijimit tek transportuesi. Këtu zhvillohen afidet (parazite shumë të vegjël). Akoma më problem bëhet kur afidet vazhdojnë të shumohen diku tjetër në linjën e ushqimit.

Shija e ushqimit ulet dhe për pasojë, marrja e ushqimit të kafshëve fillimisht bie në mënyrë të vazhdueshme. Performanca e dosave, gicave ose derrave në majmërim bie në mënyrë graduale.

Një zvogëlim i shtimit në peshë prej 10 ose 20 g në ditë të gicat ose 30 deri në 40 g të derrat e majmur është i mundur për shkak të infektimit të ushqimit nga afidet ose mola. Kjo rezulton në një humbje prej 2 deri në 5% të performancës së synuar.

Mbetjet e ushqimit në kontejnerë, ushqyes ose lug ofrojnë kushte optimale për shumimin e organizmave të dëmshëm. Ushqimi me cilësi të lartë "mbizotërohet" shpejt nga ushqimi i kontaminuar. Rezultati: Performanca dhe veçanërisht sistemi imunitar i kafshëve dobësohet.



#### Masat parandaluese për të ruajtur cilësinë e ushqimit:

- Kontrolli i mizave, afideve dhe molës
- Pastrimi i linjave të furnizimit Vulosja
- e daljes në silosin e ushqimit
- Pastrim i rregullt i ushqyesve volumetrikë dhe ushqyesve automatikë
- Përdorimi i acideve ushqimore me efekt ruajtës

#### Higjiena e ujit

Një rregull bazë për të mbajtur tufën e shëndetshme është t'u ofroni derrave ujë me cilësi të lartë në çdo kohë! Mangësitë në cilësinë e ujit mund të ndodhin për shkak të shumë ndikimeve, të tilla si uji i ndenjtur kur një ndarje është bosh, shkëmbimi i pamjaftueshëm i ujit në një tub, përdorimi i materialeve të tubave, që nxisin mikrobet (p.sh. tubat plastike), depozitimet në tuba, formimi i një biofilmi, pirëse uji të papastrë, kontejnerë të papërshtatshëm për ruajtjen e ujit.

Linjat duhet të pastrohen pas çdo ndërhyrjeje, tasat e pirjes duhet të kontrollohen çdo ditë.

Depozitat në linja mund të hiqen ose shmangen nga dioksidi i klorit ose aditivë acidë. Kur përdoren acide, duhet të merret parasysh përshtatshmëria me materialin dhe dëmtimet e mundshme (p.sh. me acid formik të pastër).

Acidet speciale të ushqimit për ujin e pijshëm janë jo gërryese dhe me aromë të pranueshme. Ato janë të përshtatshme për higjienën bazë dhe gjithashtu për dezinfektimin e përhershëm. Për më tepër, ato kanë një efekt pozitiv në traktin gastrointestinal të derrave. Normat e aplikimit janë të ulëta, kostot janë relativisht të ulëta dhe përfitimet janë të larta. Rezultatet janë më pak diarre, më pak përdorim i medikamenteve dhe konsum më i lartë i ujit dhe ushqimit.

Përmirësimet në higjienën e ushqimit janë gjithashtu të mundshme dhe të nevojshme në sistemet e ushqimit të thatë. Optimizimi i higjienës së ujit është një detyrë rutinë; dioksidi i klorit ose përdorimi i acideve të veçanta mund të ndihmojë. Kur pastroni stallën, pastroni edhe pjesën e brendshme të tubave të ujit!

#### Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit  
Profesional të Blegtorëve**

#### **Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)

**website:** [www.ap.com.al](http://www.ap.com.al)

### 34. FILLIMI SHËNDETSHËM I JETËS - BONVITAL PËR GICAT NË GJI

Përpunuar nga Kristian Maka

Përfitimi i prodhimit të gicave matet me numrin e gicave të rritur për çdo dosë në vit. Peshë e shkëputjes nga gjiri ka një ndikim të rëndësishëm në rritjen e tyre në periudhat e mëvonshme.

Peshë në lindje, numri i të sapolindurve dhe rendimenti i qumështit të dosës ndikojnë në peshën e shkëputjes nga gjiri. Lindjet e shumta me peshë fillestare nën mesataren nuk janë të rralla. Nëse këta gica do të mbijetojnë ditët e para të jetës dhe më pas do të zhvillohen mirë, është e rëndësishme të mbështesni vitalitetin dhe sistemin e tyre imunitar.

Zorra është organi imunitar më i madh në trup, por gjithashtu përfaqëson pikën hyrëse të mikrobeve patogjene. Flora e qëndrueshme intestinale ka një rëndësi të madhe për mbajtjen e gicit të shëndetshëm. Probiotiku Bonvital ndikon pozitivisht në performancën e gicave.

#### **Eksperiment ushqimi me gicat në gji**

Në bashkëpunim me Freie Universität Berlin (Universitetin e Lirë të Berlinit), u dokumentuan efektet pozitive të Bonvital tek gicat në gji. Një provë praktike testoi efektin e dhënies së kombinuar të Bonvital (pastë dhe prestarter) në zhvillimin e peshës së gjallë, marrjen e prestarterit dhe konsistencën e jashtëqitjes te gicat në gji (Euroc x Pietrain).

Gjatë periudhës 28-ditore të gjdhënies, gicat morën një dozë orale të SchaumaLac Pro Aktiv (2 ml për kafshë) në ditët 1 dhe 4 dhe një prestarter nga dita e 11 e jetës. Grupit Bonvital iu dha SchaumaLac Pro Aktiv dhe prestarter me përmbajtje të Bonvital. Gicave në grupin e kontrollit iu dhanë të dy produktet pa Bonvital.

20 dosa me numër të ngjashëm lindjesh u ndanë në dy grupe në fund të shtatzanisë dhe u vendosën veçmas në stalla pjelljeje pa kashtë. Deri në fund të eksperimentit, dosat janë ushqyer me një dietë pa probiotikë. Pas pjelljes, gicat u krahasuan për peshën e gjallë dhe numrin. Numri mesatar i gicave për pjellje ishte 10.4 gica.

Karakteristikat e tjera të dosave (peshë e gjallë, marrja e

ushqimit dhe humbja e peshës së gjallë) gjithashtu korrespondojnë shumë mirë në të dy grupet e testimit gjatë gjithë periudhës së gjdhënies. Kjo siguroi kushte optimale për vlerësimin e Bonvital.


Përdorimi i Bonvital përmirësoi peshën e heqjes nga gjiri të derrave me 1,09 kg për gicë, pra me 13,2%, krahasuar me grupin e kontrollit (shih Fig. 1). Veçanërisht në tre ditët e para të jetës dhe nga java e tretë e jetës, ritmet më të mira të rritjes u panë te gicat në gji si rezultat i shtimit të Bonvital. Mesatarisht, gicat në grupin Bonvital konsumuan 15.1% më shumë para fillimit sesa gicat e grupit të kontrollit (shih Fig. 2). Ky efekt ishte veçanërisht i theksuar në javën e 4-të të jetës.

Zhvillimi shumë pozitiv i përfitimit në peshë të gicave në grupin Bonvital mund t'i atribuohet vetëm në një masë të vogël marrjes më të lartë të prestarterit. Përkundrazi, përdorimi më i mirë i lëndëve ushqyese duke forcuar florën e zorrëve dhe sistemin imunitar është arsyeja e ritmeve më të mira rritjes. Kështu, më shumë energji ishte në dispozicion për formimin e masës trupore.

Bonvital gjithashtu përmirësoi konsistencën e feçeve gjatë gjithë periudhës së gjdhënies (shih Fig. 3). Humbjet ishin shumë të ulëta në grupin Bonvital dhe atë të kontrollit, përkatësisht në 0.9% dhe 0%.


Kjo provë konfirmon: Bonvital është gjithashtu një komponent i fortë tek gicat në gji, duke realizuar performancë dhe shëndet më të mirë. Të gjitha produktet SchaumaLac dhe Schauma e përmbajnë probiotikun.

**Fig. 1: Zhvillimi i peshës së gjallë gjatë periudhës së laktacionit.**  
Pesha e gjallë në ditën e 28-të të jetës




**Fig. 2: Konsumi mesatar ditor i ushqimit nga dita e 11 deri në ditën e 28-të të laktacionit.**

Marrja e pretarter



**Fig. 3: Konsistenca e fekaleve të gicave gjatë periudhës së laktacionit.**  
Konsistenca fekale (1 = normale; 4 = e lëngshme)



Java Laktacionit	1.	2.	3.	4.
Kontrolli	1,21	1,19	1,46	1,50
BONVITAL	1,19	1,07	1,17	1,11

Për më shumë informacion:



**QF** Qendra e Formimit  
**PB** Profesional të Blegtorëve

**Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**website:** www.ap.com.al

## 35. MJESHTËRIA E MBARËSHTIMIT TË DERRAVE

Përpunuar nga Kristian Maka

### *“Me derra të lumtur mund të fitoni më shumë para”*

Kees Scheepens pretendon se ka vëzhguar dhe mësuar të kuptojë tingujt e derrave dhe gjuhën e trupit të tyre, në rreth pesë milionë krerë që ai ka parë me kalimin e kohës. Veterineri holandez këshillon fermerët e derrave në të gjithë Evropën dhe ndonjëherë provon edhe nga ushqimi i kafshëve.

*Dosa hungërin, shkund kokën dhe duket e zemëruar.* Kees Scheepens, 53 vjeç, ka provuar nga lugu ushqimet e kafshëve. “Rupp, rupp” i derrit është një tingull alarmi dhe do të thotë diçka të ngjashme me: “Po e them një herë. Po e them dy herë, por nuk do të ta them për herë të tretë”, përkthen Scheepens. Veterineri i trajnuar është një “mjeshtër derrash”. Gjatë dy dekadave e gjysmë, ai ka vizituar stalla në çdo vend të Evropës dhe ka zbuluar nga sjellja e kafshëve, nëse ato janë vërtet të shëndetshme. Nuk është punë e lehtë për të, sepse ai thotë gjithmonë: “Nuk do mësohem kurrë me erën e stallës.”

Holandezi miqësor e lë ushqimin t'i shkrihet në gojë. “Një lloj supe me drithëra dhe acid. Është e mirë.” Ai thotë se derrat, janë përzgjedhës si njerëzit - “nëse ushqimi nuk është në rregull, ata e lënë në lug”.

Në Münsterland një fermer ka gjithmonë punë. Mjeshtri holandez shpesh duhet të ndihmojë derrat e tij të lindin. Kjo kërkon shumë punë dhe kohë. Stalla është e madhe, ka dhjetëra dosa. Scheepens vëzhgon me qetësi kafshë pas kafshe, kërkon anomali, kontrollon nëse gicat janë grumbulluar njëri mbi tjetrin. “Atëherë ata kanë shumë ftohtë.” Ngrohja nën dysheme u siguron atyre ngrohtësi. Por eksperti dëshiron të jetë i sigurt, largohet për pak kohë nga stalla dhe kthehet me një makineri mjegulle. Menjëherë pas kësaj, nuk mund të shihet shumë koka e dosës nga i gjithë akulli i thatë. Mjeku veteriner dëshiron të përfytyrojë rrjedhën e rrymave të ajrit në stallë. “Dua të sqaroj nëse furnizimi me ajër të pastër shkatërron mikroklimën e gicave të vegjël”.

Eksperimenti tregon se jo. Mjegulla lëviz aty ku i takon, mbi kafshën mëmë. Pjesa e ngrohur e dyshemesë me gicat qëndron e ngrohtë. Mjegulla nuk u bën aspak përshtypje. Dosa hungërin dhe ushqen të vegjlit e saj.

“Tingulli shoqërohet nga lëshimi i rregullt i hormonit oksitocinë”, thotë Scheepens. Kjo stimulon prodhimin e qumështit, vijon ai. Holandezi nga qyteti i Eindhoven-it thotë se i ka hasur shumë rastësisht derrat gjatë studimeve. Deri më sot, ai ka këshilluar rreth 15,000 fermerë. Gjithçka ka të bëjë me mënyrën se si t'i mbajmë kafshët sa më mirë në përputhshmëri me llojin. “Mund të fitoni më shumë para me derra të lumtur”. Për fat të keq, disa fermerë bëhen të verbër ndaj kësaj me kalimin e kohës. Fermerëve u propozon:

Pyetja është gjithmonë: Çfarë të bëj me situatën ekzistuese? Stalla nuk duhet shkatërruar dhe ndërtuar ngta e para, por duhet t'i kushtohet vëmendje disa ndryshimeve të vogla. Për shembull, furnizimi me ujë të freskët për dosat dhe derrat duhet të ketë më shumë presion uji:

“Asnjë nga dosat nuk duhet të ketë etje. Është më mirë nëse pijnë më shumë seç duhet. Në këtë mënyrë, më shumë mikrobe nxirren jashtë me urinë.” Ndoshta do të zvogëloheshin edhe lindjet me probleme.

### **Për më shumë informacion:**



**QF Qendra e Formimit  
PB Profesional të Blegtorëve**

### **Austria Praemix shpk Tel:**

+355 (0)68 402 6311

**e-mail:** [agri@ap.com.al](mailto:agri@ap.com.al)


**website:** [www.ap.com.al](http://www.ap.com.al)

## 36. ORGANIZIMI I KOHËS SË DERRAVE NË MAJMËRIM

Përpunuar nga Kristian Maka

### Mbarështimi i derrave

Termi "materiale aktivizimi për derrat" është ngatërruar edhe në "Aktin e Mbrojtjes së Kafshëve". Ligjvënësi ka lënë të hapura në formulim disa detaje të eksportit, në mënyrë që shumë gjëra të testohen dhe të fitohet në të njëjtën kohë përvojë. Franz Strasser e di se çfarë supozohet të jenë në gjendje të realizojnë objektet e aktivizimit.



Si fillim, në manualin e rritjes së derrave, në lidhje me materialet e aktivizimit thuhet: Norma ligjore: 1-rë ThVO, Shtojca 5, 2.7: "Derrat duhet të kenë akses të përhershëm në sasi të mjaftueshme materialesh për të ekzaminuar dhe lëvizur, si kashtë, dru, tallash, pleh kërpudhash, torfë ose një përzierje e këtyre materialeve që nuk rrezikojnë shëndetin e kafshëve." Për t'i mbajtur dosat, gicat dhe derrat të zënë në mënyrë konstante dhe me materiale interesante, rekomandohen produkte të tilla si litarët sizale, raftet e kashtës dhe shpërndarësit e ushqimeve të papërpunuara. Këto produkte inkurajojnë sjelljet natyrale hulumtuese të kafshëve.

Ashtu si me lodrat për fëmijët dhe kafshët shtëpiake në përgjithësi, duhet të jenë tërheqëse dhe interesante. Për derrat, diçka që ata mund të kafshojnë dhe që lëviz është interesante.

Nga ky këndvështrim, kashta do të kishte padyshim një përdorim të gjerë, pasi me të mund të praktikohet edhe instinkti i gërmimit. Megjithatë, në mbarështimin konvencional të derrave për majmërim në dysheme me rrasa të plota, ajo mund të përdoret vetëm në shumë pak raste pa patur probleme me sistemin e plehut organik.

Kashta duhet të jetë shumë higjienike dhe me përmbajtje të ulët pluhuri dhe mykotoksinash. Te raftet e kashtës, derrat mund t'i tërheqin vetë fijet përmes "shportës" me rretë. Një tabaka grumbullimi e montuar poshtë parandalon ndotjen e madhe dhe kashta mbetet interesante për më gjatë.

### Materialet e lëvizshme

Në shumë ferma, zinxhirë me hallka të ngushta, të mbuluar me tub plastik varen në pjesë të stallës si materiale argëtuese. Avantazhi i këtij materiali është qëndrueshmëria e tij, është higjienik dhe gjithmonë i pastër, pasi nuk ndotet lehtë për shkak të sipërfaqes së lëmuar. Derrat e pranojnë me kënaqësi, pasi e kapin lehtësisht me gojë. Është e rëndësishme për kafshët që pjesët të lëvizin. Gomat e makinave ose pjesët e tyre në zinxhir duhet të mos përdoren, pasi rripi i çelikut në brëndësi të gomës mund t'i dëmtojë derrat kur të konsumohet.

### Material organik

Që nga maji 2013, AMA (Agrarmarkt Austria Marketing) u ka kërkuar fermerëve të saj të cilët mbajnë vulë cilësie të përdorin materiale organike për objektet e aktivizimit të derrave. Nëse kjo kërkesë nuk plotësohet, pritet një frekuencë më e lartë inspektimi. Në praktikë, druri përdoret shpesh për këtë qëllim. Derrat e pëlqejnë drurin si tra ngritës ose të lidhur me një zinxhir si lodër. Druri mund të gërryhet dhe kur montohet si një tra, ofron gjithashtu mundësinë e ngritjes dhe të plotësimit të dëshirës tipike të derrave për të gërmuar. Disavantazhi i drurit është mungesa e higjienës, pasi papastërtitë ngjiten mirë në pjesët e gërryera. Druri i butë konsumohet veçanërisht më shumë dhe duhet të rinovohet shpesh. Praktikuesit raportojnë gjithashtu probleme me copat e shkëputura të drurit që shkaktojnë bllokime në sistemin e kullimit të kanaleve ose tek shpërndarësit.



## Konkluzione

Ka shumë mënyra për t'i mbajtur derrat të zënë. Në varësi të sistemit të caktuar, çdo fermer derrash duhet të kërkojë materialet e duhura për kafshët e tij.

Për arsye higjienike, materialet duhet të qëndrojnë gjithmonë varur, përndryshe do të shtyhen shpejt në qoshe dhe do të ndoten dhe nuk do të pranohen më nga kafshët. Druri si material është një zgjidhje e mirë, sepse mund të gërryhet dhe kontribuon në praktikimin e instinkteve natyrore.

Ky standard ligjor plotësohet kur derrat kanë akses të vazhdueshëm dhe sasi të mjaftueshme materialesh që mund t'i ekzaminojnë, lëvizin dhe që nuk janë të dëmshme për shëndetin e tyre.

## Për më shumë informacion:



**Q F** Qendra e Formimit  
**P B** Profesional të Blegtorëve

### Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**Website:** www.ap.com.al

### 37. MËNYRA EFIKASE PËR ELIMINIMIN E TOKSINAVE DHE OPTIMIZIMIN E PERFORMANCËS SË DERRAVE- SCHAUMASAN PREMIUM

Përpunuar nga Kristian Maka

Mykotoksinat dhe endotoksinat mund të dëmtojnë masivisht shëndetin dhe performancën e derrave. Toksinat DON (deoksinivalenole), toksinat ZEA (zearalenone) dhe T2/HT2 kanë një rëndësi të veçantë praktike në ushqyerjen e derrave në Gjermani.

Kontaminimi me mykotoksina të derrat nuk dallohet qartë klinikisht, sepse sasi të vogla zakonisht nuk çojnë në zhvillimin e simptomave tipike. Kafshët shfaqin simptoma jospesifikë, me performancë nën mesataren ose ndarje grupi të kafshët. Mykotoksina të ndryshme përforcojnë njëra-tjetrën në efektin e tyre, kështu që edhe në nivele mjaft të ulëta mund të vërehet një ulje e qartë e performancës në stallë.

#### Analizat e ushqimit

Pas formimit të mykotoksinave në tokat bujqësore, duhet bërë një vlerësim i mirë i kontaminimit të pjesëve të ndryshme të drithërave dhe misrit, me analiza specifike në kohën e korrjes. Thatësira ekstreme bën të mundur shfaqjen e mykotoksinave edhe në pulpë të thatë. Duke ditur nivelet e mykotoksinës në ushqimet individuale, situata e përgjithshme mund të vlerësohet saktë. Sasia e mykotoksinave mund të reduktohet që me përshtatjen e përbërësve të ushqimit.

#### Endotoksinat e ngarkojnë kafshën


Mykotoksinat e gjejnë rrugën e tyre për tek kafshët përmes ushqimit, kurse endotoksinat formohen direkt në zorrë. Ato janë pjesë e murit të jashtëm qelizor të baktereve dhe çlirohen kur qeliza bakteriale vdes. Çrregullimet në florën e zorrëve dhe stresi i lartë fizik (p.sh. rreth lindjes) mund të çojnë në rritjen e vdekjes së baktereve dhe rrjedhimisht në më shumë endotoksina. Kjo dëmton mukozën e zorrëve dhe streson sistemin imunitar si dhe të gjithë metabolizmin e dosës (Fig.1).

#### Masat


Schaumasan Premium ndihmon në arritjen e një shëndeti të mirë të derrave. Efektet sinergjike shfrytëzohen për zgjedhjen e komponentëve të ndryshëm për grumbullimin e mykotoksinave.

Metabolizmi lehtësohet nga përdorimi i antioksidantëve të ndryshëm dhe në këtë mënyrë bëhet reduktimi i radikaleve të lira (Fig.2). Në këtë mënyrë parandalohet edhe dëmtimi i mukozës së zorrëve dhe mbështetet rigjenerimi i saj.

#### 1. Efekti i toksinave tek derrat



#### 2. Biloqet e ndërtimit të SCHAUMASAN PREMIUM



**Siguroni shëndet dhe performancë me SCHAUMASAN PREMIUM**

**Për më shumë informacion:**

**Austria Praemix shpk**

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**website:** www.ap.com.al

## 38. MASAT OPTIMALE KUNDËR PARAZITËVE DHE PROGRAMET E VAKSINIMIT TË TUFËS SË DERRAVE

Përpunuar nga Kristian Maka

Luftimi i parazitëve dhe programet e vaksinimit, së bashku me masat e pastrimit dhe dezinfektimit përbëjnë një pjesë të rëndësishme në menaxhimin shëndetësor në shumë ferma mbarështimi. Ato shërbejnë për të stabilizuar shëndetin e tufës dhe optimizimin e performancës. Koha e marrjes së masave është ende një çështje diskutimi, si dhe shpeshësia e përdorimit të barnave të disponueshme brenda një periudhe të caktuar kohore.

Mikrobiologjia e parazitëve dhe mikroorganizmave infektive, gjendja e tufës, moshja e grupeve të kafshëve dhe kushtet e jashtme duhet të merren parasysh patjetër.

Presioni i infeksionit (mikroorganizmat) dhe presioni i infektimit (parazitët) në parim nuk duhet të mposhtin sistemin imunitar të kafshëve. Sipas parimit që një zinxhir është i fortë po aq sa hallka e tij më e dobët, vlen edhe për tufën, që stabiliteti i saj shëndetësor është rezultat i shëndetit të të gjitha grupeve të kafshëve dhe kafshëve individuale. Pikat e dobëta në këtë sistem, qoftë për shkak të imunitetit të pamjaftueshëm, presionit të lartë të infektimit ose infestimit, fillimisht shkaktojnë ngarkesë të madhe në grupe moshash ose kategori prodhimi të caktuara deri në përhapje të theksuar të patogjenëve, të cilët sistemi imunitar i shumë kafshëve nuk është më në gjendje t'i përballojë. Pra, tufa është në duar të sigurta, kur presioni i patogjenit është më i ulët dhe imuniteti më i lartë.

Të dyja kushtet arrihen në rrugët e mëposhtme:

1. Mbartja, akumulimi dhe përhapja e patogjenëve mund të pakësohet në mënyrë drastike me ndihmën e proceseve fiziologjike dhe kimike. Këto masa janë më efektivet lidhur me ciklin e mbushjes dhe zbrazjes në bokset e stallave.
2. Baza e një sistemi të lartë imunitar të kafshët përbëhet nga furnizimi optimal me lëndë ushqyese dhe përbërës efektivë, i shoqëruar me kushte strehimi me nivel stresi të ulët. Mungesat në furnizimin e bazuar në nevojat, ekspozimi ndaj mykotoksinave dhe mangësitë në mikroklimë mund të shkaktojnë një dëmtim të konsiderueshëm të sistemit imunitar.
3. Përveç këtyre masave të përgjithshme stabilizuese, nevojiten dhe metoda specifike, d.m.th. që përdoren kundër patogjenëve të caktuar. Ato paraqiten në mënyrë të ndryshme të kafshët e reja dhe të vjetra.

### Vaksinimi i dosave ka prioritet

Disa sëmundje të gicave, që janë akoma në gji mund të frenohen në një masë të madhe vetëm me ndihmën e një furnizimi të mjaftueshëm të kulloshtrës, pra imunizimi pasiv. Dosat mëma duhet të vaksinohen kundër E. Coli, Clostridium perfringens ose Phinitis atrophicans jo më herët se 6 javë dhe jo më vonë se 2 javë përpara datës së pritshme të pjelljes, pasi i janë nënshtruar një imunizimi bazë si paradosa. Akumulimi dhe përhapja e këtyre patogjenëve frenohet në mënyrë afatgjatë, prandaj rreziku për këtë grupmoshë është dukshëm më i ulët.

### Forcimi i imunitetit

Në fazën e mëtejshme të rritjes, imuniteti pasiv zëvendësohet nga ai aktiv. Në varësi të statusit të infektimit të tufës, mund të jetë e nevojshme të forcohet imuniteti në mënyrë aktive me anë të vaksinimit kundër Mycoplasma hyopneumoniae nga mesi i javës së parë të jetës dhe një javë më vonë kundër virusit PRRS. Kohët e zgjedhura të vaksinimit zvogëlojnë në këtë mënyrë mundësinë që kafshët të infektohen nga patogjenët në këtë moshë. Kjo mundëson një shkallë të lartë sigurie në zhvillimin e kafshëve në gjashtë muajt e parë të jetës së tyre, për aq kohë sa nuk dominojnë patogjenët të tjerë që përcaktohen më në detaje.

Në rastin e bokseve pa kashtë, shkëputja nga mëmëzimi në grup dhe lëvizjet në ciklin e zbrazjes dhe mbushjes mundësohet dhe nga një kontroll i vetëm i ekto- dhe endoparazitëve në moshën 5 deri në 8 javë, për të shmangur dëmtimet e shkaktuara nga parazitët të tillë në fazën e rritjes.

Në të njëjtën mënyrë, imunizimi ose trajtimi në grup është krijuar për profilaksinë e kafshëve të reja që më vonë do të shërbejnë për mbarështim. Masat e lartpërmendura të imunizimit plotësohen më pas nga vaksinimet kundër erizipelës, parvovirusit dhe nëse është e nevojshme, gripit. Në kohën e përzgjedhjes së paradosave, vaksinimet e para të përsëritura mund të kryhen, me kusht që kjo të mos bëhet nga blerësi në stallën e karantinës.

## Parandalimi në të gjithë tufën

Të gjitha masat e vaksinimit që kryhen brenda gjashtë muajve të parë të jetës janë në thelb të orientuara drejt stabilitetit të shëndetit të kafshës ose grupit individual të kafshëve. Në tufën e dosave të mbarështimit, ky aspekt plotësohet me synimin për zhvillimin e shëndetshëm të embrioneve ose fetuseve të dosat mëma nga njëra anë dhe një status vazhdimisht të lartë imuniteti të të gjithë tufës së derrave të mbarështimit nga ana tjetër.

Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme të devijohet nga procedura e zakonshme e trajtimeve dhe vaksinimeve me parazitë në grup, gjithë popullata e dosave dhe derrave duhet t'i nënshtrohet masave profilaktike. Prandaj, presioni mesatar i parazitëve ose mikroorganizmave nuk do të ndryshojë thelbësisht me trajtimin në grup. Vetëm kur procedura të ndryshojë në favor të trajtimit të tufës, presioni i infeksionit do të bjerë në mënyrë drastike. Tundimi për zgjatjen e intervaleve të trajtimit, nuk duhet të ekzistojë, sepse mund ta rritë ndjeshëm këtë presion përsëri.

Në përgjithësi, kostot e trajtimit të tufës nuk do të jenë më të ulëta se ato të një procesi në grup, por niveli i shëndetit dhe i performancës do të rritet në periudhë afatgjatë dhe në këtë mënyrë do të përmirësojë efektivitetin e kostove të masave veterinare.

## Për më shumë informacion:



**QF** Qendra e Formimit  
**PB** Profesional të Blegtorëve

### Austria Praemix shpk


**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**website:** www.ap.com.al

## 39. KAFSHË TË SHËNDETSHEME PËR PERFORMANCË TË LARTË

Përpunuar nga Kristian Maka



Kombinimet specifike të acideve në ushqim kanë një ndikim pozitiv në shëndetin dhe shkallën e konvertimit të ushqyerjes së kafshëve. Schaumacid-i i lëngshëm është kombinimi i ri i acideve të Schaumann, i cili ndikon në uljen e vlerës së pH dhe rritjen e efektit antibakterial. Baza për këtë është kombinimi i zgjedhur i acideve të ndryshme organike. Ky produkt ka funksionuar si në praktikë ashtu edhe në eksperimentet e ndryshme për rritjen e derrave në qendrën kërkimore të Schaumann në Huelsenberg.

### Vlera e pH


Acidet specifike krijojnë një mjedis acid në stomak, ndryshim i cili është i nevojshëm veçanërisht te gicat e vegjël, që kanë mungesë të prodhimit të acidit klorhidrik (HCl). Nëpërmjet tij bëhet tretja e proteinave fillestare.

### Efekt i antibakterial

Bakteret koliforme dhe gjithashtu salmonela mund të shkaktojnë një çrregullim të florës së zorrëve, veçanërisht te gicat. Kjo sjell si pasojë simptoma të lehta ose të rënda të diarresë (në varësi të ushqimit dhe kushteve të menaxhimit). Me Schaumacid-in e lëngshëm, mikroorganizmat e dëmshëm frenohen që në ushqim dhe parandalohet kolonizimi i zorrëve nga këto baktere.

### Stabilizon florën e zorrëve

Nëse shtohet acid laktik arrihet një optimizim i mjedisit për laktobacilet dhe bifidobakteret që janë të pranishme në ushqim dhe stabilizimi i mikroflorës bakteriale të zorrëve.



**Fig. 1** Efekt i Schaumacid-it të lëngshëm në metabolizmin e energjisë të mukozës së zorrëve

Furnizimi me acid laktik si dhe aktivizimi i prodhuesve të acidit laktik të zorrëve përmirëson furnizimin me energji të qelizave të zorrëve (Fig. 1). Për të gjithë gamën e lëndëve ushqyese garantohet një stimulim i sistemit imunitar dhe një kapacitet i përmirësuar përthithës i lëndëve ushqimore. Shfrytëzimi më i mirë i lëndëve ushqyese reflektohet në një konvertim më të favorshëm të ushqimit dhe si rrjedhojë shtesa peshe më të mëdha.

### Shëndeti dhe performanca e kafshëve

Hulumtimet në qendrën kërkimore të Schaumann në Huelsenberg për efektin e Schaumacid-it të lëngshëm te bakteret gram-negative (E.coli dhe salmonela) tregojnë efektin e lartë bakterial. Brenda 4 orëve, Schaumacid-i i lëngshëm (5kg/t ushqim) reduktoi përmbajtjen e baktereve gram-negative në përmbajtjen ushqimore në më pak se 1% të vlerës fillestare. (Fig. 2). Kontaminimi me salmonelë i ushqimit u ul në të njëjtën kohë me 20% të vlerës fillestare. Përdorimi i acideve të Schaumacid-it të lëngshëm rezulton pozitiv në frenimin e rritjes së mikroorganizmave dhe kufizimin afatgjatë të mikrobeve dhe sporeve të padëshiruara.

**Schaumacid-i i lëngshëm redukton përmbajtjen e baktereve gram-negative në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt.**

## Marrja e përmirësuar e ushqimit

Schaumacidi i lëngshëm përmirëson marrjen e ushqimit, një faktor ky që luan një rol të rëndësishëm në ushqyerjen e gicave.

Efektet më të kënaqshme arrihen gjatë fazës kur gicat janë të vegjël dhe paramajmëri. Frytdhënës është edhe për të ushqyerit e dosave, derrave të majmërisë dhe shpendëve.

## Rezultate shumë të mira

Për shembull, në figurën 3 janë paraqitur të dhënat e një eksperimenti për rritjen e gicave në Huelsenberg. Ushqimi për rritjen e derrave përbëhej nga 74,5% grurë, 20% miell soje, 1,5% vaj soje dhe 4% ushqim mineral Schaumann.

Ndikimi pozitiv në shtimin ditor të peshës, marrjen e ushqimit dhe konvertimin e ushqimit është i dukshëm në vlerësimin e të gjithë fazës së eksperimentit me shtim ditor të peshës 9% më të lartë.

Në praktikë: Përdorimi i kombinimit të balancuar të acidit të lëngshëm Schaumacid sjell një rritje të matshme të performancës së kafshëve në lidhje me një nivel të sigurt dhe të lartë të shëndetit në stallë.

## Për më shumë informacion:



**QF** Qendra e Formimit  
**PB** Profesional të Blegtorëve


## Austria Praemix shpk

**Tel:** +355 (0)68 402 6311

**e-mail:** agri@ap.com.al

**website:** www.ap.com.al

**Fig.2** Efekti frenues i Schaumacid-it të lëngshëm mbi bakteret gram-negative.



**Fig.3** Efektet ushqyese në rritjen e derrave

**Tabelë 3: Nutritivus Effekte von SCHAUMACID flüssig in der Ferkelaufzucht (7-28 kg)**

Shtesa ditore e peshës	0,7% SCHAUMACID	
Marrja ditore e ushqimit		
Konvertimi i ushqimit	g	432
Tägliche Futtermenge	g	711
Futterverwertung	1:	1,66